


Abd. no. 141.609

JOBI  
edhe  
EKKLISIASTIU

Kthyerë prej Evraishtesë



MANASTIR

Shtypëshkronja Treg. Nërkombëtare

1912



BIBLIOTHECA  
Vivlia e YJobit. Y KUYPILA  
ΛΑΥΡΙΩΤΟΥ  
AYZON APIO.  
Krye I.

- 1 Ishte një njeri ndë dhet të Uzit, i-cili qu  
hej Job; edhe ky njeri ishte i-mbaruarë e i-  
drejtë, e kishte frikë nga Perëndia, e mër-  
2 gonej nga e-keqeja. Edhe i linn' ati shtatë  
3 bij e tri bija. Edhe bagëtit' e atij ishinë  
shtatë mijë *krerë* dhën, e tri mijë kamilla,  
e pesë qint pëndë qe, e pesë qint gomare,  
edhe mjaft shumë shërbëtorë; kaqë sa ay  
njeri ishte më i-madhi i gjithë vëndësvet të  
Lindjesë.
- 4 Edhe të bijt' e ati shkonin' e bëninë go-  
sti ndë shtëpit të sicilit *nga ata* ndë ditët  
t' ati; edhe dërgonin' e grishninë të tri të  
motrat' e tyre që të hanin' e të pininë ba-  
5 shkë me ato. Edhe kur mbaroneshinë ditt' e  
gostisë, Jobi dërgonte e shënjtëronte ata, e-  
dhe ngrihej çpejt ndë mëngjest, e binte dhu-  
rrata të-gjithëdjugura pas numërit t' atyre të-  
gjithëve; sepse Jobi ihoshte, Mundetë t' im  
bij të kenë fëjyerë e të kenë mohuarë Pe-  
rëndinë ndë zëmërët të tyre. Kështu bënte  
Jobi përherë.



- 6 Edhe një ditë erthnë të bijt' e Perëndi që të dilninë përpara Zotit, edhe ndër më 7 t' atyreve erdhi edhe Satanaj. Edhe Zoti tha Satanajt, Nga po vjen? Edhë Satanaj upërgjeq Zotit, e tha, Që dyke shkuarë a dej e këtej mbi dhet, e që dyke ecurë la 8 e poshtë ndëpër atë. Edhe Zoti i tha Sat najt, A e ke vënë re shërbëtorinë t' im Jol sepse s' ka asndonjë *njeri* posi atë ndë dhë njeri të-mbaruarë e të-drejtë, *njeri* që 1 frikë nga Perëndia, e që mërgonetë nga 9 keqeja. Atëhere Satanaj i upërgjeq Zotit, tha, Mos për asgjë Jobi ka frikë nga Perë 10 dia? A nuk' e ke thururë nga të-githë anë atë, e shtëpin' e ati, e gjithë ç' ka? i ke bë kuarë punët' e duarvet, e bagëtit' e ati jar 11 shumuarë mbi dhet. Po tashi ndej dorët t' ënde edhe nga-j'a gjithë ç' ka, edhe do 12 të mohonjë përpara syvet të tu. Edhe Zoti tha Satanajt, Na tek *janë* ndë dorët t' ënd gjithë ç' ka; vetëmë mbi atë mos vësh dorënë t' ënde. Kështu Satanaj dolli që përpar fakes' së Zotit.
- 13 Edhe një ditë, tek ishinë të bijt' e të bjet' e ati dyke ngrënë e dyke pirë verë ndë 14 shtëpit, të vëllajt të tyrë më të-madhit, Erdi një lajmës te Jobi, e tha, Qetë po lëronin 15 edhe gomaretë po kullotin' afër' atyreve; Edhe Sabeanëtë ranë mbi ta, e i rrëmbyen edhe shërbëtorët' i shkuarë ndëpër gojët t



kordhësë; edhe vetëm' unë fillthi shpëtova që të t' ap zë ty.

- 16 Tek ishte ky edhe dyke folurë, erdhi edhe një tjetërë, e tha, Zjarr Perëndie ra nga qielli, edhe dogji dhëntë e shërbëtorëtë, edhe i përvëloj ata; edhe vetëm' unë fillthi shpëtova që të t' ap zë ty.
- 17 Tek ishte ky edhe dyke folurë, erdhi edhe një tjetërë, e tha, Haldeanëtë, bërë tri tufë, usulnë mbi kamillat, e i rrëmbyenë; edhe shërbëtorëtë i shkuanë ndëpër gojët të kordhësë; edhe vetëm' unë fillthi shpëtova që të t' ap zë ty.
- 18 Tek ishte ky edhe dyke folurë, erdhi edhe një tjetërë e tha, T' ët bij e t' ët bija po hanin' e po pininë verë ndë shtëpit të vë-
- 19 Ilajt të tyre më të-madhit; Edhe na tek erdhi një er' e-madhe nga shkretëtira, edhe ura te katrë çipevet të shtëpisë, edhe shtëpia ra mbi djemt, e vdiqnë; edhe vetëm' unë fillthi shpëtova që të t' ap zë ty.
- 20 Atëhere ungrit Jobi, e çori rrobën' e tij e rroj kryet' e ti, edhe ra mbi dhet, e ufal;
- 21 Edhe tha, Lakuriq dolla nga barku i s' im' mëje, edhe lakuriq dotë kthenem atje; Zoti i dha, edhe Zoti i mori; i-bekuarë goftë emër' i Zotit.
- 22 Ndër gjithë këto Jobi nukë fejeu, as nuk e ngarkoj Perëndinë me marrëzi.



- 6 Edhe një ditë erthnë të bijt' e Perëndis që të dilninë përpara Zotit, edhe ndër mes 7 t' atyreve erdhi edhe Satanaj. Edhe Zoti tha Satanajt, Nga po vjen? Edhë Satanaj upërgjeq Zotit, e tha, Që dyke shkuarë an-dej e këtej mbi dhet, e që dyke ecurë lar 8 e poshtë ndëpër atë. Edhe Zoti i tha Satanajt, A e ke vënë re shërbëtorinë t' im Jobi sepse s' ka asndonjë *njeri* posi atë ndë dhet, njeri të-mbaruarë e të-drejtë, *njeri* që ka frikë nga Perëndia, e që mërgonetë nga e- 9 keqeja. Atëhere Satanaj i upërgjeq Zotit, e tha, Mos për asgjë Jobi ka frikë nga Perën- 10 dia? A nuk' e ke thururë nga të-githë anëtë atë, e shtëpin' e ati, e gjithë ç' ka? i ke be- kuarë punët' e duarvet, e bagëtit' e ati janë 11 shumuarë mbi dhet. Po tashi ndej dorënë t' ënde edhe nga-j'a gjithë ç' ka, edhe dotë 12 të mohonjë përpara syvet të tu. Edhe Zoti i tha Satanajt, Na tek *janë* ndë dorët t' ënde gjithë ç' ka; vetëmë mbi atë mos vësh dorënë t' ënde. Kështu Satanaj dolli që përpara fakes' së Zotit.
- 13 Edhe një ditë, tek ishinë të bijt' e të bijat' e ati dyke ngrënë e dyke pirë verë ndë 14 shtëpit, të vëllajt të tyrë më të-madhit, Erdhi një lajmës te Jobi, e tha, Qetë po lëroninë, 15 edhe gomaretë po kullotin' afër' atyreve; E- dhe Sabeanëtë ranë *mbi ta*, e i rrëmbyenë; edhe shërbëtorët' i shkuanë ndëpër gojët të



kordhësë; edhe vetëm' unë fillthi shpëtova që të t' ap zë ty.


- 16 Tek ishte ky edhe dyke folurë, erdhi edhe një tjetërë, e tha, Zjarr Perëndie ra nga qielli, edhe dogji dhëntë e shërbëtorëtë, edhe i përvëloj ata; edhe vetëm' unë fillthi shpëtova që të t' ap zë ty.
- 17 Tek ishte ky edhe dyke folurë, erdhi edhe një tjetërë, e tha, Haldeanëtë, bërë trifufë, usulnë mbi kamillat, e i rrëmbyenë; edhe shërbëtorëtë i shkuanë ndëpër gojët të kordhësë; edhe vetëm' unë fillthi shpëtova që të t' ap zë ty.
- 18 Tek ishte ky edhe dyke folurë, erdhi edhe një tjetërë e tha, T' ët bije t' ët bija po hanin' e po pininë verë ndë shtëpit të vë-
- 19 Ilajt të tyre më të-madhit; Edhe na tek erdhi një er' e-madhe nga shkretëtira, edhe ura te katërë çipevet të shtëpisë, edhe shtëpia ra mbi djemt, e vdiqnë; edhe vetëm' unë fillthi shpëtova që të t' ap zë ty.
- 20 Atëhere ungrit Jobi, e çori rrobën' e tij e rroj kryet' e ti, edhe ra mbi dhet, e ufal;
- 21 Edhe tha, Lakuriq dolla nga barku i s' im' mëje, edhe lakuriq dotë kthenem atje; Zoti i dha, edhe Zoti i mori; i-bekuarë qoftë emër' i Zotit.
- 22 Ndër gjithë këto Jobi nukë fejeu, as nuk e ngarkoj Perëndinë me marrëzi.



## Krye 2.

1 Përsëri një ditë erthnë të bijt' e Perën-disë që të dilninë përpara Zotit, edhe ndër mest t' atyreve erdhi edhe Satanaj, që të 2 dilte përpara Zotit. Edhe Zoti i tha Satanajt, Nga po vjen? Edhe Satanaj i upërgjeq Zotit, e tha, Që dyke shkuarë andej e këtej mbi dhet, e që dyke ecurë lart e poshtë ndëpër 3 atë. Edhe Zoti i tha Satanajt, A vure re shërbëtorinë t' im Job? sepse s' ka asndonjë njeri posa atë mbi dhet, njeri të-mbaruarë e të-drejtë, *njeri* që ka frikë nga Perëndia, e që mërgonetë nga e-keqeja; edhe po mbahetë i-patundurë ndë tërësit të ti, ndonëse më ndeze kundr' atij, që t'a prish atë pa *ndonjë* 4 *farë* ngaje. Edhe Satanaj i upërgjeq Zotit, e tha, Lëkurë për lëkurë, po, çdo që të ketë 5 njeriu, dot' e apë për jetën' e ti. Po tashi ndej dorënë t' ënde, edhe *nga-i* eshtërat' e mishratë, edhe dotë të mohonjë përpara sy- 6 vet të tu. Edhe Zoti i tha Satanajt, Na ay tek *është* ndë dorët t' ënde; vetëmë i ruaj ati jetënë.

7 Atëhere Satanaj dolli që përpara fakes' së Zotit, edhe i ra Jobit me koqe të-këqia që *nga* gjurm' e këmbëvet t' ati e gjer ndë 8 majët *të kokës'* s' ati. Edhe mori një guacë për vetëhen' e ti, që të kruhej me atë; edhe 9 rrinte ndë mest të hirit. Atëhere i tha ati



- gruaj' e ti, Edhe më e mban vetëhenë t' ënde të-patundurë nde tërësit t' ënde? moho
- 10 Perëndinë, edhe vdis. Po ay i tha asaj, *Ti* flet si flet ndonjë grua nga të-marratë. Çë? *vetëmë* të-miratë të presëmë nga Perëndia, edhe të-keqiatë të mos i presëmë? Ndër gjithë këto Jobi nukë fëjeu me buzët' e tia.
- 11 Edhe kur dëgjuanë të tre miqt' e Jobit gjithë këto të-këqia që erthnë mbi atë, erthnë sicili nga vëndi i tij; Elifas Themanini, e Bildad Shuhiti, e Zofar Naamathiti; edhe bënë fjalë bashkë të vininë që të rëkoninë
- 12 bashkë me atë e t'a ngushulloninë. Edhe kur ngritnë syt' e tyre për-së-largu, edhe nuk' e njohnë atë, ngritnë zërin' e tyre, e qanë; edhe çuarrë sicili rrobën' e ti, edhe hothnë pluhurë mbi kryet të tyre drejt qiellit.
- 13 Kështu ndënjinë bashkë me atë përdhe shtatë dit e shtatë net, edhe asndonjë nuk' i foli ati ndonjë fjalë, sepse shihninë se të-dhëmburit' e ati ishte fort të-matn.

### Krye 3.

- 1 Pasandaj Jobi hapi gojën' e ti, edhe mallë-  
2 koj ditën' e tij. Edhe Jobi foli e tha,
- 3 Të kishte humburë ajo ditë, ndë të-cilët  
linda,  
Edhe ajo natë, ndë të-cilët thanë, Lindi  
mashkull.
- 4 Ajo ditë qoftë errësirë;



- Perëndia mos e nderoftë atë prej-së-larti,  
As mos ndrittë dritë mbi atë.
- 5 Errësira e hijeja e vdekjesë e kërkofshinë  
për vetëken' e tyre;  
Mjergullë ndënjtë mbi atë;  
Çdo që nxin ditënë e bëftë atë të dridhetë.
- 6 Sapër atë natë, errësir' e-dëndurë e pu-  
shtoft' atë;  
Mos ugëzoftë ndër mest të ditvet të vitit;  
Mos hyftë ndë numërt të muajvet.
- 7 Na, ajo natë qoftë shterpë;  
Mos udëgjoftë zë gëzimi mb' atë.
- 8 E mallëkofshin' atë ata që mallëkonjënë  
dittë,  
Ata që janë gati të ngrenë Leviathaninë.
- 9 Uerrësorfshin' yjt' e mbrëmjes' s' asaj;  
Prittë dritënë, e mos arthtë;  
As mos paftë qepallat' e të-gdhirit.
- 10 Sepse nukë mbylli dyert' e barkut të s'  
im' *mëje*,  
As fshehu shtrëngimnë nga syt' e mi.
- 11 Përse nukë vdiqa që nga shtrati *i s' im' mëje?*  
Përse nukë dhashë frymënë posa dolla nga  
barku?
- 12 Përse më pritnë gjunjëtë?  
A përse gjirëtë, që të pi qumësht?
- 13 Sepse tashi dotë kisha flejturë, e dotë  
isha prëjturë;



Dotë kisha rënë ndë gjumë; atëhere dotë  
isha ndë prëhje,

**14** Bashkë me mbretërit' e me këshilëtarët' e  
dheut,

Të-cilëtë ndërtuanë vënde të-shkretë për  
vetëhen' e tyre;

**15** A bashkë me bujarëtë që patnë ar;

Të-cilëtë mbushnë shtëpit' e tyre me er-  
gjënt;

**16** A posi dështak i-fshehurë nukë dotë kisha  
pasë qënë,

Posi foshnje që s' kanë parë dritënë.

**17** Atje të-liqtë pushonjënë së punuari keq;  
Edhe atje prëhenë të-lodhuritë.

**18** Atje prëhenë bashkë skllevëritë;  
Nukë dëgjonjënë zë shtrëngatësi.

**19** I-vogëli edhe i-madhi jan' atje;  
Edhe shërbëtori ësht' i-liruarë nga i zoti.

**20** Përse i udha dritë fatkeqit,

Edhe jetë të-helmuarit ndë shpirtt,

**21** Të-cilëtë dëshëronjënë mortjenë, po nuk' e  
gjenjënë,

Ndonëse rëmonjënë për atë me tepërë se  
për thesarët' e-fshehurë?

**22** Të-cilëtë gëzonnenë tepërë,

E janë të-gëzuarë, kur gjenjënë varrinë?

**23** Përse t' i epetë dritë ati qe e ka udhënë  
të-fshehurë,

Edhe Perëndia e ka thururë përqark?



- Perëndia mos e nderoftë atë prej-së-larti,  
As mos ndrittë dritë mbi atë.
- 5 Errësira e hijeja e vdekjesë e kërkofshinë  
për vetëken' e tyre;  
Mjergullë ndënjtë mbi atë;  
Çdo që nxin ditënë e bëftë atë të dridhetë.
- 6 Sapër atë natë, errësir' e-dëndurë e pu-  
shtoft' atë;  
Mos ugëzoftë ndër mest të ditvet të vitit;  
Mos hyftë ndë numërt të muajvet.
- 7 Na, ajo natë qoftë shterpë;  
Mos udëgjoftë zë gëzimi mb' atë.
- 8 E mallëkofshin' atë ata që mallëkonjënë  
dittë,  
Ata që janë gati të ngrenë Leviathaninë.
- 9 Uerrësofshin' yjt' e mbrëmjes' s' asaj;  
Prittë dritënë, e mos arthtë;  
As mos paftë qepallat' e të-gdhirit.
- 10 Sepse nukë mbylli dyert' e barkut të s'  
im' *mëje*,  
As fshehu shtrënglëmnë nga syt' e mi.
- 11 Përse nukë vdiqa që nga shtrati *i s' im' mëje*?  
Përse nukë dhashë fryshtë posa dolla nga  
barku?
- 12 Përse më pritnë gjunjëtë?  
A përse gjirëtë, që të pi qumësht?
- 13 Sepse tashi dotë kisha flejturë, e dotë  
isha prëjturë;



Dotë kisha rënë ndë gjumë; atëhere dotë  
isha ndë prëhje,

- 14 Bashkë me mbretërit' e me këshilëtarët' e  
dheut,  
Të-cilëtë ndërtuanë vënde të-shkretë për  
vetëhen' e tyre;
- 15 A bashkë me bujarëtë që patnë ar;  
Të-cilëtë mbushnë shtëpit' e tyre me er-  
gjënt;
- 16 A posi dështak i-fshehurë nukë dotë kisha  
pasë qënë,  
Posi foshnje që s' kanë parë dritënë.
- 17 Atje të-liqtë pushonjënë së punuari keq;  
Edhe atje prëhenë të-lodhuritë.
- 18 Atje prëhenë bashkë skllevëritë;  
Nukë dëgjonjënë zë shtrëngatësi.
- 19 I-vogëli edhe i-madhi jan' atje;  
Edhe shërbëtori ësht' i-liruarë nga i zoti.
- 20 Përse i udha dritë fatkeqit,  
Edhe jetë të-helmuarit ndë shpirrt,
- 21 Të-cilëtë dëshëronjënë mortjenë, po nuk' e  
gjenjënë,  
Ndonëse rëmonjënë për atë me tepërë se  
për thesarët' e-fshehurë?
- 22 Të-cilëtë gëzonnenë tepërë,  
E janë të-gëzuarë, kur gjenjënë varrinë?
- 23 Përse t' i epetë dritë ati qe e ka udhënë  
të-fshehurë,  
Edhe Perëndia e ka thururë përqark?



- 24 Sepse psherëtima më vjen më përpara se të ha,  
Edhe ulërinat' e mia derdhenë pos i ujera.
- 25 Sepse vjen mbi mua ajo prej së-cilësë kam  
frikë,  
Edhe vjen mbi mua ajo prej së-cilësë trëm-  
bem.
- 26 S' kam paqtim, as të-prëjturë, as qetësi;  
Po trubullim vjen *mbi mua*.

## Krye 4.

- 1 Atëhere Elifaz Themaniti upërgjeq, e tha,  
2 Ndë kuxoftë ndonjë të të flasë, a dotë të  
vinjë keq?  
Po cili munt të mbanjë vetëhen' e ti pa  
folurë?
- 3 Na ti tek këshillove shumë *veta*,  
Edhe forcove duar të-pafuqishime.
- 4 Fjalët' e tua përmbanin' atë që tunde-  
shinë,  
Edhe u epninë fuqi gjunjëve të-këputurë.
- 5 Po tashi të erdhi këjo, edhe të pshon  
zëmëra;  
Të piek, edhe dridhesh.
- 6 A nuk' eshte frika jote *prej Perëndisë* gjëja,  
mbë të-cilënë besonesh,  
*Edhe* drejteria e udhëvet të tua shpresa  
jote?
- 7 Kujtohu, të lutem, cili njeri i-pafajm ka  
humburë?  
*Edhe* ku të-drejtëtë janë shuarë?



- 8 Sikundrë kam parë unë, ata që punonjënë paudhërinë,  
Edhe mbjellënë të-keqenë, gjithato po korr-njënë.
- 9 Shuhënë nga të-fryiturit' e Perëndisë,  
Edhe humbasënë nga të-çfryturit' e zëmë-rimit t' atij.
- 10 Ulërim' e leonit, edhe zëri i lconit t' egërë-shuhënë,  
Edhe dhëmbët' e leonëvet të-rinj thyhenë..
- 11 Leoni plak vdiretë, se s' gjen gjah,  
Edhe këlyshët' e leoneshesë çpérndahanë..
- 12 Një fjalë më erdhi fshehuraj,  
Edhe veshi im mori një pishtëlimë t' asaj.
- 13 Ndë mendimet nga të-faniturat' e natësë,  
Kur njerëzitë i zë gjum' i-thellë,
- 14 Me mori frika e të-dridhuritë,  
Edhe bënë gjith' eshtërat' e mia të dridhenë:
- 15 Atëhere një frymë shkoj përpara meje,  
Edhe qimet' e mishit t' im ungritnë përpjetë.
- 16 Qëndroj, po nukë munda të shquanj fytarën' e asaj;  
Një figurë m' uduk përpara syvet;  
*Atje ishte* një pushim, edhe dëgjova një zë,  
që thoshte,
- 17 A dotë jetë njeriu i-morçim më i-drejtë se Perëndia?  
A dote jetë njeriu m' i-kthjellëtë se Ndërtustari i tij?



- 18 Na ay tek nuk' u zë besë shërbëtorëvet  
të ti;  
Edhe ëngjëjvet të ti u gjen të-metë;
- 19 Sa më tepërë atyre që rrinë ndër shtë-  
pira të-baltta,  
Themelia e të-cilavet është ndë pluhurt,  
*Edhe* të-cilatë rrëzonënë përpara Mizësë?
- 20 Që ndë mëngjest e gjer mbrëmanet vdi-  
renë;  
Pa kupëtuarë njeri, humbasënë për gjithënjë.
- 21 A nukë çkuletë lirari i tendës' s' atyre  
që përbrënda atyreve?  
Vdesënë, po nukë me dituri.

### Krye 5.

- 1 Thirrë tashi; a ka ndonjë që të të përgjigjetë?  
Edhe mbë cilinë nga shënjtorëtë dotë kthenësh?
- 2 Sepse helmi vret njerin' e-marrë,  
Edhe zëmërata mbyt atë që s' ka mënt.
- 3 Unë kam parë të-marrinë të zërë rrënjë,  
Po përnjëhere mallëkova të-ndënjurit' e ati.
- 4 Të bijt' e ati janë lark nga siguria,  
Edhe dërrmonenë përpara portësë,  
Edhe s' ka njeri që i shpëtonjë.
- 5 Të-korrët' e atyre e ha ay që ka uri,  
Edhe e rrëmben atë nga gjëmbatë,  
Edhe ay që ka et përpin pasjen' e atyre.



- 6 Sepse shtrëngimi nukë del nga pluhuri,  
As hidhërimi nukë mbin nga dheu;
- 7 Po njeriu lint për hidhërim,  
Sikundrë shkëndiatë, për të flutruuarë përpjetë.
- 8 Po unë, dotë thërrisnja Perëndisë përndihmë,  
Edhe punënë t'ime dot' j'a linja Perëndisë;
- 9 I-cili bën punë të-mëdha e të-pavëshguarshime;  
Punë të-cudiçime pa numër;
- 10 I-cili lëshon shi mbi faqet të dheut,  
Edhe dërgon ujëra mbi faqet të aravet;
- 11 I-cili larton të-përunjuritë;  
Edhe ngre ndë shpëtim ata që mbanjënë zi.
- 12 I-cili përprish pllanet' e *njerësvet* dinakë,  
Sa duart' e atyre s' munt të mbaronjënë punënë që dëshëronjënë.
- 13 I-cili zë të-dituritë nde dinakërit të tyre,  
Edhe këshilla e kobimtarëvet përbysëtë.
- 14 Ditënë përpikenë me errësirë,  
Edhe ndë mest të ditësë kërkonjënë me dorë posi natënë.
- 15 Po të-vobegunë e shpëton nga kordha e gojës' s' atyre,  
Edhe nga dora e të-fortit.
- 16 Kështu i-vobegu ka shpresë,  
Po goj' e paudhërisë thuretë.
- 17 Na, lum ay njeri që e qërtan Perëndia;



Përandaj mos e hith poshtë mundimn' e  
Fuqimadhit.

- 18 Sepse ay bën plagë, edhe e lith;  
Plagos, edhe duart' e ati shëronjënë.
- 19 Ndër gjashtë shtrëngata të ka për të shpë-  
tuarë,  
Edhe mbë të-shtattënë s' të ka për të pje-  
kurë *ndonjë* e-keqe.
- 20 Ndë *ditët* të urisë dotë të shpëtonjë nga  
vdekja;  
Edhe ndë luftët nga fuqia e kordhësë.
- 21 Nga shufra e gjuhësë dotë jesh i-ruajturë;  
Edhe nukë dotë kesh frikë nga prishja  
që vjen.
- 22 Ndë prishjet e ndë urit dotë qëshç;  
Edhe nukë dotë kesh frikë nga bishat' e  
dheut.
- 23 Sepse dotë kesh ndihmë gurët' e fushësë,  
Edhe bishat' e dheut dotë jenë ndë paq-  
tim me ty.
- 24 Edhe dotë njohç se tenda jote është ndë  
paqtim;  
Edhe dotë vështronjç të-ndënjuritë t' at, e-  
dhe asgjë nukë dotë të shteretë.
- 25 Edhe dotë njohç se fara jote dotë jet' e-madhe,  
Edhe nipërit' e tu posi bari i dheut.
- 26 Dotë veç ndë varrt ndë pleqëri të-plotë,  
Sikundrë grumbullonetë mullari i grurit ndë  
kohët të ti.
- 27 Na tek e vëshguamë këtë, kështu është;



Dëgjo-e, e di-e, për të-mirënë t' ënde.

Krye 6.

- 1 Atëhere Jobi upërgjeq e tha,
- 2 Ah! sikur të peshohej hidhërimi im,  
Edhe mjerësia ime të vihej bashkë ndë  
palanxët!
- 3 Sepse tashi dot' ishte më ë-rëndë se rëra  
e detevet;  
Përandaj fjalët' e mia janë të-tepëruara.
- 4 Sepse shëgjetat' e Fuqimadhit janë për-  
brënda meje,  
Vëreri i atyre përpi frymënë t' imë;  
Trishtimet' e Perëndisë janë radhiturë kun-  
drë meje.
- 5 A pëllët gomari i-egrë, kur ka bar të-  
njomë?  
A pëllët kau përanë grashdit të tij?
- 6 A munt të hahetë pa kripë ajo gjë që s'  
ka shijë?  
A ka shijë të-ngrëni ndë të-bardhët të vesë?
- 7 Ato që mërzit shpirti im t' u pjekë,  
Këto m' ubënë ushqimi im i-ndohtë.
- 8 Makar të kisha fituarë kërkimnë t' im,  
E të më epte Perëndia atë që dëshëronj!
- 9 Po, të donte Perëndia të më prishnjë;  
Të lëshonte dorën' e tij e të më priste!
- 10 Atëhere dotë kisha edhe ngushullim;  
Po, dotë ngazëllonesha ndë mundimet të mi,



- ndonëse s' më kurjenjënë;  
Sepse nukë mohova fjalët' e Shënjtit.
- 11** Cila është fuqia ime, që të qëndronj?  
Edhe cili është fundi im, që të duronj?
- 12** Mos është fuqia ime fuqi gurësh?  
Apo mishi im ramë?
- 13** A nukë kam mbeturë pa ndihmë,  
Edhe shpëtimi është larguarë farë prej  
meje?
- 14** Ati që është gati të shuhetë *duhetë t' i rrë-fenetë përdëllim* prej mikut të tij,  
Edhe ndë qoftë se la mbë nj' anë frikën' e Fuqimadhit.
- 15** T' im vëllezër usuallnë me kobim posa përrua,  
Posa rrjedhje përrënsh që shkonjënë;
- 16** Të-cilëtë trumbullonenë nga akulli,  
*Edhe* ndë të-cilët fshihetë dëbora;
- 17** Kur nxehenë, s' mbetenë më;  
Kur bën nxehëtë, shuhënë nga vëndi i tyre.
- 18** Karvanëtë që *udhëtonjenë* nga udh' e atyre  
kthenenë mbë nj' anë,  
Venë lart ndë shkretëtirët, edhe humbasënë..
- 19** Karvanët' e Themasë vështroninë *për ata*,  
Udhëtarët' e Shebasë shpreninë mb' ata.
- 20** Ugënjyenë ndë shpresët të tyre;  
Erdhë atje, edhe uturpëruanë.
- 21** Tashi edhe ju jeni posa ata;  
Patë tmerrë *t' im*, edhe utrëmptë.
- 22** Mos u thashë unë, Ep-më-ni gjë?



- Apo, Bi-më-ni dhuratë nga pasja juaj?
- 23 Apo, Shpëto-më-ni nga dora e armikut?  
Apo, Çpërble-më-ni nga dora e shtrëngatësvet?
- 24 Mëso-më-ni, edhe dotë pushonj;  
Edhe bë-më-ni të kupëtonj ku kam lajthiturë.
- 25 Sa të-forta janë fjalët' e-drejta!  
Po qërtimi juaj, ç' dëften?
- 26 Apo mendoni të qërtoni fjalë,  
Kur fjalët' e njeriut të-dëshpëruarë janë posa era?
- 27 Me të-vërtetë ju qeshni me fatin' e të-varfërit,  
Edhe shitni mikunë t' uaj.
- 28 Tashi pra kini mirësinë të hithni sytë mbi mua;  
Sepse me të-vërtetë nukë dotë them gënje-shtra përpara faqesë s' uaj.
- 29 Kthehi, u lутем, letë mos bënëtë paudhëri;  
Po, kthehi përsëri; puna ime ësht' e-drejtë..
- 30 A ka shtrëmbëri ndë gjuhët t' ime?  
A nukë munt të çquanjë qiellëza ime gjërrëra të-këqia?

### Krye 7.

- 1 A nuk' është luftë *jeta* e njeriut mbi dhet?  
Edhe ditt' e atij a nukë janë si ditt' e njeriut të-pajtuarë?
- 2 Sikundrë shërbëtori dëshëron me të-tepërë



- hijenë,  
 Edhe sikundrë i-pajtuari shikon për pagën'  
 e tij,
- 3 Kështu unë jam bërë për të pasurë për tra-  
 shëgim muaj kotësireje,  
 'Edhe net të-dhëmburash janë urdhëruarë  
 për mua.
- 4 Kur bje *të fle*, them, Kur dotë ngrihem?  
 Po nata ësht' e-gjatë;  
 'Edhe kthenem andej e këtej gjer mbë të-  
 gdhirët.
- 5 Mishi im është veshurë me krimba e me  
 plisa dheu;  
 Lëkura ime pëlçet e rrieth.
- 6 Ditt' e mijë janë më të-çpejta se suvajka  
 e pelhurë-endësit,  
 Edhe hnmbasënë pa shpresë.
- 7 Kujtohu sejeta ime është eïë;  
 Syri im më nukë dotë shohë të-mirë.
- 8 Syri i ati që më sheh nukë dotë më shohë më;  
 Syt' e tu dotë jenë mbi mua, po unë nukë  
 dotë jem.
- 9 Posi përndahetë reja e humbetë,  
 Kështu ay që sbret ndë varrt nukë dotë  
 ngjitetë më *lart*.
- 10 Nukë dotë kthehetë më ndë shtëpit të ti,  
 Edhe vëndi i atij nukë dot'a njohë më atë.
- 11 Përandaj nukë dotë mbanj gojënë t'ime;  
 Dotë flas ndë shtrëngimt të frymësë s'ime;

Dotë qanj me dënesë nde të-pikët të shpirtit t' im.

- 12 Det jam unë, a bishë deti,  
Qe vure mbi mua ruajtje?
- 13 Kur them, Shtrati im dotë më ngushëllonjë,  
Edhe shtresa ime dotë më lehtësonjë rë-kimnë,
- 14 Atëhere *ti* më frikëson me ëndërra,  
E më bën të dridhem me të-fanitura;
- 15 Kështu shpirti im sjeth ljakthinë,  
Edhe vdekjenë më *tepërë* se *këto* eshtërat' e mia.
- 16 Umërziçë *nga jeta*; nukë dua të rronj gjithënjë;  
Hiqù prej meje; sepse ditt' e mia janë kotësirë.
- 17 Ç' është njeriu që e madhon atë?  
Edhe e vë zëmërënë t' ënde mbi atë?
- 18 Edhe vet' e shikon mëngjes për mëngjes,  
Edhe e çprovon atë mbë çdo të-fillme?
- 19 Gjer kur nukë dotë hiqesh prej meje,  
Edhe nukë dotë më lësh vetëmë, që të përpipshymënë t' ime?
- 20 Ndë fëjeva, ç' munt të të bënj ty, o Përbajtësi i njerësve?  
Përse më vure si shënjë për *shëgjetat'* e tua,  
Kaqë sa më rëndonetë vetëheja?
- 21 Edhe përse nukë më ndjen të-shkelurit' e *porosirë*, edhe nukë më heq panominë t' ime?



Sepse për pakëzë dotë fle ndë baltët;  
 Edhe dotë më kërkonjç me kujdes, po nukë  
 dotë jem.

Krye 8.

- 1 Atëhere upërgjeq Bildad Shuhiti, e tha,
- 2 Gjer kur dotë flasç këto?  
 Edhe *gjer kur* fjalët' e gojësë s' ate dotë  
 jenë pos i er' e-fortë?
- 3 A shtrëmbëron Perëndia gjyqinë?  
 Apo përbys Fuqimadhi drejtërinë?
- 4 Ndë kanë fëjyerë bijt' e tu kundr' atij,  
 Edhe ay i dha ndë dorët të panomis' s'  
 atyre.
- 5 Po të keshe kërkuarë Perëndinë me kujdes,  
 Edhe t' i keshe bërë lutje Fuqimadhit;
- 6 Po të ishe i-kthjellët' e i-drejtë;  
 Me të-vërtetë tashi dotë ishte sgjuarë për ty,  
 Edhe dotë kishte bërë të-lumurë të-ndënju-  
 rit' e drejtërisë s' ate.
- 7 Edhe ndë qoftë se të-nisuritë t' at ishte të-  
 vogjëlë,  
 Po të-pastajmet' e tua dotë madhoneshinë  
 fort.
- 8 Sepse pa pyet, të lutem, për brezat' e-shku-  
 arë,  
 Edhe vëshgo me kujdes për atërit' e atyre;
- 9 (Sepse ne jemi të-djeshm, edhe nukë dimë  
 asgjë,  
 Sepse dittë t' ona mbi dhet janë si hije;)



- 10 A nukē dotë tē mësonjënë ty, edhe dotë tē,  
rrëfenjënë,  
Edhe dotë nxjerrënë fjalë nga zëmëra e tyre?
- 11 A gëlon papyri jashtë baltësë?  
A rritetë kallami pa ujë?
- 12 Tek është edhe i-gjelbërë *edhe i-paprerë*,  
Thahetë përpara çdo *tjetërë* bari.
- 13 Kështu janë udhët' e gjith' atyreve që ha~  
rronjënë Perëndinë;  
Edhe shpresa e tē-pabesit dotë humbasë;
- 14 Shpresa e atij dotë pritetë,  
Edhe gjëja ndë tē-cilët besonetë dotë jetë  
posi pëlhirë merimange.
- 15 Dotë pshtetetë ndë shtëpit tē tij, po ajo  
nukē dotë qëndronjë;  
Dotë xihetë keq pas asaj, po ajo nukē  
dotë mbahetë.
- 16 Ësht' i-njomë përpara djellit,  
Edhe degat' e aji shtrihenë mbi kopshtët t' aji.
- 17 Rrënjet' e atij ngatëronenë rresh togut *të gurëvet*,  
*Edhe* sgjeth vëndin' e-gurtë.
- 18 Ndë uckultë nga vëndi i tij,  
Atëherë *vendi* dot'a mohonjë atë, *dyke thënë*,  
Nukë tē kam parë.
- 19 Na, ky është gëzimi i udhës' s' atij,  
Edhe nga dheu tē-tjerë dotë mbinjënë.
- 20 Na, Perëndia nukē dot'a hedhi tej njerin'  
e-mbaruarë,



As dotë ngrerë lart keqbësëritë.

21 Dotë mbushnjë edhe gojënë t'ënde me të-qeshurë,

Edhe buzët' e tua me zëre gëzimi.

22 Ata që të kanë cmir dotë vishenë me tur-përi;

Edhe tenda e të-liqvet nukë dotë jetë më.

### Krye 9.

1 Atëhere Jobi upërgjeq, e tha,

2 Me të-vërtetë e di se kështu është;

Po njeriu qysh munt të jet' i-drejtë përparrë  
Perëndisë?

3 Ndë dashtë të gjykonetë me atë,

Nukë dotë muntnjë t'i përgjigjet' atij as një për mijë.

4 *Perëndia* ësht' i-urtë ndë zëmërët, edhe i-fortë ndë fuqit;

Cili uashpërua kundr' atij, e i vate mbarë?

5 Ay luan nga vëndi maletë, edhe nuk' e dinë,  
Kur i përblys ata ndë zëmëratët të tij.

6 Ay tunt dhenë nga vëndi i tij,  
Edhe shtyllat' e atij lëkundenë.

7 Ay urdhëron djellinë, edhe *djelli* nuk' lint;  
Edhe mbyll yjtë ndënë vulë.

8 Ay vetëmë nden qiejtë,

Edhe ecën mbi valët të detit.

9 Ay bën Arkturinë, Orionnë, e Pleiadhnë,  
Edhe dhomat' e anës' se shiut.



- 10 Ay bën punë tē-mëdha tē-pavëshguarshime,  
Po, punë tē-çudiçime tē-panumëruara.
- 11 Na tek shkon afërë meje, edhe nuk' e shoh  
atë;  
Shkon, edhe nuk' e kupëtonj atë. .
- 12 Na tek zë *gjahunë*, cili munt t'a ndalonj' atë?  
Cili dot' i thot' atij, Ç' bën?
- 13 Perëndia nukë dotë heqë zëmërimin' e tij;  
Ndihmësitë madhështorë vihenë poshtë ndënë  
atë.
- 14 Sa shumë më pak dot' i përgjigjem un' atij,  
Edhe tē sgjeth fjalët' e mia *që tē flas* me  
atë?
- 15 Tē-cilit, edhe i-drejtë tē isha, prapë nukë  
dot' i përgjigjeshe,  
Po dot' i luteshe gjykatësit t' im.
- 16 Ndë i thërrica, e tē më përgjigjetë,  
Prapë nukë dotë besonja se më dëgoj zënnë.
- 17 Sepse më dërrmon me erë shakulli,  
Edhe shumon plagët' e-mia pa ndonë ngajë.
- 18 Nukë dotë më lërë tē marr frymë,  
Po më ngin me hidhërimë.
- 19 Ndë qoftë puna pér fuqi, Na tek është i-  
fortë;  
Ndë qoftë pér gjyq, cili dotë më ndanjë  
kohë *që tē mburonëm*?
- 20 Edhe ndë jam i-drejtë, goja ime dotë më  
dënonjë;  
Edhe ndë jam i-mbaruarë, dotë më trego-  
një tē-prishurë.



- :21 *Edhe ndë jam i-mbaruarë, nukë dot' e mbronj vetëhenë t' ime;*  
*Nuk' e zë për gjë jetënë t' ime.*
- :22 *Gijthajo është; përandaj them,*  
*Ay shuan edhe të-mbaruarinë edhe të-ligunë.*
- 23 *Ndë vret shufra e ati përnjëhere,*  
*Dotë qesnjë me çprovimn' e të-pafajmit.*
- 24 *Dheu është dhënë ndë duart të të-ligut;*  
*Ay mbulon faqet' e gjykatësvet t' atij;*  
*Ndë mos ësht' ay, atëhere cili është?*
- 25 *Edhe ditt' e mia janë më të-çpejta se posta;*  
*Ikënjënë, edhe nukë shohënë të-mirë.*
- 26 *Shkonjënë si aniat' e-çpejta;*  
*Posi shqiponja që lëshonetë mbi gjahunë.*
- 27 *Ndë thënça, Dotë harronj rëkimnë t' im,*  
*Dotë lë vajënë t'ime, edhe dotë sbukuronem;*
- 28 *Prapë dridhem nga gjithë helmet' e mi,*  
*Di se nukë dotë më nxjerrç të-pafajm.*
- 29 *Dotë dënohem;*  
*Përse pra të lodhem mbë kët?*
- 30 *Ndë ulafsha me ujë dëbore,*  
*Edhe të pastronj duart' e mia sa kurrë *ndo-një herë*;*
- 31 *Prapë ti dotë më krethç ndë hendekt,*  
*Kaqë sa edhe *ato rrrobat'* e mia dotë më mërzitnjënë.*
- 32 *Sepse ay nuk' është njeri si unë, që t' i përgjigjem,*



- E të vemi bashkë ndë gjyq.*
- 33 *S' ka ndonjë mbigjykatës ndër mest nesh,  
Që të muntnjë të vërë dorën' e ti mbi ne  
të dy.*
- 34 *Letë heqë stadin' e tij prej meje,  
Edhe frik' e ati letë mos më trishtonjë;*
- 35 *Atëhere dotë flas, e nukë dot' i kem frikë ati;  
Sepse kështu nukë jam ndë vetëhet t' ime.*

### Krye 10

- 1 *Shpirtit t' im i urëndua jeta ime;  
Dot' epem ndë rëkimt t' im;  
Dotë flas ndë hidhërimt të shpirtit t' im.*
- 2 *Dot' i them Perëndisë, Mos më dëno;  
Dëfte-më përse hahesh me mua.*
- 3 *A është mirë për ty të mundonjç,  
E të hethç tej punën' e duaret të tua,  
E të ndriçonjç këshillën' e të-liqvet?*
- 4 *Sy mishi ke,  
Apo sheh sikundrë sheh njeriu?*
- 5 *Posi ditt' e njeriut janë ditt' e tua,  
Apo vitet' e tu posi ditt' e njeriut,*
- 6 *Që bën të-vëshguara për paudhërinë t' ime,  
Edhe të-kërkuara për fajnë t' im,*
- 7 *Ndonëse ti e di se unë nukë jàm i-lik,  
Edhe s' ka ndonjë që të muntnjë të më  
shpëtonjë nga dora jote?*
- 8 *Duart' e tua me formuanë e më gatuanë  
të-tërë,*



- Edhe prapë po më prish!
- 9 Kujtohu, të lutem, se më gatove posi baltënë;  
Edhe do të më bjesh prapë ndë baltët?
- 10 A nukë më mole posi qumest,  
Edhe më ngjize posi djathë?
- 11 Më veshe me lëkurë e me mish,  
Edhe më ende me eshtëra e me dej.
- 12 Më fale jetë e mirësira,  
Edhe kujdesi yt më ruajti frymënë.
- 13 Po këto i fshehve ndë zëmërët t' ënde;  
E di se këjo është bashkë me ty.
- 14 Ndë fëjefsha, më vë re,  
Edhe nukë dotë më nxjerrç të-pafajm nga  
panomia ime.
- 15 Ndë qofsha i-lik, mjerë unë!  
Edhe nde qofsha i-drejtë, prapë nuke dotë  
ngre kryetë t' im;  
Dotë nginem me turpëri,  
E dotë shoh shtrëngimnë t' im.
- 16 Edhe ndë ulartoftë *kryetë t' im*, Ti më gjuan-  
posi leon;  
Edhe prapë dëftehesh i-çudiçim kundrë meje.
- 17 Përtërin dëshmimirët' e tu kundrë meje;  
Edhe shumon zëmërimnë t' ënt kundrë meje;  
Ushtëri pas ushtërie janë kundrë meje.
- 18 Përse më nxore pra nga shtrati?  
Makar të kisha dhënë frymënë, edhe sy të  
mos më kishte parë.
- 19 Dotë ishnjam sikur s' kisha qënë;



- Dotë ishnjam prurë nga shtrati ndë varrt.
- 20 Ditt' e mia a nukë janë të-paka? pusho pra;  
Edhe lërë-më të marr vetëhenë pakëzë,
- 21 Përpara se të vete atje që ku s' jam për  
të kthyerë më,  
Po, ndë dhet t' errësirës' së hijes' së vde-  
kjesë;
- 22 Ndë një dhe errësire së-thellë, si errësira  
vetë;  
*Ndë dhet të hijes' së vdekjesë, ku s' ka-  
radhë,*  
Edhe drita është posa errësira,

## Krye 11:

- 1 Atëhere upërgjeq Zofar Naamathiti, e tha;
- 2 A nukë dot' i epetë të-përgjegjurë shumicës'  
së fjalëvet?  
Edhe dotë dalë i-drejtë ay që flet shumë?
- 3 A dotë mbyllnjënë gojën' e njerësvet lëvda-  
tat' e tua?  
Edhe kur përqesh, a nukë dotë të turpëro-  
ronjë njeri?
- 4 Sepse ti the, Fjala ime ësht' e-kthjelëtë;  
Edhe jam i-kthjellëtë përpara teje.
- 5 Po makar të fliste Perëndia,  
Edhe të hapte buzët' e ti kundrë teje;
- 6 Edhe të të tregonte të-fshëhëtat' e diturisë;  
Sepse dituria e-shëndoshë është shumë herë  
m' e-mbaruarë!



T'a dishi pra se Perëndia kërkon më pak  
se sa vëjen panomia jote.

- 7 'A munt ti të gjenjç thellësirat' e Perëndisë?  
A munt të kupëtonjç Fuqimadhinë më të-  
plotë?
- 8 Këto janë të-larta sa qelli; ç' munt të  
bëjsh?  
Më të-thella se Hadhi; ç' munt të njohç?
- 9 Masa e atyreve është më e-gjatë se e dheut,  
Edhe më e-gjerë se e detit.
- 10 Nde dashtë të prishnjë, e të mbyllnjë,  
A të thérresë ndë gjyq, atëhere cili munt  
t'a ndallonjë atë?
- 11 Sepse ay njeh kotësirën' e njerësvet,  
Sheh edhe paudhërinë, ndonëse duketë se  
s'e vë re.
- 12 Po njeriu i-kotë nukë ka kupëtim,  
Po, njeriu l'int posa visku i-egrë.
- 13 Ti ndë ndreqç zëmërënë t' ënde,  
Edhe të ndejsh duart' e tua tek ay;
- 14 Ndë mërgofsh paudhërinë që është ndër  
duart të tua,  
Edhe të mos lësh të rrijë paudhëri ndër  
tendat të tua;
- 15 Pa fjalë atëhere dotë ngresh faqenë t' ënde  
pa njollë;  
Po, dotë jesh i-siguruarë, edhe nukë dotë  
kesh frikë;
- 16 Sepse dotë harronjç mjerësinë t' ënde;



- Dot' e kujtonjç *atë* posi ujëratë që rrothnë;
- 17 Edhe jeta *jote* dotë linnijë më e-nđriturë se mes-dita;
- Edhe* ndë qoftë errësirë, dotë bënëtë posi mëngjezi.
- 18 Edhe dotë jesh i-siguruarë, sepse ke shpresë;  
Po, dotë vëshgosh *rrotullë teje*, edhe dotë prëhesh ndë siguri.
- 19 Edhe dotë bjesh të flesh, edhe asnjeri nukë dotë të trëmpnjë;  
Po, shumë veta dotë jenë pas teje.
- 20 Po syl' e të-liqvet dotë fyshkenë,  
Edhe pshtetje nukë dotë ketë për ata,  
Edhe shpresa e atyre dotë jetë të-dhënët' e shpirtit.


## Krye 12

- 1 Atëhere Jobi upërgjeq e tha,
- 2 Me të-vërtetë ju jeni një gjindje,  
Edhe dituria dotë vdesë bashkë me ju.
- 3 Po edhe unë kam mënt sikundrë edhe ju;  
Nukë jam m' i-poshtërë se ju;  
Po, cili nukë di të-këtilla gjer'ra si këto?
- 4 Ubësë si njeri që bënëtë qesëndi te i-afërm i ti,  
*Njeri* që thërriti mbë Perëndinë, edhe i upërgjeq:  
I-drejti, njeriu i-mbaruarë, përqeshetë.
- 5 Ndë mendimt të fatmirit ka çnderim përfatkeqërinë;



Ky çnderim është i-gatishim për ata që u shket këmba.

- 6 Tendat' e kursarëvet venë 'mbarë,  
Edhe ata që zëmëronjënë Perëndinë janë  
ndë siguri;  
Nde duart të këtyreve Perëndia ep me të-  
plotë.
- 7 Po pyet tashi shtëzëtë, edhe dotë të mëso-  
njënë;  
Edhe shpest' e qiellit, edhe dotë të rrëfenjënë;
- 8 Ndo fol'-i dheut, edhe dotë të mësonjë;  
Edhe pishqvet të detit, edhe dotë të tregonjënë.
- 9 Cili nga të-gjithë këta nuk' e di,  
Se dora e Zotit e ka bërë *gjithësinë?*
- 10 Ndë dorët të të-cilit është shpirti i çdo-  
gjëje së-gjallë,  
Edhe fryma e gjithë njerëzisë.
- 11 Veshi a nukë çquan fjalëtë,  
Sikundrë qiellëza ndjen shijën' e gjellësë?
- 12 Bashkë me pleqtë është dituria,  
Edhe ndë të-gjatët të ditvet urtësia.
- 13 Me *Perëndinë* është dituria e fugia;  
Ay ka këshillë e urtësi.
- 14 Na tek prish, edhe *e-prishura* s' ndërtonetë  
përsëri;  
Mbyll kundrë njeriut, edhe s' ka të-hapurë.
- 15 Na tek mban ujëratë, edhe thahenë;  
Përsëri i lëshon ato, edhe përmbysnjënë  
dhenë.



- 16 Me atë është fuqia e dituria e-shëndoshë;  
I ati është *edhe* ay që gënjenetë edhe ay  
që gënjen.
- 17 I shpie këshillëtarëtë të-sveshurë,  
Edhe gjykatësit' i godit me marrësi.
- 18 Sgith brezin' e mbretërvet,  
Edhe ngjesh mezin' a atyre me litar;
- 19 I shpie priftëritë të-sveshurë,  
Edhe përbys të-fortëtë.
- 20 U mbyll gojënë të-fortëvet *ndë fjalë*,  
Edhe ngre mëntë nga pleqtë.
- 21 Derth çnderim mbi të-parët,  
Edhe sgith brezin' e të-fortëvet.
- 22 Çfaq punëra të-thella nga errësira,  
Edhe bje ndë dritë hijen' e vdekjesë.
- 23 Madhon kombetë, edhe i prish ata;  
Sgjeron kombetë, edhe i rruth ata.
- 24 Heq zëmërënë nga krerët' e gjindjevet të  
dheut,  
Edhe i bën ata të sillen' andej e këtej ndë  
shkretëtirë që s' ka udhë.
- 25 Kërkonjënë me dorë ndë t' errët pa dritë,  
Edhe i bën ata të bjen' andej e këtej si i-  
dejturi.

### Krye 13.

- 1 Na tek m' i pa syri *këto* të-gjitha,  
Veshi m' i dëgjoj, edhe i kupëtova.
- 2 Atë që dini ju, e di edhe unë;



- Nukë jam m' i-poshtërë se ju.
- 3 Me të-vërtetë dot' i flas Fuqimadhit,  
Edhe dëshëronj të kuvëndonj bashkë me  
Perëndinë.
- 4 Po ju jeni çpifës gënjeshtash;  
Të-gjithë jeni mjekës të-padobishim.
- 5 Makar të pushonitë fare!  
Edhe këjo dot' ishte urtësi ndër ju.
- 6 Pa dëgjoni mendimet' e mi,  
Edhe mba-u-ni vesh të-mbrojturavet të bu-  
zëvet të mia.
- 7 A dotë flisni me paudhëri për Perëndinë,  
Edhe dotë flisni gënjeshtra për atë?
- 8 Apo dotë nderoni vetën' e atij,  
E t' i mbani anë Perëndisë?
- 9 A është mirë t' u vëshgonjë juve?  
Apo dot'a përqeshni atë, sikundrë përqesh  
njeriu njerinë?
- 10 Me të-vërtetë dot' u qërlonjë iuve,  
Ndë u mbajçi anë njerësvet fshehuraj.
- 11 Madhëria e atij a nukë dot' u trëmpnjë juve?  
Edhe tmeri i atij a nukë dotë bjerë mbi ju?
- 12 Fjalëtë t' uaj të-shënuarshime janë fjalë  
pluhuri;  
Fortesatë t'uaj janë posi fortesa balte.
- 13 Pushoni, lër-më-ni që të flas unë,  
Edhe letë vinjë mbi mua ç' të dojë.
- 14 Përse të marr mishinë t' im ndër dhëmbë,  
Edhe të vë jetënë t' ime ndë dorët t' ime?



- 15 Ndonëse më vret, unë prapë shprenj mb' atë;  
Po me gjithë këto dotë mbronj udhët' e mia  
përpara ati.
- 16 Edhe këjo dotë jetë shpëtimi im;  
Sepse i-pabesë njeri s' ka për t' ardhurë  
përpara ati.
- 17 Dëgjoni me kujdes fjalënë t' ime,  
Edhe rrëfimi im letë jetë ndër veshët t' uaj.
- 18 Na tashi tek radhita gjyqinë t' im;  
E di se dotë dal i-drejtë.
- 19 Cili ësht' ay që dotë flasë kundrë meje?  
Sepse, ndë pushofsha, dotë ap-frymënë t'ime..
- 20 Vetëmë dy gjër'ra mos më bëj,  
Edhe atëhere nukë dotë fsheh. vetëhenë  
t'ime nga faqeja jote;
- 21 Mërgo dorënë t' ënde prej meje,  
Edhe tmeri yt letë mos inë trëmpnjë.
- 22 Pastaj thirr-më, edhe unë dotë përgjigjem;  
Apo letë flas unë, edhe ti m' upërgjiq.
- 23 Sa janë paudhërit' e mia e fajet' *e-mi?*  
Bë-më të njoh paudhërinë t'ime e fajnë t' im..
- 24 Përse fsheh faqenë t' ënde,  
Edhe mua më numëron posi armik mbë ty?"
- 25 Dotë mundonjç një fletë që e merr *era?*  
Edhe dotë ndjeksh kashtën' e-thatë?
- 26 Sepse shkruan ger'ra të-hidhura kundrë meje..  
Edhe më bën të trashëgonj paudhërit' e të-  
ritit t' im;



- 27 Më vë edhe këmbëtë ndër vargje *hekurash*,  
edhe përgjon gjithë udhët' e mia.  
Edhe heq vijë rrëth gjurmavet të këmbëvet  
të-mia;
- 28 Ndonëse jam si gjë e-kalbëtë që vdiretë,  
Si rrobë e-brejturë nga molica.

## Krye 14

- 1 Njeriu që ka lindurë prej gruaje  
Është jetë-shkurtërë edhe plot me turbullim.
- 2 Mbin posi lule, edhe këputetë;  
Ikën posi hie, edhe nuk' është më.
- 3 Edhe mbë të-tillinë hap syt' e tu,  
Edhe më bje mbë gjyq me ty?
- 4 Kush munt të nxjerrë gjë të-pastrëtë nga  
e-papastrëta? Asnjëri.
- 5 Sepse ditt' e ati janë të-ndara, numëri i mu-  
ajvet t' ati gjëndetë te ti,  
Edhe ti ke vënë sinorët' e ati të-cilëtë s'  
munt t' i kapërxenjë;
- 6 Hiq syt' e tu lart prej ati, që të prëhetë,  
Gjersa të mbushnjë ditën' e ti dyke ugëzuarë  
posi një i-pajtuarë.
- 7 Sepse për drurinë, ndë upreftë, ka shpresë  
të lëshonjë përsëri,  
Edhe dega e-njomë e ati të mos pushonjë,
- 8 Ndonëse rrënja e ati mblaketë ndë dhet,  
Edhe kurmi i ati vdes ndë baltët,
- 9 Prapë dyke marrë erë uji dotë çelnjë,



- Edhe dotë lëshonjë dëga posa bim' e-re.
- 10 Po njeriu vdes, edhe humbetë;  
Po, njeriu ep frymënë, edhe ku është?
- 11 Si mehenë ujëratë nga deti,  
Edhe lumi shtron e thahetë,
- 12 Kështu njeriu fle e nukë ngrihetë *më*;  
Gjersa të mos jenë qiejtë, nukë dotë sgjo-nenë,  
As dotë ngrihenë nga gjumi i tyre.
- 13 Makar të më fshehnje ndë varrt,  
*E* të më mbulonje, gjersa të shkonte zë-mërimi yt,  
Të më kishe ndarë një kohë, edhe *atëhere*  
të më kujtonje!
- 14 (Ndë vdektë njeriu, a dotë ngjalletë përsëri?)  
Gjithë ditt' e luftësë s' ime dotë prisnja,  
Gjersa të vinte të-liruarëtë t' im (\*).
- 15 Dotë thërritnje *ti*, edhe unë dotë të përgjigjeshe;  
Dotë kishe mall për punën' e duarvet të tua.
- 16 Po tashi ti numëron çapet' e mi;  
A nukë përgjon fajnë t' im?
- 17 Të-dalëtë t' im jashtë *nomit* është të-vulosurë ndë kuletë,  
Edhe paudhërinë t' ime e shënon përsipërë.
- 18 Me të-vërtetë mali, kur bje, bënetë asgjë,  
Edhe shkëmbi luan prej vëndit të ti;
- 19 Ujëratë hanë gurëtë;
- (\*) a: të-ndërruarëtë t' im.



- Vërshimet' e atyre heqënë dhenë nga toka;  
*Kështu* edhe ti prish shpresën' e njeriut.
- 20 Del pérherë m' i-fortë kundrë atij, edhe ay shuhetë;  
 Ndërron ftyrën' e ati, edhe tej e dërgon.
- 21 Të bijt' e ati lartonenë ndë ndër, edhe ay nuk' e di;  
 Edhe turpëronenë, edhe nukë kupëton asgjë pér ata.
- 22 Po mishi i atij mbi atë dhëmb,  
 Edhe shpirti i ati pérbrënda ati bën vajë.

### Krye 15

- 1 Atëhere upërgjeq, Elifaz Themaniti e tha,  
 2 A gjan njeriu i-urtë të përgjigjetë me dituri të-kotë,  
 Edhe të mbushnjë barkun' e ti me erë të anësë që lint djelli?
- 3 A gjan të zihetë me fjalë të-padobishime,  
 A me fjalë që nukë sjellënë ndonjë të-mirë?
- 4 Po, ti heth tej frikënë,  
 Edhe s'e zë pér gjë lutjenë pérpara Zotit.
- 5 Sëpse paudhëria jote mëson gojënë t' ende,  
 Edhe s gjeth gjuhën' e dinakëvet.
- 6 Goja jote të dënon ty, e nuk' unë;  
 Po, buzët' e tua dëshmonjënë kundrë teje.
- 7 Mos je ti i-pari njëri që je lindurë?  
 Apo mos ugatove ti pérpara malevet?
- 8 Apo mos ke dëgjuarë këshillën' e-fshehëtë  
 të Perëndisë?



- Edhe e pëngon diturinë *vetëmë* ndë vetëhet t' ënde?
- 9 Ç' di ti, e nuk' e dimë na?  
Ç' kupëton ti, e neve s' e *kupëtojmë*?
- 10 Gjëndenë *edhe* ndër ne lesh-thinjurë e pleq të lashtë,  
Shumë më pleq se yt atë.
- 11 Pun' e-vogëlë të dukenë ngushëllimet' e Pe-rëndisë,  
Edhe fjalëtë që të flitenë me ëmblësirë?
- 12 Përse të gënjen zëmëra jote?  
Edhe përse veshtrojnë shtrëmbërë *syt'* e tu,
- 13 Kaqë sa kthen frymënë t' ënde kundrë Pe-rëndisë,  
Edhe lë të dalënë të-këtilla fjalë prej gojësë s' atë?
- 14 Ç' është njeriu, që të jet' i-kthjellëtë?  
Edhe ay që është lindurë prej gruaje, që të jet' i-drejtë?
- 15 Na tek nuk' u zë besë shënjtorëvet të ti;  
Po, *edhe* qiejtë nukë janë të-kthjellëtë ndë *syt'* t' ati.
- 16 Sa më tëpërë eshtë i-ndryr' e i-prishurë  
Njeriu, ay që pi paudhërinë posi ujë!
- 17 Unë të kam për të mësuarë, dëgjo-më;  
Edhe atë që kam parë dot'a rrëfenj;
- 18 (Atë që njerës të-diturë na e rrëfyenë  
· Nga atërit' e tyre, edhe nuk' e fshehnë;
- 19 Vetem' atyreve udha *ky* dhe,



Edhe i-huaj nukë ka shkuarë ndëpër mest t' atyre;)

- 20 "Njeriu i-lik mundonetë gjithë ditt' e tij,  
Edhe vjet të numëruarë janë ruajturë për tyraninë.
- 21 Gjamë frikërash është ndër veshët t' ati;  
Ndë mest të paqtimit dotë vinjë prishësi mbi atë;
- 22 Nukë beson se dotë kthenetë nga t' errëtitë,  
Edhe pret thikënë;
- 23 Silletë andej e këtej për bukë, *dyke thënë,*  
Ku ka?  
Di se dit' e t' errëtit është gati afër' atij.
- 24 Shtrëngim e acarim e bënjënë atë të ketë frikë;  
Dalënë më të-fortë se ay, posi një mbret q' është bërë gati për luftë;
- 25 Sepse ndeji dorën' e ti kundrë Perëndisë,  
Edhe usuall me madhështi kundrë Fuqimadhit;
- 26 Turretë kundrë ati me qafë *të-ngriturë*,  
Me kurrizët' e-trashë të mburonjavet të ti;
- 27 Sepse mbuloj faqen' e ti me të-majmit' e ti,  
Edhe majti fort tepërë brinjët' e ti;
- 28 Edhe ndënji ndë qytete të-shkretuarë,  
Ndër shtëpira që s' rrinte njeri,  
Të-cilatë ishinë për të urrezuarë togje togje.
- 29 Nukë dotë jet' i-pasurë, as dotë mbesë pasja e ati,



- As dotë sgjeronetë tē-plotët' e atyre mbi dhet.
- 30 Nukë dotë ndahetë nga errësira;  
Flaka dot' i thanjë degat' e ati,  
Edhe me frymën' e gojës' së ti dotë shuhetë.
- 31 Letë mos i apë besë kotësirësë, dyke gë-  
nnyerë vetëhenë;  
Sepse kotësirë dotë jetë paga e atij.
- 32 Përpara kohës' së ti dotë vdiretë,  
Edhe dega e ati nukë dotë gjethësonjë.
- 33 Dotë shkuntnjë rrushin' e tij tē-paarrirë posì  
vreshti,  
Edhe dotë hedhë lulen' e tij posì ulliri.
- 34 Sepse përbledhja e tē-pabesëvet dotë jetë  
shterpë,  
Edhe zjarri dotë përvëlonjë tendat' e nje-  
rësvet *të-prishurë*.
- 35 Mbarsenë tē-keqe, e pjellënë kotësirë,  
Edhe bärku i atyreve bën gati gabim.,,

### Krye 16.

- 1 Atëhere Jobi upërgjeq, e tha,  
2 Kam dëgjuarë shumë tē-këtilla;  
Të gjithë jeni ngushëllimtarë tē-mjerë.
- 3 A kanë funt fjalët' e-kota?  
Apo ç' gjë tē ep zëmërë që tē përgjigjesh?
- 4 Edhe unë muntnjam tē flisnjam posì ju;  
Po tē ishte shpirti juaj ndë vëntt tē shpir-  
lit t' im,  
Dôte muntnjam tē grumbullonjam fjalë kun-  
drë jush,



- Edhe të tundnjam kryetë t' im kundrë jush.
- 5 Po nukë; dot' u ipnjam fuqi juve me gojënç  
t' ime,  
Edhe të-lëvizurit' e buzëvet të mia dot' u  
lehtësonte.
- 6 Ndë folça, të-dhëmburitë t' im nukë lehtë-  
sohetë;  
Edhe ndë pushofsha, mos dotë më pakë-  
sonctë?
- 7 Po tashi më rëndoij fort;  
Shkretove tërë fëmijënë t'ime.
- 8 Edhe rrudhatë, me të-cilatë më shënove,  
janë dëshmim *kundrë meje*,  
Edhe të-liguritë t' im ngrihetë *kundrë meje*,  
e dëshmon ndë faqet t'ime.
- 9 Më copëtoj ndë zëmërimit të ti, edhe më  
ndoqi;  
Kërcëlliti dhëmbët' e ti kundrë meje;  
Armiku im mbreh syt' e ti mbi mua.
- 10 Hapnë gojën' e tyre kundrë meje;  
Me rrahnë ndë faqet dyke sharë;  
Umblohnë bashkë kundrë mejë.
- 11 Perëndia më dha ndë dorët të të-pabesit,  
Edhe më hodhi ndë duart të të-ligut.
- 12 Isha ndë prëje, edhe më copëtoj;  
Po, më zuri nga sverku, e më dërrmoj;  
Edhe më vuri për shënjë të tij.
- 13 Shëgjetarët' e ati më qërtëllonjënë;



Depérton veshnjat' e mia, edhe nukë kur-senetë;

Derth t' émblëthitë t' im mbi dhet.

14 Më dërrmon me plagë përmbi plaqë;  
Turretë mbi mua posa gjigant.

15 Qepa rrobë thesi mbi lëkurënë t' ime,  
Edhe fuliqë bririnë t' im ndë mbluhur.

16 M' uçkuq faqeja nga të-qarëtë,  
Edhe mbi qepalat të mia është hie vdekjeje,

17 Ndonesë nukë ka ndonjë shtrëmbëri ndë  
duart të mia,  
Edhe lutja ime ësht' e-kthjellëtë.

18 O dhe, mos mbulojsh gjakunë t' im,  
Edhe mos pastë vënt për klithmënë t' ime.

19 Edhe tashi, na dëshmimtari im tek është  
ndë qiell,  
Edhe ay që dëshmon për mua ndër të-lartat.

20 Miqt' e mi më përqeshnjënë;  
*Po syt' e mi derthnjënë lot te Perëndia.*

21 Të muntte të gjykonej ndonjë me Perëndinë,  
Posi njeriu me t' aférmin' e tij!

22 Sepse, passi të shkonjënë ca pak vjet,  
Dotë shkonj asaj udhe, prej së-cilësë s' jam  
për të kthyerë më.

### Krye 17.

1 Fryma ime vdiretë, ditt' e mia shuhënë,  
Varri eshtë hapurë për mua.



- 2 Më të-vërtetë ka përqeshës afërë meje,  
Edhe syri im shkon natënë ndër hidhëri-  
mët *prej* atyreve.
- 3 Ep tashi një penk, bëj-m'-u dorëzënës pë-  
ranë vetëhesë s' ate;  
Cili ësht' ay që dotë bënetë dorëzënës për  
muat?
- 4 Sepse ti e fshehve zëmërën' e atyre nga  
kupëtimi;  
Përandaj, nukë dot' i lartojsh ata.
- 5 T' ati që kallëzon miqt' e ti *që të bënenë rrëmullë*,  
Edhe syt' e bijvet t' ati dotë tretenë.
- 6 Më bëri edhe përrallëzë të gjindjevet;  
Edhe ubëshë i-atillë, ndë faqet të të-cilit  
pshtynjënë.
- 7 Edhe syri im errësonetë nga hidhërimi,  
Edhe gjithë anët' e trupit t' im ubënë posr  
hie.
- 8 Njerëzit' e-drejtë dotë çuditenë mbë këtë,  
Edhe i-pafajmi dotë ngrihetë kundrë të-  
pabesit.
- 9 Edhe i-drejti dotë qëndronjë ndë udhët të ti,  
Edhe ay që ka duar të-pastrëta dotë bënetë  
i-fortë e m' i-fortë.
- 10 Po ju të-gjithë kthehuni *këtu*, edhe ejani  
tashi;  
Edhe s' kam për të gjeturë ndonjë të-urtë  
ndër ju.




- 11 Ditt' e mia shkuanë; qëllimet' e mi upér-nibysnë;  
Po, mendimet' e zémérésë s'ime.
- 12 E kthenjënë natënë ndë ditë;  
Drita, *thonë*, është afërë errësirësë.
- 13 Ndë pres vərrinë si shtëpinë t'ime;  
Ndë kam shtruarë shtratinë t' im nd' errësirët;
- 14 Ndë i kam thënë errësirësë, Ti je im atë;  
Krymbit, *Ti je* mëma ime, edhe motëra ime,
- 15 Atëhere ku është shpresa ime?  
Edhe shpresënë t'ime kush dot'a shohë?
- 16 Dotë sbresë ndë dyert të varrit,  
Vërtet dotë prëhetë bashkë *me mua* ndë-varrt.

## Krye 18.

- 1 Atëhere Bildad Shuhiti upërgjeq, e tha,
- 2 Gjer kur dotë vini (dhokanë ndë vëntt tefjalëvet?  
Vini re, edhe pastaj dotë flasëmë:
- 3 Përse numëronemi posi shtëzë,  
Edhe ubëmë të-ndyrë përpara jush?
- 4 O ti që çqyen vetëhenë ndë zémërimt t'ënt,  
Mos për ty dotë lihetë mbë nj'anë dheu?  
A mos dotë luhetë shkëmbi nga vëndi i ti?
- 5 Me të-vërtetë drita e të-liqvet dotë shuhetë,  
Edhe shkëndia e zjarrit t'atij nukë dotëndrinjë.



- 6 Drita dotë jetë errësirë ndë tendët t' ati;  
Edhe kandileja e atij që përsipër' atij dotë shuhetë.
- 7 Çapet' e fuqis' s' ati dotë shkurtonenë,  
Edhe këshilla e atij dot'a rrëzonjë atë.
- 8 Sepse ra ndë rrietë me këmbët' e tia,  
Edhe ecën mbi leqt.
- 9 Dhohan dot'a zërë atë prej thëmbërësë,  
Edhe kurth dot'a mbanjë atë.
- 10 Dhokan është fshehurë për atë ndë dhet,  
Edhe pritë për atë ndë udhët.
- 11 Trishtime dot'a frikësojn' atë nga çdo anë,  
Edhe dot'a ndjekënë pas këmbësh.
- 12 Fuqia e ati dotë humbasë nga uria,  
Edhe mjerësia dotë jetë gati ndë ijët t' ati.
- 13 Dotë hajë anët' e trupit t' ati,  
Po, i-parëlinduri i vdekjesë dotë hajë anët'  
*e trupit t' ati.*
- 14 Dotë çkuletë nga tenda e tij ndë të-cilët  
ka besimn' e ti;  
Edhe dotë bihetë te mbreti i trishtimevet.
- 15 Dotë rrinë ndë tendët t' ati, e-cila nuk' është më e ati;  
Shqyfur dotë çpërndahetë mbi të-ndënjurit t' ati.
- 16 Që përposh dotë thahënë rrënjët' e ati,  
Edhe përsipërë dotë fishketë dega e ati.
- 17 Kujtimi i ati dotë shuhetë nga dhëu,  
Edhe nukë dotë këtë emër ndëpër udhët.



- 18 Dotë nxirretē prej dritësē nd' errësirët,  
Edhe dotë përziretë prej bolësë.
- 19 Nukë dotë ketë as bir as bir biri ndë mest  
të gjindjes' së ti,  
As të-mbeturë ndër të-ndënjurat të ti.
- 20 Të-pastajmitë dotë habitenë pér ditën' e  
*prishjes' s'* ati,  
Sikundrë udrothnë ata që qenë përpara 4-  
tyreve.
- 21 Me të-vërtetë të-këtilla janë të-ndënjurat' e  
të-ligut,  
Edhe ky është vëndi i ati që s' njeh Perëndinë.

### Krye 19.

- 1 Atëhere Jobi upërgjeq, e tha,
- 2 Gjer kur dotë më helmoni shpirtinë,  
Edhe dotë me dërrmoni ·me fjalë?
- 3 Këto të dhjetë herë më keni sharë;  
Nukë turpëroni të silleni *kaqë* ashpërë me  
mua?
- 4 Edhe ndë lajthita me të-vërtetë,  
Lajthitja ime mbetetë tek unë.
- 5 Ndë doni me të-vërtetë të madhërohi kun-  
drë meje,  
Edhe të hithni kundrë meje turpërinë t' ime,
- 6 Merrni vesh tashi se Perëndia më përbysë,  
Edhe më qerthëlloj me rrietën' e ti.
- 7 Na tek po thërrës nga paudhëria, po s' më  
dëgjon njeri;



- Thérres për ndihmë, po s' ka gjyq.
- 8 Thuri udhenë t'ime, edhe s' munt të shkonj,  
Edhe vuri errësirë ndë rrugat të-mia.
- 9 Më sveshi lavdinë,  
Edhe më mori kurorënë nga kryetë.
- 10 Më prishi nga të-gjithë anëtë, edhe po shkonj;  
Edhe shpresënë t'ime e shkuli posi një'dru.
- 11 Ndezi kundrë meje zëmërimn' e ti,  
Edhe më numëron posi, *ndonjë* nga kundrështarët' e ti.
- 12 Ushtërit' e ati vinjënë bashkë, edhe bënjenë  
gati udhën' e tyre kundrë meje,  
Edhe ngulnjënë fushatënë rreth e rrotullë  
tendësë s'ime.
- 13 Mërgoj t' im vëllezër lark prej meje,  
Edhe të-njohurit' e mi m' ubënë fare të-huaj.
- 14 Far' e fisi imë *m* lanë,  
Edhe miqt' e shtëpisë s'ime më harruanë.
- 15 Ata që rrinë ndë shtëpit t'ime, edhe shërbëtoret' e mia, më numëronjënë për të-huaj;  
Jam i-huaj ndë syt t'atyre.
- 16 I thérres shërbëtorit t' im, e nukë më përgjigjetë,  
*Ndonëse* i lutem me gojënë t'ime.
- 17 Fryma ime ubë e-huaj tek ime shoqe;  
Edhe të-luturat' e mia te bijt' e barkut t'im:
- 18 Edhe ata djemt' e-vegjëllë më muarrë ndë-për këmbë;



Ndë daça të ngrihem, dotë flasënë kundrë meje.

19 Gjithë miqt' e mi të-përbrëndëshm më kanë të-ndyrë,

Edhe ata që kam pasë dashurë ukthyenë kundrë meje.

20 Eshtërat' e mia më ngjitenë pas lëkurës' e pas mishit,

Edhe shpëtova me lekurën' e dhëmbëvet të mi.

21 Përdëlle-më-ni, përdëlle-më-ni, o miqt' e mi;

Sepse dora e Perëndisë më plagosi.

22 Përse më ndiqni si Perëndia,

Edhe nukë jeni të-kënaqurë me mishinë t' im?

23 Oh sikur të shkruheshinë fjalët' e mia!

Edhe të shtypeshinë ndë një vivli!

24 Me pëndë të-hekurtë e me plump

Të gërvishëtëshinë mbi shkëmpt për gjithënë!

25 Po e di se rron Çperblimtari im,

Edhe se më ndë funt dotë ngrihetë mbi dhet;

26 Edhe passi të vdiretë ky (kurm) bashkë me lëkurënë t' ime,

Prapë prej mishit t' im dot'a shoh Perëndinë;

27 Të-cilinë unë vetë dot'a shoh,

Edhe syt' e mi dot'a shikonjënë, e jo tjetër. . . . .



Veshnjat' e mia po treienë pérbrënda meje,,  
*dyke dëshëruarë atë dltë.*

- 28 Ndë thoni, Si t'a ndjekëm' atë,  
 Edhe të gjejmë tek ay rrënjen' e punës'  
 s' ati?
- 29 Kini frikë prej kordhësë;  
 Sepsë zëmërimi *sjell* mundimet' e kordhësë.,  
 Që të nijhni se ka gjyq,

**Krye 20.**

- 1 Atëhere upërgjeq Zofar Naamathiti, e tha.,
- 2 Përandaj mendimet' e mi më shtynjënë të  
 ap përgjigje,  
 Edhe përandaj nxitonem.
- 3 E dëgjova qërtimnë që më bën të turpë-  
 ronem,  
 Po prej të-kupëtuarit t' im fryma më bën.  
 të përgjigjem.
- 4 A nuk' e di ti këtë që qëmoti,  
 Që kur uvu njeriu mbi dhet,
- 5 Se triomfi i njerësvet të-liq ësht' i-shkur-  
 tërë,  
 Edhe gjëzimi i të-pabesëvet për një të-  
 fillme?
- 6 Ndonëse madhëria e ati *munt të* hipënjë gjer  
 ndë qiejt,  
 Edhe kryet' e ati të arrinjë gjer ndë ret,
- 7 Prapë dotë humbasë për gjithënjë posi  
 plehët' e ati:



- Ata që e kanë par' atë dotë thonë, Ky  
ësht' ay?
- 8 Dotë fluturonjë posi ëndërrë, edhe nukë  
dotë gjëndetë *më*;  
Edhe dotë humbasë posi të-pamët' e natësë..
- 9 Syri që e shihte atë s' e ka për të parë më;  
As vëndi i ati s' e ka për të njohurë më.
- 10 Të bijt' e zti dotë kërkonjënë dashurin' e-  
të-vobeqvet,  
Edhe duart' e ati dotë apënë prapë pasjen'  
e ti.
- 11 Eshtërat' e ati janë plot me djalërin' e ati.,  
Po dotë dergjetë bashkë me atë ndë plu-  
hurt.
- 12 Ndonëse ligësia është e-embëlë ndë gojët  
t' ati,  
Ndonëse e fsneh atë ndënë gjuhët të ti;
- 13 Ndonëse e kursen atë, edhe nuk' e lë atë  
të shkonjë,  
Po e ruan atë brënda ndë gojet të ti;
- 14 Prapë ushqimi i ati ndërronetë ndë zorrët-  
t' ati;  
Vërer aspidhash bënetë përbrënda ati.
- 15 Pasjetë që kollofiti dot' i vjellë prapë;  
Perëndia dot' i çkitnjë ato nga barku i ati..
- 16 Vërer aspidhash dotë thëthnjë;  
Gjuha e nepërkësë dot'a vrasë atë.
- 17 Nukë dotë shohë lumënjtë,  
Rrëketë që rrjedhënë mjaltë e gjalpë.
- 18 Atë *gjë*, për të-cilën' umundua, dot'a apë-



- prapë, edhe nukë dot'a kollofitnj' atë;  
 Sipas pasjesë që fitoj nukë dotë gëzonetë.
- 19 Sepse shtrëngoj të-vobegun' e hoqi dorë  
 prej ati;  
 Rrëmbëu me paudhëri shtëpi,  
 Të-cilënë s' e ka pasë ndërtuarë.
- 20 Me-qënë-që nukë njoju të-prejturë përbrën-  
 da tij,  
 Nukë dotë shpëtonjë asgjë nga ato, të-ci-  
 latë dëshëron.
- 21 Nukë mbeti asgjë që s' e kollofiti;  
 Përandaj lumëria e ati nukë dotë mbanjë  
*shumë kohë*.
- 22 Ndë shumicët të të-plotit t' ati dotë jetë  
 ndë shtrëngime;  
'Dora e çdo *njeriu* që është ndë mjerësi  
 dotë vinjë mbi atë.
- 23 Tek bënetë gati përtë mbushurë barkun' e ti,  
*Perëndia* dotë lëshonjë ashpërimn' e zëmë-  
 rimit të ti mbi atë,  
 Edhe posi shi dot'a lëshonjë mbi atë, tek  
 është dyke ngrënë.
- 24 Dotë ikënëjë nga arm' e-hekurtë,  
 Edhe harku i-ramtë dot' e depërtonjë.
- 25 E heq atë, edhe del nga trupi i ati,  
 Po, maj' e-çkëlqyerë del nga t'ëmblëthit' e  
 ati;  
 Trishtime *vdekjeje* janë mbi atë.
- 26 Çdo errësirë është ruajturë për thesarët' e ati;  
 Zjarr që s' i fryn *njeri* dot'a hajë atë;



- Dotë djegë çdo që ka mbeturë ndë tendët t' ati.
- 27 Qiejtë dotë shulonjënë paudhërin' e ati,  
Edhe dhei dotë ngrihetë kundrë ati.
- 28 Té-ardhurat' e shtëpis' s' ati dotë humbasënë;  
Ndë ditët të zëmërimit kundrë ati dotë rrriedhënë.
- 29 Këjo është pjesa e njeriut të-lik nga Perëndia,  
Edhe trashëgimi i-urdhëruarë për atë nga an' e Perëndisë.

### Krye :21

- 1 Atëhere Jobi upërgjeq e tha,  
2 Dëgjoni me kujdes fjalënë t' ime;  
Edhe këjo letë jetë për ngushullimi hë t' uaj.
- 3 Duro-më-ni, edhe dotë flas edhe unë;  
Edhe passi të flas, përqeshni.
- 4 Unë mos i rrëkonem njeriu?  
Edhe si munt të mos jemi i-paduruuarshim?
- 5 Vështroni mua, edhe çudituni,  
Edhe vini dorënë mbi gojët l' uaj.
- 6 Vetëmë të kujtonem, dridhem,  
Edhe tmer më pushton mishtë.
- 7 Përse të-liqtë rrunjënë,  
Mblakenë, e bënenë të-fortë ndë fuqi?
- 8 Fara e atyreve forconetë përpara atyreve  
bashkë me ata,  
Edhe nipërit' e atyreve përpara atyreve.



- 9 Shtëpit' e atyre janë ndë siguri nga frika,  
As ka shkop Perëndie mbi ata.
- 10 Lop' e atyreve mbarsetë; edhe nukë lajthit;  
Mëshqerra e atyre pjell, edhe nukë dështon.
- 11 Lëshonjënë të-vegjëlit' e tyre posi dhën,  
Edhe djemt' e atyre këcenjënë.
- 12 Këndonjënë me tymbanë e me qitharë,  
Edhe gëzonenë ndë zët të fyellit.
- 13 Shkonjënë ditt' e tyre ndër të-mira,  
Edhe përnjëhere sbresënë ndë varrt.
- 14 Edhe me gjithë këto i thanë Perëndisë,  
Largohu prej nesh;  
Sepse nukë duamë të njohëmë udhët' e tua.
- 15 Cili është Fuqimadhi që t'i shërbejmë ati?  
Edhe ç'dobi dotë kemi, dyke ulutur' ati?
- 16 *Ju thoni*, Na, nukë janë të-mirat' e atyreve  
ndë dorët t' atyre.  
(Këshilla e të-liqvet qoftë lark prej meje!)
- 17 *Sa dëndurë* shuhetë kandili i të-liqvet,  
Edhe prishja e atyreve vjen mbi ata,  
Edhe *Perëndia* çpérndan ndër ata helme ndë  
zëmërimt të ti?
- 18 *Sa dëndurë* janë posi kashtë përpara erësë,  
Edhe posi byk që e rrëmben er' e shakullit?
- 19 *Ju thoni*, "Perëndia ruan *mundimin'* e pau-  
dhëris' s' ati për të bijt' e ati.."  
Po let' j'a çpaguanjë vetë ati, që t'a dijë.
- 20 Letë shohënë syt' e ti prishjen' e ti,  
E letë pijë *vetë ay* nga zemërata e Fuqi-  
madhit.



- 21 Sepse ç' farë gjëzimi ka i-ligu ndë shtëpit  
të tij pas vetëhes' së ti,  
Kur t'i këputetë ndë mest numëri i muaj-  
vet t' ati?
- 22 A dot' e mësonjë mënt ndonjë Perëndinë,  
Atë që gjykon të-lartëtë?
- 23 Njëri vdes ndë fuqit të ti të-plotë,  
*Ndonëse* është fat-mirë e i-prëjturë mbë të-  
gjitha.
- 24 Brinjët' e ati janë plot me dhjamë,  
Edhe eshtërat' e ati njomenë me palcë.
- 25 E tjetëri vdes ndë hidhërimt të shpirtit,  
Edhe kurrë nukë ka parë *të-mirë*.
- 26 Dergjenë gjithashtu ndë baltët,  
Edhe krymbatë mbulonjën' ata.
- 27 Na tek i di mendimetë t' uaj,  
Edhe të-çpifuratë që çpifni pa të-drejtë  
kundrë meje.
- 28 Sepse ju thoni, Ku është shtëpia e zotënisë?  
Edhe ku është tenda ndë të-cilët rrinë të-  
liqtë?
- 29 A nukë kini pyeturë ata që shkonjënë u-  
dhësë?  
Edhe shënjat' e atyre nuk' i kupëtoni,
- 30 Se i-ligu ruhetë ndë ditët të prishjesë?  
Se ndë ditët të zëmërimit bihetë lark?
- 31 Cili dotë çfaqnjë udhën' e ati përpara ati?  
Edhe cili dot' j'a çpaguanjë atij atë që ka  
punuarë?



- 32 Edhe ay dotë bihetë ndë gropët,  
Edhe dotë mbetetë ndë varrt.
- 33 Plisat' e fushësë dotë jenë të-ëmbëlë tek ay,  
Edhe prapa atij dotë shkonjënë gjithë nje-  
rëzitë,  
Sikundrë të-panumëruarë *njerës* prinjënë për-  
para ati.
- 34 Si pra më ngushëlloni me kotësirë,  
Kur ndë të-përgjegjurat t' uaj nukë mbe-  
tetë veç gënjeshtrë?

### Krye 22

- 1 Atëhere upërgjeq Elifas Themaniti, e tha,
- 2 A munt t' i bënë dobi njeriu Perëndisë?  
Me të-vërtetë ay që ësht' i-urtë esht' i-do-  
bishim për vetëhën' e ti.
- 3 A ka ndonjë gëzim te Fuqimadhi, se ti je  
i-drejtë?  
A ka ndonjë fitim *për atë*, se ti bën udhët'  
e tua të-mbaruara?
- 4 Mos për frikënë t' ënde të qërton,  
*E* hyn ndë gjyq bashkë me ty?
- 5 A nuk' ësht' e-madhe ligësia jote?  
As paudhëritë t' ënde nukë kanë funt.
- 6 Sepse more penge prej l' yt vëllaj pa ndo-  
një punë,  
Edhe i le pa rrobat' e tyre ata që ishinë  
lakuriq.
- 7 Nuk' i dhe ujë të-lodhurit, që të pijë,  
Edhe s'i dhe bukë ati që kishte uri.



- 8 Po sa për njerin' e-fortë, ay kishte dhenë  
të tinë,  
Edhe njeriu i-shënuarë rrinte nd' atë.
- 9 Grat' e-va i dëbove të-sbrazëta,  
Edhe krahët' e të-varfërvet udërrmuani prej  
teje.
- 10 Përandaj dhokanë janë rrëth e rrrotullë teje,  
Edhe frik' e-papandehurë të trëmp,
- 11 A errësir' e-thellë, sa nukë munt të shohç,  
Edhe vërshim ujërash të mbulon.
- 12 A nuk' është Perëndia ndë të-lartat të qiellit?  
Edhe vërë re të-lartët' e yjet, sa lart janë!
- 13 Edhe ti thua, Ç' di Perëndia?  
A munt të gjykonjë ndëpër errësirët të-  
dëndurë?
- 14 Re të-dëndura e mbulonjën' atë, edhe nukë  
sheh;  
Edhe ecën mbi vutët të qiellit.
- 15 Mos do të mbanjç udhën' e-moçimë,  
Të-cilënë kanë shkelurë të-liqtë?
- 16 Të-cilët' urrëinbyenë përpara kohësë,  
Edhe themelia e atyreve rrođhi posa rrëke;
- 17 Të-cilët' i thoshinë Perëndisë, Largohu prej  
nesh;  
Edhe, Ç' munt të bënjë Fuqimadhi për ne?
- 18 Po me gjithë këto *ju thoni*, U mbushi atyre  
shtëpitë me të-mira;  
(Po këshilla e të-liqvet qoftë lark prej meje!)
- 19 Të-drejtëtë 'shohënë, edhe gëzonenë;



- Edhe të-pafajmitë i përgesnjën' ata;
- 20 *Dyke thënë, Me të-vërtetë ata që ngriheshi-në kundrë nesh uprishnë,*  
*Edhe të-mbeturit' e atyreve e hëngri zjarri.*
- 21 Behu pra mik me atë, edhe ij ndë paqtim;  
*Kështu të-mirë dotë vinjë të ti.*
- 22 Prit, të lutem, nomnë prëj gojës' s' ati,  
*Edhe vërë fjalët' e ati ndë zëmërët t' ënde.*
- 23 Ndë ukthefsh te Fuqimadhi, dotë ndërtonesh  
*përsëri,*  
*Si të dëbonjç panominë lark prej tendavet të-tua:*
- 24 Hith thesarinë *t' ënt* ndë dhet,  
*Edhe arin' e Ofirit ndë mest të gurëvet të përrënjet,*
- 25 Edhe Fuqimadhi dotë jetë ari yt,  
*Edhe ergjënt i-paçëmuarë për ty.*
- 26 Sepse atëhere dotë gëzonesh mbë Fuqimadhinë,  
*Edhe dotë ngresh faqenë t' ënde mbë Perëndinë.*
- 27 Dot' i lutesh ati, e dotë të dëgjonjë;  
*Edhe dot' i apç kushtet' e tu.*
- 28 Edhe ç' të vendosç, dotë të bënetë,  
*Edhe dritë dotë ndritnjë ndë udhët të tua.*
- 29 Kur të *të* shtjenë poshtë, dotë thuash, Ka  
*të-ngriturë;*  
*Edhe atë që mban sytë poshtë dot'a shpëtonjë.*



- 30 Dotë shpëtonjë edhe atë që ësht' i-pafajm;  
Po, me anë të kthjellësirës' së duarvet të  
tua do'l'a shpëtonjë.

Krye 23.

- 1 Atëhere Jobi upërgjeq, e tha,
- 2 Edhe sot rëkimi im numëronetë kryengritje;  
Mjerësia ime është më e-rëndë se psherë-  
tima ime.
- 3 Makar të 'dinjam ku munt t'a gjenj atë,  
*Edhe* dotë vinjam gjer ndë front t' ati!
- 4 Dotë dëftenjam punënë t'ime përpara ati,  
Edhe dotë mbushnjam gojënë t'ime me  
dëftesa.
- 5 Dotë dinjam fjalëtë që dotë më përgjigjej,  
Edhe dotë kupëtonjam ç' dotë më thoshte.
- 6 Mës ndë madhërit të fuqis' së tij dotë  
hahej me mua?  
Nukë; po dotë më vintë veshnë.
- 7 Atëhere dotë muntte të flistë i-drejti me atë;  
Kështu dotë shpëtonjam për gjithënjë nga  
gjykatësi im.
- 8 Na tek vete përpara, po nuk' është;  
Edhe prapa, po nuk' e shoh dot;
- 9 Mbë të-mëngjërët, kur punon, po s' munt  
t'a shoh;  
Fshihetë mbë të-djathët, edhe nuk' e shoh.
- 10 Po ay e njeh udhënë që kam marrë;



- Kur të më çprovonjë, dotë dal pos i ar.
- 11** Këmba ime ka qëndruarë ndër çapet t' ati;  
Udhën' e atij e kam ruajturë, edhe nuk'  
uprora.
- 12** Nuk' uhoqa prapa nga porosit' e buzëvet  
t' ati;  
Ruajta fjalët' e gojës' s' ati më tepërë se  
ushqimnë t' im të-nevojshim.
- 13** Po ay ëshië ndë një *mëndje*, edhe kush  
munt t'a kthenjë atë?  
Edhe ç' i dojë shpirti, atë bën.
- 14** Sepse bën atë që është vendosurë për mua;  
Edhe shumë të-këtilla janë me atë.
- 15** Përandaj trëmbem prej faqes' s' ati;  
Kur mendonem, më merr frika prej ati.
- 16** Sepse Perëndia m'a bëri të-frikshime zë-  
mërenë,  
Edhe Fuqimadhi më ka trëmburë.
- 17** Sepse nuk' ukëpuçë përpara se të *vinte*  
errësira,  
Edhe nukë fshehu errësirënë prej faqesë  
s' ime.

### Krye 24

- 1** Përse nukë ka kohëra të-ndara prej Fuqi-  
madhit?  
Edhe përse ata që e njohënë nukë shohënë  
ditt' e ati?
- 2** Ka njerës që e luanjënë sinorëtë;



- Rrëmbenjënë tufë dhënsh, e i kulloşënë;
- 3 Marrënë gomarin' e të-varfërit,  
Marrënë kan' e gruas' së-ve për penk;
- 4 E kthenjënë të-nevojshiminë nga udha;  
Të-butët' e dheut fshihenë bashkë.
- 5 Në, posi gomarë t' egërë ndë shkretëtirët,  
Dalënë ndë punërat të tyre, dyke kërkuarë  
me kujdes gjah;
- Shkretëtira *ep* ushqim për ata *edhe* për  
djemt' e atyre.
- 6 Korrnjënë atë që nuk' ësht' e atyreve,  
Edhe vjelënë vreshtë paudhërie.
- 7 Bënjënë të-sveshuritë të shkonjënë tërë na-  
tënë pa rrobë,  
Edhe pa mbulesë ndë të-ftohëtit.
- 8 Lagenë nga shirat' e malevet,  
Edhe pushtonjënë shkëmbinë, se s' kanë  
ku të pshtetenë.
- 9 Ata rrëmbenjënë të-varfërinë nga gjiri,  
Edhe marrënë penk nga i-vobegu.
- 10 Kështu e bënjënë atë të shkonjë lakuriq,  
pa rrobë,  
Edhe ata që barnjënë demetë kanë uri.
- 11 Ata që shtrydhënë vaj. përbrënda murevet  
të këtyre njerësve,  
Edhe që shkelnjënë tirat' e atyreve, kanë et..
- 12 Nga qyteti njerëzitë psherëtinjënë,  
Edhe shpirti i të-plagosurvet këlthet;  
Po Perëndia nuk' u'a numëron për marrëzi.



- :13 Këta janë prej atyreve që ngrenë krye kundrë dritësë;  
 Nukë njohënë udhët' e asaj,  
 As nukë qëndronjënë nd' udhët t' asaj.
- :14 Vrasësi ngrihetë mbë të-gdhirët e vret të-vobegunë e të-nevojshiminë;  
 Edhe natënë benëtë si kursar.
- :15 Gjithashtu edhe syri i kurvarit ruan mbrëmanet,  
 Dyke thënë, Sy nukë më sheh, edhe ndërron faqenë.
- :16 Nd' t' errët çponjënë shtëpira;  
 Ditënë rrinë mbyllurë;  
 Nuk' e njohënë dritënë.
- :17 Sepse të-sbardhurit' e ditësë për gjith' ata  
 është hie vdekjeje;  
 Ndë i njohtë ndonjë, ata janë ndë trishtimet  
 të hies' së vdekjesë.
- :18 Ësht' i-lehëtë mbi faqet të ujëravet;  
 Pjesa e atyreve ësht' e-mallëkuarë mbi dhet;  
 Nukë kthenetë nga udha e vreshtavet.
- :19 Thatësira e të-nxehëtitë rrëmbenjënë ujërat'  
 e dëborësë;  
*Kështu varri ha fajtorëtë.*
- :20 Shtrati i barkut dot' i harronjë ata; krimbi  
 dotë kulotnjë ëmbëlë mbi ata;  
*Emëri* nukë dot' u përmëndetë më;  
 Edhe paudhëria dotë thyhetë posa dru.
- :21 Kollofitnjënë shterpënë që s' piell;



- Edhe nuk' i bënjenë mirë së-vesë.
- 22 Rrëmbenjenë edhe të-fortëtë me anë të fuqis' së tyre;  
Sjjonenë, edhe asnjeri s' ësht' i-siguruarë për jetën' e ti.
- 23 Perëndia u ep atyre siguri, edhe prëhenë;  
Edhe syt' e atij janë mbi udhët t' atyreve.
- 24 Lartonenë; po për pak kohë, edhe nukë janë më;  
Po, bjenë poshtë, mirrenë nga udha si gjithë të-tjerëtë,  
Edhe pritenë si majat' e kallinjvet të grurit.
- 25 Edhe tashi, ndë mos qoftë kështu, kush dotë më nxjerrë gënjeshtar,  
Edhe t' e bënje fjalënë t' ime për asgjë?

### Krye 25.

- 1 Atëhere upërgjeq Bildad Shuhiti, e tha,
- 2 Fuqia e frika është bashkë me atë;  
Bën paqtim ndë vëndet të ti të-lartë.
- 3 A kanë numër ushtërit' e ati?  
Edhe mbë cilinë nukë lint drita e ati?
- 4 Qysh pra munt të dalë i-drejtë njeriu përpara Perëndisë?  
A qysh munt të jet' i-kthjellëtë ay që lint prej gruaje?
- 5 Na edhe ajo hëna nukë ka ndriçim,  
Edhe yjtë nukë janë të-kthjellëtë përpara ati;
- 6 Sa më pak njeriu, që është krimip!



Edhe i bir' i njeriut, që është kalbësirë!

Krye 26.

- 1 Atëhere upërgjeq Jobi, e tha,
- 2 Si i ndihe të-pafuqishimit!  
Si shpëtove krahun' e ati që ëshrë pa fuqisë
- 3 Si këshillove atë që s' ka dituri,  
Edhe dëfteve me të-plotë, urtësi të-shëndoshë!
- 4 Kujt i fole fjalë?  
Edhe frym' e kujt dolli prej teje?
- 5 Të-vdekuritë dridhenë *nga ay përposh ujë-ravet*,  
Edhe ata që rrinë nd' ato.
- 6 Hadhi është lakuriq përpara ati,  
Edhe prishja s' ka mbulesë.
- 7 Shtrin gojenë mbi vënt të-sbrazëtë,  
Edhe var dhenë mbi asgjë.
- 8 Lith ujëratë ndë ret të tia të-dëndura;  
Edhe reja nukë çiretë përposh atyreve.
- 9 Mbulon faqen' e frontit të ti;  
Nden ren' e tij mbi atë.
- 10 Heq kufi mbi faqet t' ujëravet,  
Gjer ndë kufit të dritës' e të ërrësirësë.
- 11 Shyllat' e qjellit dridhenë,  
E habitenë ndë qërtimt t' ati.
- 12 Përzjen detinë me anë të fuqis' së ti,  
Edhe me anë të dituris' së tlj depërtos  
madhështorëtë.
- 13 Me anë të frymës' se ti stolisi qiejte;



- Dor' e ati çpon gjarpërinë që dridhetë.
- 14 Na këto janë vetëmë anë të udhëvët t' ati;  
Edhe sa të-vogëlë zë dëgjojmë për atë!  
Po bumbullimën' e fuqis' s' ati kush munt  
t'a kupëtonjë?

## Krye 27

- 1 Edhe Jobi sgjati paravolin' e ti e tha,  
2 Rron Perëndia, ay që hodhi tej gjyqinë t' im!  
Edhe Fuqimadhi, ay që më piku shpirtinë!
- 3 Se sa të jetë jeta ime tek unë,  
Edhe frym' e Perëndisë ndër fyejt të hun-  
dësë s'ime,
- 4 Buzët' e mia me të-vërtetë nukë dotë fla-  
sënë paudhëri,  
As gjuha ime s' ka për të thënë gënjeshtë.
- 5 Qoftë lark prej meje t' u drejtëronj juve;  
Gjersa të vdes nukë dotë mërgonj drejtë-  
rinë t'ime prej meje.
- 6 Shtrënguarë dotë mbanj drejtërinë t'ime,  
edhe nukë dot'a lë të shkonjë;  
Zëmëra ime nukë dotë më qërtonjë gjersa  
të jem i-gjallë.
- 7 Armiku im qoftë posa i-ligu,  
Edhe ay që ngrihetë kundrë meje qoftë  
posa i-paudhi.
- 8 Sepse cila është shpresa e të-pabesit, ndo-  
nëse lakmoj,  
Kur Perëndia i çkëput shpirtinë?



- 9 A dot'a dëgonjë Perëndia klithmën' e ati,  
Kur të vinjë e-zeza mbi atë?
- 10 A dotë gëzonetë për Fuqimadhinë?  
A dotë thërresë Perëndinë mbë çdo kohë?
- 11 Dot' u mësonj juve si punon Perëndia;  
Atë që është me Fuqimadhinë s' e kam për  
të fshehurë.
- 12 Na ju të-gjithë vetë patë;  
Përse pra ubëtë fare të-kohë?
- 13 Këjo është pjesa e njeriut të-lik nga Pe-  
rëndia,  
Edhe trashëgimi i shtrëngimtarëvet që dotë  
marrënë nga Fuqimadhi.
- 14 Ndë shumohenë të bijt' e ati, janë për thi-  
kënë.  
Edhe të bijt' e atij nukë dotë nginjenë me  
bukë.
- 15 Ata që dotë mbetenë prej ati dotë varro-  
senë nde vdekjet,  
Edhe të-vat' e ati nukë dotë qanjënë.
- 16 Edhe ndë grumbulloftë ergjënt posì dhenë,  
Edhe ndë bëftë gati rroba posì baltënë;
- 17 Ay munt t' i bënje gati, po i-drejti i ka  
për të veshurë,  
Edhe i-pafajmi ka për të ndarë ergjëndinë.
- 18 Ndërton shtëpin' e tij posì merimanga,  
Edhe posì një kalive që bën ruajtësi i aravet.
- 19 Bje e fle i-pasurë, po nukë dotë hënje më  
kështu;



Hap syt' e ti, e nuk' është më.

- 20 Trishtime e pushtonjën' atë posi ujëra *të-vërshuara*,  
Edhe erë shakulli natënë e rrëmben atë.
- 21 Er' e lindjesë e rrëmben, edhe shkon;  
Edhe e çkëput atë nga vëndi i ati.
- 22 Sepse *Perëndia* dotë lëshonjë *shëgjeta*: mbi  
atë, edhe nukë dot' e kursenjë;  
Dëshëron me nxitim të ikënje nga dora e ati.
- 23 Njerëzitë dotë përpjekënë duart' e tyre-  
kundrë atij,  
Edhe nga vëndi i atij dotë fëshëllenjënë-  
kundrë atij.

### Krye 28..

- 1 Me të-vërtetë ka vënt prej të-cilit del er-  
gjëndi,  
Edhe vënt për arinë, të-cilin' e kullonjënë:
- 2 Hekuri mirretë nga dheu,  
Edhe rama tretetë nga guri.
- 3 *Njeriu* i vë kufi errësirës,  
Edhe vëshgon gjer ndë funt  
Gurët' e errësirës' së-dëndurë e të hies' së-  
vdekjesë.
- 4 Hap pus lark nga vëndi që rrinë *njerës*;  
Nukë kujtonjënë më këmbët' e *tyre*;  
Varenë lark njerësvet, e lëkundenë, që të-  
*hynjën' e të dalënë nd' atë*.
- 5 Sa për dhenë, nga ay del buka,  
Edhe ndënë të përzjehetë si prej zjarri..



- 6 Gurët' e ati janë vëndi i sapfirëvet,  
Edhe ka pluhur ari.
- 7 Atë udhë shpes gjahu nuk' e njeh,  
As syri i gjypit nuk' e ka parë;
- 8 Bishatë madhështore s' e kanë shkelurë,  
As leoni i-keq s' ka shkuarë andej.
- 9 Nden dorën' e ti mbi shkëmbin' e-ashpërë;  
*Edhe* përmbyss maletë që nga rrënjetë.
- 10 Hap kanale ndë mest të shkëmbënjet,  
Edhe syri i ati sbulon çdo gjë të-çëmuarë.
- 11 Lith vërshimin' e lumënjet, që të mos rrje-  
dhënë,  
Edhe gjën' e fshehurë e nxjer ndë dritë.
- 12 Po urtësia ku gjëndetë?  
Edhe ku është vëndi i diturisë?
- 13 Njeriu nuk' e njeh nderin' e asaj;  
As gjëndetë ndë dhet të të-gjallëvet.
- 14 Pafundja thotë, S' është tek unë;  
Edhe deti thotë, S' është me mua.
- 15 S' munt të fitonetë me ar,  
As munt të pëshonetë ergjënt për nderin' e  
asaj.
- 16 S' munt të çëmonetë me arin' e Ofirit,  
Me thuan' e-paçëmuarë, a me sapfiranë.
- 17 Ari e krystalli s' munt te barësohenë me arë,  
As munt të çkëmbenetë më stolira prej ari  
fort të-kulluarë.
- 18 Nukë dotë përmëndenë korralli a margari-  
tarëtë;



- Po, çëmimi i urtësisë është m' i-lartë se i rubinëvet.
- 19 Topazi i Ethiopisë nukë dotë barësohetë me atë,  
As dotë çëmonetë me ar të-kulluarë.
- 20 Që ku pra vjen urtësia?  
Edhe ku është vëndi i diturisë?
- 21 Sepse është fshehurë nga syt' e gjithë të-gjallëvet,  
Edhe mbuluarë nga shpest' e qiellit.
- 22 Humbja edhe vdekja thonë,  
Me veshëtë t'anë dëgjuamë të flasënë për afë.
- 23 Perëndia kupëton udhën' e asaj,  
Edhe njeh vëndin' e asaj.
- 24 Sepse ay shikon gjer nd' anët të dheut,  
Edhe sheh përposh gjithë qiellit.
- 25 Kur i epte erësë rëndësi,  
E kur matte ujëratë me masë;
- 26 Kur bënte nom për shinë,  
E udhë për vetëtimën' e bumbullimësë;
- 27 Atëhere e pa aië, edhe e çfaqi;  
E bëri gati atë, po, edhë e vëshgoj.
- 28 Edhe njeriut i tha,  
Na, frik' e Zotit, këjo është dituria,  
Edhe të-hequritë nga e-liga është urtësia.

### Krye 29

- 1 Edhe Jobi prapë sgjati paravolin' e ti, e tha,  
2 Ah të ishnjam posi ndë muajet të-shkuarë,



- Posi ndër ato dit, kur Perëndia më ruante;
- 3 Kur kandili i ati ndritte mbi kryet t' im,  
Edhe me dritën' e atij ecënja ndë t' errët;
- 4 Sikundrë ishnjam ndë ditt të vjeshtavet të  
mia,
- Kur dashuria e Perëndisë ishte mbi tendët  
t' ime;
- 5 Kur Fuqimadhi ishte edhe me mua,  
Edhe djemtë t' im ishinë rrotullë meje;
- 6 Kur lanja këmbet' e mia me gjalpë,  
Edhe shkëmbi dirhte për mua lumënj vaji!
- 7 Kur dilnja ndë portët të qytetit,  
Kur bënja gati froninë t' im ndë rrugët,
- 8 Të-rinjtë më shihninë, edhe fshiheshinë,  
Edhe pleqtë ngriheshinë e rrininë mbë këmbë;
- 9 Të-parëtë pushoninë së foluri,  
Edhe vininë dorën' e tyre mbi gojët të tyre.
- 10 Zëri i të-fisçimëvet pushonte,  
Edhe gjuha e atyre ngjitej ndë qiellezët të  
gojës' s' atyre.
- 11 Sepse, kur dëgjonte veshi, më lumëronte,  
Edhe, kur shihte syri, dëshmonte për mua-
- 12 Sepse lironjam të-vobëgunë që bërtiste,  
Edhe të-varfërinë, që s' kishte njeri t' i ndihte.
- 13 Bekimi i ati që ishte mbë të uhumbur' e  
sipërë vinte mbi mua;  
Edhe bënjam zëmërën' e së-vesë të kën-  
donte nga gëzimi.
- 14 Vishnjam drejtëri, edhe ajo vishte mua;



- Drejtëria ime ishte rroba *ime* e kurora ime.
- 15 Ishnjam sy tek i-verbëri,  
Edhe isnnjam këmbë tek i-çali.
- 16 Ishnjam atë te të-vobegtë;  
Edhe vëshgonjam gjyqin' e ati që nukë njihnjam.
- 17 Edhe thyenjam nofullat' e të-paudhit,  
Edhe rrëmbenjam gjahunë nga dhëmbët' e ati;
- 18 Atëhere thoshnjam, Dotë vdes ndë folet t'ime,  
Edhe posi rërënë dotë shumonj ditt' e mia
- 19 Rrënja ime dotë shtrihetë ndë ujërat,  
Edhe vesa dotë shkonjë tërë natënë mbi degat të mia;
- 20 Lavdia ime dotë përtërihetë tek unë,  
Edhe hargu im dotë forconetë ndë dorët t'ime.
- 21 Më dëgjoninë, e pritninë,  
Edhe pushoninë gjersa t' u *ipnja* këshillënë t'ime.
- 22 Pas fjalëvet të mia nukë shtoninë gjë,  
Edhe lëgjérata ime pikonte mbi ata.
- 23 Edhe më pritninë posи shinë,  
Edhe hapninë gjerë gojën' e tyre posи për shin' e-vonë.
- 24 Qeshnjam ndër ata, *edhe* nukë besoninë,  
Edhe nukë hithninë poshtë dritën' e fagesë s'ime.
- 25 Sgjithnjam udhën' e atyre, e rrinjam i-parë,



Edhe rrinjam posi mbret ndë ushtërit,  
Posi ay që ngushullon të-helmuarëtë.

Krye 30.

- 1 Po tashi ata që janë më të-rinj se unë më përqeshnjënë,  
Atërit' e të-cilëvet nukë më pëlgente t' i vijnam bashkë me qënt' e tufësë s' ime.
- 2 Edhe me të-vërtetë ç' dotë 'vëjente fuqia e duarvet t' atyre,  
Të-cilëvet s' u kishte mbeturë forcatë?
- 3 Janë të-fyshkurë nga nevoja e nga uria;  
Mbrehnjënë dhen' e-thatë ndë t' errëtit të prishjes' e të sinkretimit.
- 4 Këputnjënë mëllagë afërë dushnezavet,  
Edhe rrënjët' e kulmakut janë ushqimi i atyre.
- 5 Janë të-dëbuarë nga mezi i *njerësvet*;  
Këlthasënë pas atyreve si pas kursarëvet.
- 6 Rrinë ndër shkrepat të përrënjet,  
Ndër vërat të dheut e ndër shkëmbenjt.
- 7 Ndëpër dyshnezat pëllasënë;  
Përposh fërravet mblidhenë bashkë.
- 8 Janë bij të marrëve, po, bij njerësve pa emër,  
Të-cilëtë ishinë të-përzënë nga dheu.
- 9 Edhe tashi ubëshë kënkë ndër ata,  
Po, jam përrallëzë ndër ata.
- 10 Më kanë të-ndyrë, largonenë prej meje,



Edhe s' kurseenenë të më pshynjënë ndëfaqet.

- 11 Sepse çliroj *Perëndia* litarin' e *hargut* t' im,  
e më shtrëngoj.

Edhe ata hothnë tej frerinë përpara meje.

- 12 Mbë të-djathët t' ime ngrihenë bërsit' e botësë;

Më shtynjënë këmbëtë,

Edhe bënjenë gati kundrë meje udhët' e tyre të-këqja.

- 13 Prishnjënë udhënë t' ime;

Bënjenë të madhonetë mjerësia ime,

Po, njerës që s' kanë ndihmës.

- 14 Vinjenë posa prej shtegu të-gjerë;

Nde mest të shkretimit rrukullisenë *mbi mua*.

- 15 Trishtime kthenenë mbi mua,

Ndjekënë nderinë t' im posa erë;

E lumëria shkon posa re.

- 16 Edhe tashi shpirti im tretetë përbrënda meje;

Dit shtrëngimi më arritnë.

- 17 Natënë depërtonenë eshtërat' e mia,

Edhe deit' e mi nukë prëhenë.

- 18 Nga fuqia e-madhe e *dhëmbjesë* s' ime rroba ime ndërroj ngjyrënë;

Më shtrëngon posa qafëza e këmishësë s'ime.

- 19 Më hodhi ndë baltët,

Edhe ubëshë posa pluhur e hi.



- 20 Thérres mbë tynë, edhe nukë më përgjigjesh;  
 Qëndronj *mbë këmbë*, edhe më shikon.
- 21 Ubëre i-ashpërë për mua;  
 Me fuqin' e dorësë s' ate po më ndjek.
- 22 Më ngre nd' erët, më bën t' ecënj kaluarë  
*mbi atë*;  
 Edhe më bën të tretem ndë/ thëllimt.
- 23 Sepse e di se dotë më bjesh ndë vdekjet,  
 Edhe ndë shtëpit që është urdhëruarë për  
 gjithë të-gjallëtë.
- 24 Me gjithë këto nukë munt ndonjë të sgjatnjë  
 dorënë ndë prishjet të ti?  
 E ndë mjerësit të ti nukë munt të këlthasë?
- 25 A nukë qanja unë për atë që ishte<sup>ndë</sup> ditt  
 të-zeza?  
 Edhe nukë më helmoheshe shpirti për të-  
 vobegunë?
- 26 Kur prisnjam të-mirënë, atëhere më erdhi  
 e-keqeja;  
 Kur prisnjam dritënë, atëhere më erdhi e-  
 rrësira.
- 27 Zorrët' e mia valonjënë, edhe nukë kanë  
 të-prëjturë;  
 Dit shtrëngimi erdhë mbi mua.
- 28 Ecënj i-nxirë, po nukë prej djellit;  
 Ngrihem ndë përmbledhjet, edhe thérres  
 për ndihmë.
- 29 Ubëshë i vëllaj i çakajvet,



Edhe shoku i zokkamillavet.

- 30 Lëkura ime po nxihetë e po bje prej meje  
'Edhe eshtërat' e mia po digjenë nga zjarri.  
31 Përandaj qithara ime ukthye mbë vajë,  
Edhe fyelli im ndë zët t' atyre që qanjënë.

Krye 31.

- 1 Me syt' e mi kisha bërë dhiatë;  
E qysh munt të shikonjam mbë vërgjëresë?  
2 Sepse ç' është pjesa nga Perëndia që sipërë,  
Edhe trashëgimi nga Fuqimadhi që lart?  
3 A nuk' është mjerësi për të-pabesinë,  
Edhe poqaqi për punëtorët' e paudhërisë?  
4 A nukë sheh ay udhët' e mia,  
Edhe numëron gjithë çapet' e mi?  
  
5 Ndë kam ecurë me të-rrem,  
Edhe ndë ka nxituarë këmba ime për të  
gënjerë;  
6 (Letë peshonem ndë një zigare drejtërie,  
Që Zoti të njohë drejtërinë t' ime;)  
7 Ndë dolli çapi im jashtë udhësë,  
Edhe zëmëra ime ndë vate pas syvet të mi,  
Edhe ndë m' ungjit ndë duart ndonjë njollë;  
8 Atëhere mbiellça unë, e tjetërë letë hajë,  
Edhe uçrrënjoftë pronja e arësë s' ime.  
  
9 Ndë m' ugënje zëmëra prej gruaje,  
Edhe prita ndë derët të t' afërmit t' im,  
10 Atëhere gruaja ime bloftë për tjerërë *njeri*,  
Edhe të-tjerë rënçinë mbi atë.



- 11 Sepse këjo është ponomi e-ndyrë;  
Po, është paudhëri që mundonetë nga gjykatësitë;
- 12 Sepse është zjarr që përvëlon gjer ndë prishje,  
Edhe dotë çrrënjosje gjithë farënë t'ime.
- 13 Ndë hodha poshtë gjyqin' e shërbëtorit t' im a të shërbëtoresë s'ime,  
Kur haheshinë për gjë me mua,
- 14 Ç' dotë bënj atëhere, kur të ngrihetë Perëndia?  
Edhe kur të vinjë të shohë, ç' dot' i përgjigjem?
- 15 Ay që më ka bërë mua ndë barkt a nuk'ë ka bërë edhe atë?  
Edhe nukë na ka formuarë ay vetë ndë shtratt të barkut?
- 16 Ndë u kam mohuarë të-vobeqvet dëshirën<sup>r</sup> e tyre,  
A ndë kam fyskurë syt' e së-vesë;
- 17 A ndë kam ngrënë vetëmë unë kafshitënë t'ime,  
Edhe i-varfëri nukë hëngri prej asaj;
- 18 (Po, që mbë të-rit t' im ky urrit me mua posa me atë,  
Edhe asaj i qeshë udhëheqës që nga barku i s' im' mëje;)
- 19 Ndë kam parë ndonjë të humbiste, sepse s'kishte rroba,



- A ndonjë tē-vobek pa mbulesë;
- 20 Ndë mos më kanë bekuarë veshnjat' e atij,  
Edhe ndë mos është ngrohurë me bashkën<sup>r</sup>  
e delesë s'ime;
- 21 Ndë kam ngriturë dorënë t'ime kundrë tē-  
varfërit,  
Sepse shihnya se kisha ndihmë ndë portët;
- 22 Më raftë supi nga shpatulla,  
Edhe m' utheftë krahu nga bërryli.
- 23 Sepse një prishje nga Perëndia ishte tmer-  
për mua,  
Edhe pér madhërin' e ati nukë muntnjam-  
tē bënjam asgjë:
- 24 Edhe ndë kam vënë shpresënë t'ime ndë art,  
Edhe ndë i kam thënë arit tē-kthjellëtë, *Tir-je* siguria ime;
- 25 Nde jam gëzuarë, sepse pasja ime ishte e-  
madhe,  
Edhe sepse dora ime kishte fituarë shumë;
- 26 Ndë kam vënë re djellinë, kur ndritte,  
A hënënë tek ecënte ndë ndriçimt tē saj;
- 27 Edhe zëmëra ime ugënye fshehuraj,  
Edhe goja ime puthi dorënë t'ime;
- 28 (Edhe këjo ështe një panomi që mundonetë-  
nga gjykatesitë;  
Sepse dotë kisha mohuarë Perëndinë që  
është ndë tē-lartat;)
- 29 Edhe ndë ugëzuashë ndë prishjet t'ati që-  
më kishte mëri.,



- A ndë ugëzuashë, kur e gjeti atë e-keqe;
- .30 (Me të-vërtetë as gojënë t'ime nuk' e lashë  
të fëjenjë,  
Dyke kërkuarë jetën' e ati me mallëkim;)
- .31 Ndë mos kanë thënë njerëzit' e tendësë s'  
ime,  
Kush munt të gjenjë njeri që s'është ngi-  
njurë me mishrat' e ati?
- .32 (I-huaji nuk' e shkonte natënë jashtë ndë  
udhët;  
Po i hapnja dyert' e mia udhëtarit;)
- .33 Ndë e kam mbuluarë të-shkelurit' e poro-  
sisë posí Adami,  
Dyke fshehurë fajnë t' im ndë gjit t' im;
- .34 Sepse kisha frikë nga gjindja e-madhe,  
Edhe më trëmpte të-sharët' e njerësvet,  
Kaqë sa heshtnjam e nukë dilnjam nga  
dera . . . . .
- .35 Ah të kishnjam njeri të më dëgjonte!  
(Na dëshërimi im është të më përgjigjetë  
Fuqimadhi;)  
Edhe të kishnjam përfoljenë që ka shhruarë  
armiku im!
- .36 Me të-vërtetë dot'a mbanjam atë mbi supt  
t' im;  
Dot'a lithnjam si kurorë mbi *kryet* t' im.
- .37 Dot' i rrëfenjam ati numërin' e çapevet të mi,  
Dot' i afëroneshe ati posí *ndonjë* zotëni.
- .38 Ndë këlthet dheu im kundrë meje,



- Edhe vijat' e ati ndë qanjënë bashkë *me atë*;
- 39 Ndë kam grënë pemën' e ati pa paguarë,  
A ndë kam bërë zotërinjt' e ati të humpnjë-  
në jetën' e tyre;
- 40 Letë mbinjënë murriza ndë vënett të grurit,  
Edhe egjér ndë vënett të e'bit.
- Fjalët' e Jobit umbaruanë.

### Krye 32

- 1 Kështu këta të tre burra pushuanë së fo-  
luri Jobit, sepse ay ishte i-drejtë ndë syt të  
2 ti. Atëhere undes zëmërimi i Elihujt, birit të  
Baraqiil Buzitit, nga gjëria e Ramit: kundrë  
Jobit undes zëmërimi i ati, sepse drejtëronte  
3 vetëhen' e ti më tepërë se Perëndinë. Edhe  
kundrë të tre miqvet t' ati undes zëmërimi i  
ati, sepse nukë gjeninë c'të përgjigjeshinë, edhe  
4 e dënuanë Jobinë. Edhe Elihuj po priste t' i  
fliste Jobit, sepse ata ishinë më pleq se ay.  
5 Edhe kur pa Elihuj se nukë kishte më për-  
gjigje ndë gojët t' atyre tre burrave, zëmëri-  
mi i ati undes.
- 6 Edhe Elihuj, i bir' i Baraqiil Buzitit, upër-  
gjeq e tha,  
Unë jam i-ri, e ju shumë pleq;  
Përiandaj upërmabajçë, edhe nukë kuxova të  
rrëfenj mëndjenë t' ime.
- 7 Thashë, Letë flasënë ditt' *e-shuma*,  
Edhe shumica e vjetvet let' u mësonjënë  
*njerëzvet* dituri.



- 8 Po ka shpirt te njeriu,  
Edhe fryma e Fuqimadhit u ep atyre ku-  
pëtim.
- 9 Nukë janë të mëdhenjtë gjithënjetë të-urtë;  
As pleqtë ata që kupëtonjenë gjyq.
- 10 Përandaj thashë, Dëgjo-më-ni;  
Dotë dëftenj edhe unë mëndjenë t'ime.
- 11 Na tek prita fjalëtë t'uaj,  
I dëgjova mendimetë t'uaj,  
Tek po kërkonitë ç' të thoshitë.
- 12 Po, u vura veshnë me kujdes,  
Edhe na tek nukë mundi asndonjë prej jush  
t'i mbushnjë mëndjenë Jobit,  
A t'u përgjigjetë fjalëvet t'ati.
- 13 Vështoni semos thoni, Neve kemi gjeturë  
dituri;  
Perëndia dot'a përunjë atë, e nukë njeri.
- 14 Ay nuk' i sillte fjalët' e ti kundrë meje;  
As unë nukë dot' i përgjigjem pas fjalëvet  
t'uaj.
- 15 Ata uhabitnë, nuk' i upërgjeqnë më;  
Nukë kanë fjalë të thonë.
- 16 Edhe duhetë të pres, sepse ata nukë fla-  
sënë,  
Sepse rrinë, e nukë përgjigjenë më?
- 17 Edhe unë dotë përgjigjem pjesënë t'ime,  
Edhe unë dotë rrëfenj mëndjenë t'ime.
- 18 Sepse jam plot me fjalë;  
Më ngut fryma përbrënda meje.



- 19 Na barku im tek është posí vera që s' është hapurë.  
Është gati të pëlcasë posí kaciqë të-rinj *prej mushti.*
- 20 Dotë flas, që të çfryhem;  
Dotë hap buzët' e mia, edhe dotë përgjigjëm.
- 21 Nukë dotë mbanj anë, u lutem, asndonjë njeriu,  
As dotë përkëdhel njeri.
- 22 Sepse nukë di të përkëdhel;  
*Ndyshe, Krietari im* dotë më rrëmbente përnjëhere.

### Krye 33.

- 1 Përandaj, o Job, të lutem, dëgjo-më tashi lëgjérata të,  
Edhe vëru veshnë gjithë fjalëvet të mia.
- 2 Na tashi tek hapa gojënë t' ime;  
Gjuha ime foli ndë gojët t' ime.
- 3 Fjalët' e mia *dotë rrëfenjënë drejtërin'* e zë-mërësë s' ime;  
Edhe buzët' e mia dotë flasënë kthjellëtë atë që dinë.
- 4 Frym' e Perëndisë më bëri,  
Edhe frym' e Fuqimadhit më dha jetë.
- 5 Ndë munç, përgiq-m' u;  
Dil-më përpara ballë për ballë, edhe mbahu.
- 6 Na tek jam përpara Perëndisë si *edhe ti;*  
*Prej balte* jam formuarë edhe unë.



- 7 Na tek s' tē ka pēr tē tremburē frika ime,  
Edhe dora ime nukë-dotë jet' e-rëndë mbi ty.
- 8 Ti me tē-vërtetë the ndër veshët tē mi,  
Edhe dëgjova zën' e fjalëvet tē tua,
- g "Gam i-qëruarë e pa faj;  
Jam i-pafajm, as s' ka paudhëri tek. unë;
- 10 Na tek gjen ngaja kundrë meje,  
Më numëron pēr armik tē ti;
- 11 Më vë këmbëtë ndë-drut,  
Përgjon gjithë udhët e mia.,
- 12 Na tek dotë tē përgjigjëm, Mbë këtë nukë  
je i-drejtë;  
Sepse Perëndia është më i-math se njeriu.
- 13 Përse qahesh kundrë ati?  
Sepse nuk' ep fjalë pēr asndonjë nga pu-  
. nërat' e tia.
- 14 Sepse Perëndia flet një herë,  
Dy here, po njeriu nukë vë re.
- 15 Nd' ëndërrë, ndë të-fanitürë tē natësë,  
Kur bje gjum' i-rëndë mbi njerëzit,  
Tek po flenë mbi shtratet tē tyre;
- 16 Atëhere u hap veshëtë njerësvet,  
Edhe vulös këshillënë që u ep atyre,
- 17 Që t'a kthenjë njerinë nga qëllimi i ti,  
Edhe tē nxjerrë madhështinë prej njeriut;
- 18 Që tē prapsnjë shpirtin' e ati prej gropësë,  
Edhe jetën' ë atij nga tē-depërtuarët' e thi-  
kësë.

- 19 E mundon njerinë edhe me të-dhëmbura<sup>a</sup>  
mbi shtratt t' ati,  
Edhe me kundrështime të-përheshim ndë-  
eshtërat t' ati,
- 20 Kaqë sa jet' e ati mërzit bukënë,  
Edhe shpirti i ati më të-dëshëruarshimenë-  
gjellë.
- 21 Mishi i ati tretetë, sa s' munt të shihetë;  
Edhe eshtërat' e ati, që *tjetërë herë* s' du-  
keshinë, dalënë jashtë.
- 22 Po, shpirti i ati afëronetë ndë gropët,  
Edhe jet' e ati ndër ata që vrasënë.
- 23 Ndë undothë me atë një ëngjëll,  
Një përkhenjës, ndër një mijë një,  
Që t' i rrëfenjë njeriut ç' ësht' e-drejtë për  
atë;
- 24 Atëhere *Perëndia* dotë jetë i-përdëlliyershim  
për atë, e dotë thotë,  
“Shpëto-e atë, që të mos sbresë ndë varrt;  
Unë gjeta çpërblim!„
- 25 Mishi i ati dotë bënetë m' i-ardhangëtë se  
i foshnjesë;  
Dotë kthenetë ndë ditt të *djalëris'* së ti.
- 26 I lutetë Perëndisë, edhe Perëndia e shikon  
me sy të-mirë,  
Kaçë sa sheh faqen' e ati me gëzim,  
Edhe i ep njeriut drejtërin' e ati.
- 27 Këndon përpara njerësvet, edhe thotë,  
Fëjeva, edhe shtrëmbërova atë që ishte e-  
drejtë,



- Edhe nukë më bëri dobi.
- :28 Shpëtqoj shpirtinë t' im nga të-vaturitë ndë  
gropët,  
Edhe jetë ime dotë shohë dritënë.
- :29 Na këto të-gjitha i punon Perëndia,  
Dy, tri herë, me njerinë,
- :30 Për të kthyerë shpirtin' e ati nga gropat,  
Që të ndriçonetë me dritën' e të-gjallëvet.
- :31 Vërë re, o Job, dëgjo-më;  
Pusho, edhe dotë flas.
- :32 Ndë ke gjë të thuash, përgjiq-m'-u;  
Folë, sepse dua të të drejtëronj.
- :33 Ndë mos, dëgjo-më;  
Mbaj paqtimnë t' ënt,  
Edhe dotë të mësonj urtësi.

## Krye 34

- :1 Elihuj upërgjeq edhe më, edhe tha.
- :2 Pa dëgjoni fjalët' e mia, o ju të-urtë;  
Edhe vi-më-ni veshnë, o ju të-mënçurë.
- :3 Sepse veshi çprovon fjalëtë,  
Edhe qielëza ngjëron gjellënë.
- :4 Letë sgjedhëmë për vetëhenë t' ënë të-  
drejtënë;  
Letë njohëmë, ndër mest t' ënë ç' është e-mira.
- :5 Sepse Jobi tha, "Jam i-drejtë,  
Edhe Perëndia e vuri mbë nj'anë të-drej-  
tënë t'ime;



- 6 Me gjithë të-drejtënë *unumëruashë* për gë-njeshtar;  
 Plaga ime ësht' e-pashëruarshime, *ndonëse jam i-pafajm*,“
- 7 Cili njeri është posa Jobi,  
 I-cili përpiu të-përgeshuritë posa ujë?
- 8 I-cili vete ndë shoqëri me punëtorët' e pa-udhërisë,  
 Edhe ecën me njerës të-liq.
- 9 Sepse tha, Asndonjë dobi ka njeriu,  
 Që do t' i pëlqenjë Perëndisë.
- 10 Përandaj dëgo-më-ni, o burra të-mënçurë;  
 Është pun' e-pamundurë Perëndia të bënje të-liqë,  
 Edhe Fuqimadhi të bënje paudhëri.
- 11 Sepse pas punës së njeriut dot' j'a çpa-guanjë,  
 Edhe dotë bënje që çdo njeri të gjenjë pas udhëvet te tia.
- 12 Po, me të-vërtetë Perëndia nukë dotë punonjë me pabesëri,  
 As Fuqimadhi dotë shtrëmbëronjë gjyqinë.
- 13 Kush e vuri atë kujdestar përmbi dhenë?  
 A kush e vuri ndë radhë gjithë botënë?
- 14 Sikur të mendonej *vetëmë* për vëtëhen' e tij,  
 Sikur të mblithë ndë vetëhet të tij shpirtin'  
 e *njeriut* e frymën' e ati,
- 15 Çdo mish dotë humbej përnjëhere,  
 Edhe njeriu dotë kthenej prapë ndë dhet.



- 16 Tashi ndë ke mënt, dëgjo këtë;  
Dëgjo zërin' e fjalëvet të mia.
- 17 Mos qeveris ay që ka mëri të-drejtënë?  
Edhe do të dënojsh atë që është fort tepërë  
i-drejtë?
- 18 A gjan njeriu t' i thotë mbretit, *Ti je i-*  
*poshtërë?*  
A të-fisçimëvet, *Ju jeni të-liq?*
- 19 *Sa shumë më pak ati që s'u mban anë të-*  
*parëvet,*  
As nukë vështon të-pasurinë më tepërë se  
të-varfërinë?  
Sepse këta të-gjithë jan' pun' e duarvet t' ati.
- 20 Ndë një të-fillme vdesënë,  
Edhe ndë mest të natësë gjindja trumbullo-  
netë edhe shkon,  
Edhe të-fortëtë rrëmbenenë; nukë prej dore.
- 21 Sepse syt' e ati janë mbi udhët të njeriut,  
Edhe sheh gjithë çapet' e ati..
- 22 Nukë ka errësirë, as hiç vdekjeje,  
Ku munt të fshihenë punëtorët' e paudhë-  
risë.
- 23 Sepse nukë ka nevojë të vështonjë njerinë  
shumë kohë,  
Që ky të vinjë ndë gjyq përpara Perën-  
disë.
- 24 Dërrmon njerës të-fortë pa pyeturë,  
Edhe vë të-tjerë ndë vënett t' atyre..
- 25 Sepse njeh punët' e atyreve,



- Edhe përbys ata natënë, edhe dërrmonenë.
- 26 Si njerës të-liq që janë i rreh  
Nde syt të gjithë botësë;
- 27 Sepse ata uprornë e nukë vanë pas atij,  
Edhe nukë vështuanë asndonjë nga udhet<sup>r</sup>  
e ati;
- 28 Kaqë sa bënë klithmën' e të-vobeqvet t'  
arrinjë tek ay,  
Edhe dëgjoj klithmën' e atyre që mundonenë.
- 29 Kur ep të-prëjturë, kush munt t'a dënonjë?  
Edhe kur fsheh faqën' e ti, kush munt t'a  
shohë atë?  
Ose për një komp, ose për një njeri të-  
vetëëm, puna eshtë gjithashtu;
- 30 Që të mos mbretëronjë i-pabesi,  
Që të mos ketë ndonjë të shtjerrë ndë kurth  
gjindjenë.
- 31 Me të-vërtetë gjan t' i thotë njeriu Perën-  
disë:  
“Umundova, s' kam për të hërë keq më;
- 32 Atë që nukë shoh mëso-m'a ti;  
Ndë kam punuarë paudhëri, s' kam për të  
punuarë më?„
- 33 Mos dotë bënëtë pas mëndjesë s' atë?  
A hedhëke tej a sgjedhëke, ay dotë çpagua-  
një, e jo unë;  
Thuaj pra atë që di.
- 34 Burra të-mënçim më kanë për të lhënë,



- Po, çdo njeri i-urtë që më dëgjon;  
 35 "Jobi flet pa mënt,  
     Edhe fjalët' e ati s' janë me urtësi.."  
 36 Dhëntë Zoti që Jobi të çprovonetë gjer  
     ndë funtt,  
     Sepse upërgjeq posi njerëzit' e-liq.  
 37 Sepse shton kryengritje ndë fajt të ti,  
     Mburretë ndër ne,  
     Edhe shumon fjalët' e ti kundrë Perëndisë.

### Krye 35.

- 1 Edhe prapë Elihuj upërgjeq, e tha,
- 2 Mendon se ësht' e-drejtë këjo që the,  
     Jam m' i-drejtë se Perëndia?
- 3 Sepse the, Ç' dobi dotë jetë te mua?  
     Ç' fitim dotë kem *prej kesaj* më tepërë se  
     *prej fajit t' im?*
- 4 Unë dotë të përgjigjem ty,  
     Edhe shokëvet të tu bashkë me ty.
- 5 Vështro lart ndë qiejt, edhe shih;  
     Edhe vërë re retë, të-cilatë janë më të-larta  
     se ti.
- 6 Ndë fëjeve, Ç' punë bën kundrë ati?  
     Edhe ndë ushumofshinë paudhërit' e tua, ç'  
     *punë të-keqe* i bën ati?
- 7 Ndë je i-drejtë, ç' i ep ati?  
     A ç' merr ay *prej dorësë s' ate?*
- 8 Ligësia jote *munt t' i bënje keq* njeriut  
     posi ty;



Edhe drejtëria jote *munt t' i bënje mirë* të  
birit të njeriut.

- 9 Këlthasënë nga shumica e shtrëngimtarëvet,  
Thërresënë për ndihmë nga krahu i të-fortëvet.
- 10 Po asndonjë nukë thotë, Ku është Perëndia,,  
Krietari im,  
I-cili ep kënkë natënë,
- 11 I-cili na mëson më tepërë se shtëzët' e-dheut,  
Edhe na bën më të-mëncurë se shpest' e-qillit?
- 12 Atje këlthasënë, po asndonjë s' përgjigjetë,  
Për madhështin' e njerësvet të-këqinj.
- 13 Me të-vërtetë Perëndia s' ka për të dëgjuarë fjalë të-kotë,  
As Fuqimadhi nuk' i ka për të vënë veshnë:
- 14 Sa shumë më pak, kur thua *se s' e shikon atë!*  
Gjyqi është përpara atij; përandaj kij shpësënë mb' atë.
- 15 Po tashi, me-qënë-që nukë vështoj ndë zë-mërimt të ti,  
As vë re shumë të-sharatë.
- 16 Përandaj Jobi hap kot gojën' e ti;  
Grumbullon fjalë pa mënt.

### Krye 36.

- 1 Edhe Elihuj sjati fjalënë, e tha,



- 2 'Duro-më pakëzë, edhe të kam për të rrë-fyerë;  
 Sepse kam edhe më fjalë për anën' e Perëndisë.
- 3 Dotë marr diturinë t'ime që lark,  
 Edhe dot'i ap të-drejtë Kriatarit t' im.
- 4 Sepse me të-vërtetë fjalët' e mia nukë janë  
 të-rreme;  
 Përanë teje është një *njeri* i-sosurë nga  
 mëndja.
- 5 Na, Perëndia ësht' i-fortë, edhe asnjeri s'  
 heth poshtë;  
 Ësht' i-fortë ndë fuqit të diturisë.
- 6 Nuk' e ruan jetën' e të-ligut;  
 Po atyre që janë të-helmuarë u ep të-drejtë.  
 Nuk' e ruan jetën' e të-ligut;
- 7 Nukë heq syt' e tij nga *njerëzit'* e-drejtë,  
 Po i vë ata me mbretër mbi fron,  
 Edhe për jetë janë të-lartuarë.
- 8 Edhe ndë qofshinë lidhurë me hekura,  
 Edhe zënë ndë litarë shtrëngimi,
- 9 Atëhere u rrëfen atyre punën' e atyre,  
 Edhe fajet' e atyre, se usullë me madhështi.
- 10 U hap edhe veshinë ndë mësim,  
 Edhe urdhëron të kthenenë prapë nga pau-dhëria.
- 11 Ndë dëgjofshin' e ndë *i shërbefshin' ati*,  
 Dot' i shkonjënë ditt' e tyre ndë lumëri,  
 Edhe vitet' e tyre me gëzime.



- 12 Po ndë mos dëqjofshinë, dotë depērtonenë  
prej thikësë,  
Edhe dotë vdesënë ndë paditje.
- 13 Edhe ata që janë tē-pabesë ndë zëmërët  
grumbullonjënë zëmërim;  
Nukë thërresënë për ndihmë, kur i lith ata.
- 14 Ata vdesënë ndë tē-rit tē tyre,  
Edhe jeta e atyreve humbetë ndë mest tē  
tē-ndyrëvet.
- 15 Shpëton tē-shtrënguarinë ndë shtrëngimt tē ti,  
Edhe u hap veshët' atyre ndë mjerësit.
- 16 Po, dotë tē heqë udhënë nga shtrëngimi  
Ndë vënt tē-gjerë, ku nukë ka shtrëngatë;  
Edhe ç vihetë ndë truvezët t'ënde dotë jetë  
plot me tē-majm.
- 17 Po ti je plot me gjyqin' e tē-liqvet;  
Gjyq e gjykatë tē kanë për tē zënë.
- 18 Me-qënë-që ka zëmëratë, ruhu semos tē  
heqnjë udhënë ndë vllasfimi,  
Edhe tē gënjenjë me *mendimn'* e ndonjë çpër-  
blese së-madhe.
- 19 Mos dotë jenë mjaft pasjet' e tua, *që tē*  
*mos jesh* ndë shtrëngim,  
A gjithë forcat' e fuqisë s' atë?
- 20 Mos dëshëro natënë,  
Kur gjindjetë këputenë ndë vënett tē tyre.
- 21 Ruhu, semos priresh mbë shtrëmbërit;  
Sepse ti sgjodhe më tepërë këtë se shtrën-  
gimnë.



- 22 Na Perëndia tek është i-lartë ndë fuqit të ti;  
Kush është mësonjës si ay?
- 23 Cili j'a dëfteu atij udhën' e ztii?  
A cili munt t' i thotë, Ti punove paudhëri?
- 24 Kujtohu të madhëronjç punën' e ati,  
Për të-cilënë këndonjënë njerëzitë.
- 25 Gjithë njerëzit' e shohën' atë;  
Njeriu e vë re atë për-së-largu.
- 26 Na Perëndia tek' ësht' i-math, edhe nuk' e  
njohëmë;  
Numëri i vjetvet t' atij është i pavëshgu-  
arshim.
- 27 Sepse heq lart pikat' e ujit,  
Të-cilatë bënenë shi nga avulli i ati;
- 28 Të-cilatë i lëshonjënë retë,  
Edhe pikonjënë me të-plotë mbi njerinë.
- 29 Po, a munt njeriu të kupëtonjë të-përhapu-  
rit' e revet,  
*Edhe* kërcëllimën' e tendës' s' ati?
- 30 Na tek nden dritën' e ti rrëth vetëhes' së ti;  
Edhe mbulon fundin' e detevet.
- 31 Sepse me anë t' atyreve gjykon gjindjetë,  
*Edhe* ep ushqim me të-tepërë.
- 32 Mbulon duart' e ti me vetëtimënë,  
Edhe e urdhëron ku duhetë të godinjë.
- 33 Zëri asaj rrëfen për atë,  
Edhe shtëzëtë për *thëllimnë* që afëronetë.

## Krye 37

- 1 Edhe mbë këtë dridhetë zëmëra ime,



- Edhe luan nga vëndi i saj.
- 2 Dëgjoni me kujdes zërin' e ati të-frikshim; Edhe gjëmimnë që del nga goja e ati.
- 3 E dërgon ndënë gjithë qiellinë, Edhe vetëtimën' e tij gjer mb' anët të dheut.
- 4 Pas asaj uturin zë; Bumbullin me zërin' e madhëris' se ti; Edhe nuk' i kursen, kur zër' i ati dëgjonetë.
- 5 Perëndia bumbullin me zërin' e ti më më-nyrë të-çudiçime, Bën punëra të-mëdha, të-cilatë nukë munt t'i kupëtojmë.
- 6 Sepse i thotë dëborësë, Bjerë mbi dhet; Gjithashtu edhe shiut të-rrëfëtë; Edhe valëvet të shiut të-ti të-fortë.
- 7 Vulos dorën' e çdo njeriu, Që t'a njohënë të-gjithë njerëzitë që ka-kriuarë.
- 8 Atëhere *gjithë* bishatë venë ndënë të-mbu-luara, Edhe rrinë ndëpër shtrofkat të tyre.
- 9 Nga dhoma e mesditësë vjën furtuna, Edhe nga goreni të-stohëtitë.
- 10 Nga të fryjturit' e Perëndisë epetë akull; Edhe të-gjerët' e ujëravet ngushtonetë.
- 11 Po, ngarkon me lagësirë ret' e-dëndura; Çpérndan retë me vetëtimën' e ti;
- 12 Edhe ato kthenënë rrotullë ndënë udhëhe-qjeti t' ati.,



- Që të bënjenë çdo që i urdhëion  
Mbi faqet të botësë;
- 13 I bën ato të vinjenë a për mundim,  
A për dhen' e tij, a për përdëllim.
- 14 Vërë veshnë mbë këtë, o Job;  
Qëndro, e mendo punët' e-çudiçime të Perëndisë.
- 15 A kupëton si Perëndia i urdhëron ato,  
Edhe bën të ndritnjë drita e res' së tij?
- 16 A kupëton të-kundrëpeshuarat' e revet,  
Punërat' e ati që ësht' i-sosurë nga mëndja?
- 17 Si rrobat' e tua janë të-ngrohëta,  
Kur dheu është i-qetë për punë të erës' së mesditësë?
- 18 A munt të ndenç bashkë me atë qëndresën'  
e qiellit,  
E-cila ësht' e-fortë posi një pasqyrë e-derdhurë?
- 19 Mëso-na ç' t'i themi ati?  
(Sepse) neve nukë muntmë t'i raditmë fjalëtë për punë t' errësirësë.
- 20 A dot' i epetë zë ati, se unë desha të flas?  
A do njeriu të përpighetë?
- 21 Edhe tashi njerëzitë nukë shohënë dot drithën' e-ntriçime q' është ndë qëndresët,  
Po era shkon, edhe e kthjell.
- 22 Nga gorenj vjen ndriçim i-artë;  
Te Perëndia ka lavdi të-frikshime.



- 23 Fuqimadhinë s' munt t'a kupëtojmë; ësht' i-çquarë ndë fuqi,  
E ndë gjyq, e ndë drejtëri të-plotë; nukë shtrëngon.
- 24 Përandaj njerëzit' i kanë frikënë;  
Asndonjë i-urtë nga zëmëra s' munt t'a kupëtonjë.

### Krye 38.

- 1 Atëhere Zoti i upërgjeq Jobit nga era e shakullit, e tha,
- 2 Cili është ky që errëson këshillënë *t'ime*  
Me fjalë të-marra?
- 3 Ngjish tashi mezinë t'ënt posi burrë;  
Sepse dotë të pyes, edhe rrëfe-më.
- 4 Ku ishnje ti, kur hithnjam themelit' e dheut?  
Thuaj-më, ndë ke kupëtim.
- 5 Kush vendosi, ndë di, masat' e ati?  
A kush ndejti zigare mbi atë?
- 6 Mbë ç' gjë janë ngulurë themelit' e ati,  
A kush e vuri gurin' e këndit t' ati,
- 7 Kur këndoninë bashkë yjt' e mëngjezit,  
Edhe gjithë të bijt' e Perëndisë brohorininë?
- 8 A *kush* mbylli detinë me dyer,  
Kur uturr e dolli nga barku *i dheut?*
- 9 Kur bëra renë për rrobë t' ati,  
Edhe errësirën' e-dëndurë për shpargër t' ati,
- 10 Edhe bëra për atë urdhërinë t' im.  
Edhe i vura loze e dyer,



- 11 Edhe thashë, Gjer këtu dotë vinjç, po jo  
më tej;  
Edhe këtu dotë mbetenë valët' e tua ma-  
dhështore?
- 12 A ti urhhërove mëngjezinë ndë ditt të tua?  
A e bëre agjiminë të njohë vëndin' e ti,
- 13 Që të zërë anët' e dheut,  
Edhe të-liqtë të hidhenë tej prej ati?
- 14 Ndërron fytyrë posi balta ndënë vulët,  
Edhe *të-gjitha* dalënë përpara posi stoli;
- 15 Edhe drit' e të-pabesëvet hiqetë nga ata,  
Edhe krahu madhështuar dërrmonetë.
- 16 A ke hyrë gjer ndë burimet të detit?  
A ke ecurë për të vëshguarë të-thellët' e ujit?
- 17 A t' uhapnë ty portat' e vdekjesë?  
A ke parë ti portat' e hies' së vdekjesë?
- 18 A e kupetove të-gjerët' e dheut?  
Trego, ndë i kupëtove këto të-gjitha.
- 19 Ku është udha e të-ndënjurit të dritësë?  
Edhe për errësirënë, ku e ka vëndin' e saj?
- 20 Që t'a zësh atë ndë kufirët t' asaj,  
E të çquash udhët' e shtëpis' s' asaj?
- 21 E njeh *këtë*, sepse atëhere ulinde!  
A sepse numëri i ditvet të tua ësht' i-shumë!
- 22 A hyre ndë thesarët të dëborësë,  
A i pe thesarëi' e breshërit,
- 23 Që i kam ruajturë për kohën' e shtrënga-  
tësë,



- Për ditën' e luftës' e të zënjesë?
- 24 Me ç' mënyrë përhapetë drita,  
A derdhetë mbi dhet er' e djellë-lindjesë?
- 25 Kush hapi rrëke për shirat' e-forta,  
A udhë për vetëtimën' e bumbullimësë,
- 26 Që të bjerë shi mbë vënt që s' ka njerës,  
Mbë shkretëtirë që s' rri njeri,
- 27 Që të nganjë vëndin' e-shkretë e të-shkre-tuarë,  
Edhe të bënje të mbinjë bar i-njomë?
- 28 A ka atë shiu?  
A cili i polli pikat' e vesësë?
- 29 Nga barku i kujt del akulli?  
Edhe brymën' e qiellit kush e ka pjellë?
- 30 Ujératë fshiħen' e bënенë posi gur,  
Edhe faqeja e pafundjesë ngrin.
- 31 A munt të lithç togun' e Pleiadësë,  
A të sgithç të-lidhurat' e Orionit?
- 32 A munt të nxjerrç shënjëzat' e Zodiakut  
ndë kohët t' atyre?  
A munt t' i heqç udhënë Arkturit bashkë  
me të bijt' e ati?
- 33 A njeh nomet' e qiellit?  
A munt të vësh fuqin' e ati ndë dhet?
- 34 A munt të ngresh zérinë t' ént gjer ndë ret,  
Që të të mbulonjë shumicë ujérash?
- 35 A munt të dërgonjç vetëtima, që të venë,  
E të të thonë ty, Na tek jemi neve?
- 36 Kush vuri mënt përbrënda *njeriut?*



- A kush dha kupëtim ndë mëndjet?
- 37 Kush munt të numëronjë retë me anë të urtësisë?  
 A kush munt të derthnjë botilet' e qiellit,
- 38 Kur balta tretet' e benetë një trup,  
 Edhe plisatë bashkonenë fort njëri me tje-  
 tërinë?
- 39 A dotë gjuash gjah për leoneshënë?  
 A dotë kënaqçë ëndën' e leonëvet të-rinj,
- 40 Kur dergjenë ndëpër shpellat të tyre,  
 Edhe rrinë fshehurë ndë pritë?
- 41 Kush j'a bën gati korbit ushqimin' e ati,  
 Kur të-vegjëlit' e ati thërresenë mbë Pe-  
 rëndinë,  
 Edhe venë andej e këtej se s' kanë ç' të hanë?

### Krye 39.

- 1 A e di kohënë kur pjellënë dhit' e-egëra  
 ndëpër shkëmbënjt?  
 A munt të shënojsh kur pjellënë drerëtë?
- 2 A munt të numëronjç muajtë që mbushajënë?  
 A e di kohënë kur pjellënë?
- 3 Ato kërrusenë, pjellënë të-vegjëlit' e tyre,  
 Edhe lironenë nga të-dhëmburat' e tyre.
- 4 Të-vegjëlit' e atyre forconeñë, rritenë ndë  
 fushë të-hapëtë;  
 Dalënë, edhe s' kthenenë më tek ato.
- 5 Kush e dërgoj jashtë të-liruarë gomarin' e-  
 egërë?



- A kush sgidhi tē-lidhurat' e gomarit t' egérë?
- 6 Tē-cilit shtëpi i bëra errësirënë,  
Edhe vënt për tē-ndënjurit' e ati dhen' e-kripurë.
- 7 Përgesh zallahin' e qytetit,  
As dëgjon klithmën' e ati ge nget kafshëtë.
- 8 Maletë janë kullota e ati,  
Edhe vete dyke kërkuarë çdo farë bari tē-njomë.
- 9 A dotë jetë i-kënaqurë kau i-egérë tē tē-shërbnjë?  
A dotë dojë tē rrijë ndë grashit t' ënt?
- 10 A munt tē lifhç kan' e-egérë me litarin' e-atì për tē lëruarë?  
A dotë sheshonjë fushatë prapa teje?
- 11 A dot' i besonesh ati, sepse ka fuqi tē-madhe?  
A dot' i lësh atij punënë t' ënde?
- 12 A dot' i besonesh ati tē bjerë ndë shtëpit farënë t' ënde,  
Edhe tē mbledhë *gruri* tē ndë lëmët t' ënt?
- 13 Krahët' e zok-kamilësë gëzonjënë;  
*Po* a janë si krahët' e pëndët' e lëjlekut?
- 14 Sepse *ajo* lë vet' e saj mbi dhet,  
Edhe i ngroh ato ndë pluhurt,
- 15 Edhe harron se munt t'i thyenjë këmba,  
A se munt t'i shkelnjë ato bishë e-egérë.
- 16 Ësht' e-ashpërë kundrë tē-vegjëlëvet tē saj,,  
sikur tē mos ishinë t' asaj;



- Nukë ka frikë, semos i vejë mundimi mibë kot.
- 17 Sepse Perëndia s'i dha asaj mënt,  
As i dha asaj pjesë ndë kupëtimit.
- 18 Kur ngrihet' e u bje krahëvet,  
Përqesh kalinë edhe kalorësin' e atij.
- 19 Ti i ke dhënë kalit fuqin' e ati?  
Ti e ke veshurë qafën' e ati me lele të-frikshime?
- 20 Ti e ke bërë atë të këcenjë posi karkalec?  
Turfullimi i fyejet të hundës's' ati ësht' i-frikshim.
- 21 Rëmon me këmbë ndë fushët, edhe gjzonetë për fuqin' e ti;  
Del përpara për të priturë njerëzit' e-armatosurë.
- 22 Përqesh frikënë, edhe nukë trëmbetë;  
As kthenetë prapa përpara kordhësë.
- 23 Kuleta e shëgjetavet kërcëllin mbi atë,  
Shtijëza e-çkëlqyerë, edhe beri.
- 24 Përpin dhenë nga zëmërimi e nga tërbimi,  
As beson se po bje trumbetë.
- 25 Posa bje trumbeta, thotë, Hal ha!  
Edhe për-së-largu merr erë luftënë,  
Bubullimën' e kryeushtëtorëvet, e brohorimnë.
- 26 Mos me anë të urtësisë s' ate fluturon lart sqifteri,  
Edhe nden krahët' e ti drejt mesditësë?
- 27 Me urdhërinë t' ënt ngrihetë lart shqipeja,



- E bën folen' e saj ndë vënde të-lartë?
- 28 Rri mbi shkëmpt, edhe atje ka të-ndënju-ritë,  
Mbi shkëmp të-keq, edhe ndë vënde të-fortë.
- 29 Që atje përgjon gjahunë;  
Syt' e atij shikonjënë pér-së-largu.
- 30 Thëthijnë gjak edhe të-vegjëlit' e asaj;  
Edhe kudo ka kërmë, atje gjëndetë *edhe ajo*.

## Krye 40

- 1 Zoti i upërgjeq Jobit edhe më, e tha,
- 2 Ay që gjykonetë me Fuqimadhinë dot'a mësonjë atë?  
Ay që hahetë me Perëndinë letë përgjigjetë mbë këto.
- 3 Atëhere Jobi i upërgjeq Zotit, e tha,
- 4 Na unë tek s' jam asgjë; si dotë të përgjigjem?  
Vë dorënë t' ime mbi gojët t' ime.
- 5 Fola një herë, edhe nukë dotë përgjigjem më;  
Po, dy herë, po nukë dotë vete më tej.
- 6 Atëhere Zoti i upërgjeq Jobit nga era e shakullit, e tha,
- 7 Ngjish tashi mezinë t' ënt posи burrë;  
Unë dotë të pyes ty, edhe ti rrëfe-më.
- 8 Mos do të përprishç gjyqinë t' im?  
Mos do të më dënojsh, që të drejtëronesh?



- 9 A ke krah posı Perëndia?  
Apo munt tē bumbullijsh me zë si ay?
- 10 Stolisu tashi me madhëri e me vëjejtje;  
Edhe vishu me nder e me lavdi.
- 11 Dirth jashtë flakën' e zëmërimit t' ënt;  
Edhe shiko çdo madhështuar, *edhe* përunj-e atë.
- 12 Shih çdo madhështuar, e rrëzo-e atë;  
Edhe shkill tē-liqtë atje ku rrinë.
- 13 Fshih-i ata bashkë ndë pluhurt;  
*Edhe* lith faqet' e atyreve nde vënt tē-fshe-hëtë.
- 14 Atëhere edhe unë dotë tē rrëfenj për ty  
Se e-djathta jote munt tē tē shpëtonjë.
- 15 Shih tashi behemothinë, tē-cilin' e kam bërë  
bashkë me ty;  
Ha bar posı ka.
- 16 Shiko pra, fuqia e atij është ndë mest t' ati,  
Edhe forca e ati ndë mishrat tē barkut t' ati.
- 17 Luan bishtin' e ti posı dëllinjë;  
*Edhe* dejet' e kofshëvet t' ati janë gërshetuarë.
- 18 Eshtërat' e ati janë si shtërfyte tē-ramtë;  
Brinjët' e ati posı loze hekuri.
- 19 Ky është balli i punëvet tē Perëndisë;  
*Vetëme* ay që e ka bërë munt t' afëronjë  
kordhën' e ti *mbi atë*.
- 20 Me tē-vërtetë malet' i apën' ati ushqim;  
Atje losnjënë gjithë bishat' e fushësë.
- 21 Fle ndënë drurët tē xinxifevet,



Ndënë mbulesët të kallamevet edhe ndër moçale.

- 22 Drurët' e xinxifevet e mbulonjën' atë me hien' e tyre;  
Shelgjet' e rrëkevet e rrëthonjën' atë.
- 23 Shih, ndë vërshoftë lumi, nukë trëmbetë;  
Ka besim ndë vetëhet të tij, edhe ndë qoftë se Jordani fryhetë ndë gojët t' ati.
- 24 A mundetë njeri t'a zëré atë me fuqi fa-qeza,  
A t' i çponjë hundënë me dhokan?

#### Krye 41.

- 1 A munt te heqç jashtë leviathaninë me grep?  
A të shtiëngonjç gjuhën' e ati me tërkuzë?
- 2 A munt t' i vësh ati gjalmë zhugash ndë hundët?  
A munt t' i çponjçnofulënë me grep?
- 3 A dotë të bënë ty shumë të-lutura?  
A dotë të flasë ty me fjalë t' ëmbëla?
- 4 A dotë bënë dhiatë me ty?  
A dot'a marrç atë për shërbëtuar për gjithënjë?
- 5 A dotë luajsh me atë posa me një zok?  
A dot'e lithç atë për shërbëtoret' e tua?
- 6 A dotë bejnë tregëti me atë shoqërit' e peshkatarëvet?  
A dot'a ndanjënë atë ndë mest të tregëtarëvet?



- 7 A munt të mbushç lëkurën' e ati me shëgjeta,  
A kryet' e ati me shijëza peshqesh?
- 8 Vërë dorënë t' ënde mbi atë;  
Kujto luftënë; mos e bëjsh me këlë.
- 9 Na tek ësht' e-kotë shpresa *për të zënë* atë;  
A nukë dotë gremisej *njeriu nga frika* që  
posa t'a shihte atë?
- 10 Asidonjë s'ështe kaqë i-kuxuarshim sa të  
kuxonjë t'a ngrerë atë;  
Cili pra munt të qëndronjë përparrë meje?
- 11 Kush më dha mua më përparrë, që t' ja çpa-  
guanj?  
*Cdo që është* ndënë gjithë qiellinë është  
imja.
- 12 Nukë dotë pushonj *pa thënë* për anët' e  
trupit t' ati,  
Edhe për fuqin' e ati të-madhë, edhe për  
shtatin' e ati të-derdhurë bukurë.
- 13 Kush munt të sbulonjë faqen' e rrobës s' ati?  
Kush munt të hynjë përbrënda nofullavet  
t' ati me dy palë?
- 14 Kush munt të hapnjë dyert' e faqes' s' ati?  
Rreth e rrotulë dhëmbëvet t' ati është tmer.
- 15 Lëforet' e ati të-forta janë mburrimi *i ati*,  
Mbërthyerë bashkë me vulë të-shtrënguarë.
- 16 Njëra është afërë tjetërësë,  
Kaqë sa *as erë* s' munt të shkonjë ndëpër  
ato.
- 17 Janë bashkuarë njëra me tjetërënë;



Janë ngjiturë kështu, sa s' munt të çkëputenë.

- 18 Ndë tështinët t' ati ndrit dritë,  
Edhe syt' e ati janë posi vetullat' e të-gdhirit.
- 19 Nga goja e ati dalënë urrë të-ndezura,  
Edhe këcenjënë shkëndija zjarri.
- 20 Nga fyejt' e hundës' s' ati del tym,  
Posi prej ene që valon a *posi* prej zhugash  
*që digjenë*.
- 21 Frym' e ati nđes thëngjij,  
Edhe flakë del nga goja e atij.
- 22 Ndë qafët t' ati rri fuqi,  
Edhe trishtim prin përpara atij.
- 23 Tulupet' e mishit t' ati janë ngjiturë bashkë,  
Janë të-forta mbi atë; s' munt të luanjënë.
- 24 Zëmëra e atij ësht' e-fortë posi gur;  
Po, e-fortë posi guri i-poshtërë i mullirit.
- 25 Kur ngrihetë, dridhenë të-fortëtë;  
Edhe nga frika ndërkrehenë.
- 26 Kordha e ati që i del përpara s' munt të  
qëndronjë;  
As shtijëza, as beri, as thuraku.
- 27 Hekurinë e numëron posi kashtë,  
*Edhe* ramënë posi dru të-kalburë.
- 28 Shëgjeta s' munt t'a bënë atë të ikënë;  
Gurët' e hobesë janë për atë posi shtupa.
- 29 Xhoretë numëronenë për shtupë;  
Qesh mbë të-hëdhurit të shtijëzësë.
- 30 Anët' e-poshtërme t' ati janë si gurë të-  
prehëtë;



- I shtronj pos i svarnë mbi baltët.*
- 31 Bën ujërat' e-thella të valonjënë pos i vorvë;  
Bën detinë pos i enë me vaj ere.
- 32 Bën udhënë të ndritnjë prapa atij;  
Dot'a pandehte njeriu thellësirën' e ujëra-  
vet për thinja të-bartha.
- 33 Mbi dhet s' ka pos i atë;  
Është bërë kështu që të mos ketë frikë.
- 34 Shikon çdo gjë që është e-lartë;  
Është mbret përmbi gjithë bijl' e madhë-  
shtisë.

### Krye 42

- 1 Atëhere Jobi i upërgjeq Zofit, e tha,  
2 E di se munt të bëjsh të-gjitha,  
Edhe se asndonjë nga qëllimet' e tu s' munt  
të ndaletë.
- 3 Kush është ky që fsheh këshillënë pa mënt?  
Unë pra fola atë që nukë kupëtonja,  
Punë fort të-çudiçime për mua që nuk' i  
dinja.
- 4 Dëgjo, të lutem, edhe dotë flas;  
Dotë të pyes, edhe ti mëso-më.
- 5 Kam dëgjuarë për ty me të-dëgjuarët' e  
veshit,  
Po tashi syri im po të sheh tynë;
- 6 Përandaj mërzit vetëhenë t' ime, edhe pen-  
donem  
Ndë pluhur e ndë baltë.
- 7 Edhe passi Zoti i foli Jobit këto fjalë, Zoti



i tha Elifaz Themanitit, Zëmërimi im undes kundrë teje edhe kundrë të dy miqvet të tu; sepse nukë foltë për mua të-drejtënë, pos; 8 Jobi, shërbëtori im. Përandaj merrni tashi për vetëhenë t' uaj shtatë dema edhe shtatë desh, edhe ecëni te shërbëtori im Job, edhe bini për vetëhenë t' uaj dhuratë të-gjithëdjegurë; edhe shërbëtori im Job dotë lutetë për ju; sepse atë dot'a pres, që të mos u'a bënj juve pas marrëzisë s' uaj; sepse nukë foltë për mua atë që ësht' e-drejtë, pos i shërbëtori im Job.

9 Kështu vanë Elifaz Themaniti, e Bildad Shuhiti, e Sofar Naamathiti, edhe bënë si i urdhëroj ata Zoti. .

10 Edhe Zoti hoqi skllavërin' e Jobit, passi ufal ky për miqt' e ti; edhe Zoti i dha Jobit dy herë kaqë sa kishte më përpara.

11 Atëhere erthnë tek ay gjithë të vëllezërit' e ati, e gjithë të motërat' e atij, edhe gjithë ata që e njihnin' atë më përpara, edhe hëngrrë bukë bashkë me atë ndë shtëpit t' ati; edhe qanë bashkë me atë, edhe e ngushulluan' atë për gjithë të-këqiatë që kishte sjellë Zoti mbi atë; edhe sicili i dhanë nga një ergjënt, edhe sicili nga një unazë të-artë.

12 Kështu Zoti bekoj të-pastajmet' e Jobit me tepërë se të-paratë; kaqë sa kishte katrë-mbë-dhjetë mijë dhen, e gjashtë mijë kamilla, e një mijë pëndë qe, e një mijë go-



- 13 mare. I l'intnë ati edhe shtatë bij e tri bija  
 14 Edhe se-parësë j'a quajti emërinë, Jemima;  
     edhe emërin' e se-dytësë, Qezia; edhe emë-  
 15 rin' e së-tretësë, Keren-happuk. Edhe mëhc  
     gjithë dhenë s' gjëndeshinë gra kaqë të-bu-  
     kura sa të bijat' e Jobit; edhe i ati u dha  
     trashëgim ndë mest të vëllezërvet t' atyre.  
 16 Paskëtaj Jobi rroj një qint e dyzet vjet,  
     edhe pa të bijt' e ti, edhe të bijt' e të bij-  
 17 vet të tij, *gjer mbë* të-katrëtinë bres. Kështu  
     Jobi vdiq plak e plot me dit.



# Ekklesiastiu; a, Lëçitesi.

---

## Krye 1.

- 1 Fjalët' e Lëçitesit, birit të Davidit, mbretit ndë Jerusalim.
- 2 Kotësirë kotësirash, tha Lëçitësi; kotësirë kotësirash, të-gjitha janë kotësirë.
- 3 Ç' dobi ka njeriu nga githë mundimi i ti,  
4 me të-cilinë mundonetë ndënë djellinë? Një bres shkon, edhe një bres vjen; po dheu  
5 mbetetë për jetën' e jetësë. Edhe djelli lint,  
edhe djelli perëndon, edhe nxitonetë të vejë  
6 ndë vëntt të ti ku lint *përsëri*. Era vete drejt *anës'* së mesdilësë, edhe kthenetë drejt goriënët; pa pushim vete dyke ardhurë rrotullë,  
edhe kthenetë prapë era ndë rredhet të saj.
- 7 Gjithë lumënjtë venë ndë dett, edhe deti nukë mbushetë; ndë vëntt prej të-cilit vinjë-
- 8 në lumënjtë, atje venë prapë. Gjithë gjer'ratë janë plot me mundim, sa njeriu s' munt t'a rrëfenjë; syri nukë nginjetë dyke parë, as
- 9 veshi nukë mbushetë dyke dëgjuarë. Ç' është



bërë, ajo dotë bënëtë *prapë*; edhe ç' ka ngjarrë, ajo dotë ngjasë *prapë*; edhe s' ka asndo-  
 10 një gjë të-re ndënë djellinë. {A ka gjë, përtë-cilinë njeriu munt të thotë, Shiko, na këjo  
 ësht' e-re? këjo ka qënë ndë jetët që kanë  
 11 qënë përpara nesh. Nukë ka kujtim të *brezavet* që kanë qënë më parë; as dotë ketë  
 kujtim të *brezavet* më të-pastajm, të-cilëtë  
 kanë për të ardhurë ndë meشت t' atyreve që  
 kanë për të ardhurë *më vonë*.

12    *Unë*, Lëçitësi, qeshë mbret mbi Israelinë ndë Jerusalim; Edhe vura zëmërënë  
 13 t' ime të kërkonj e të vëshgonj me urtësi për gjithë sa bënëtë ndënë djellinë; është  
 një pun' e-rëndë të-cilën' u'a dha Perëndia bijvet të njerëzvet, që të stërvitenë  
 14 me atë. Pashë gjithë punëratë që bënëtë  
 ndënë djellinë, edhe na tek janë të-gjitha  
 15 kotësirë, edhe mundim fryme.\* Ajo që ësht'  
 e-shtrëmbërë nukë munt të bënëtë e-drejtë;  
 edhe ato që mungonjënë s' munt të numë-  
 16 ronenë. Unë fola ndë zëmërët t' ime, dyke  
 thënë, Na tek umadhova edhe shkova nga  
 dituria gjithë sa kanë qënë përpara meje ndë  
 Jerusalim; po, zëmëra ime pat stërvitje të-  
 17 madhe ndë urtësit e ndë diturit. Edhe vura  
 zëmërënë t' ime të njoh urtësi, edhe të njoh

---

\* A: të luftuarë pas erësë, a: të-kulloturë erë. Kështu edhe gjetkë.



marrëzi e çmënçëri; *po* kupëtova se edhe 18 këjo është mundim fryme. Sepse ndë shumë urtësi ka shumë hidhërim; edhe ay që shton dituri shton dhëmbje.

### Krye 2.

- 1 Unë thashë ndë zëmërët t'ime, Eja tashi të të çprovon me gëzim, edhe gëzohu me të-mira; po na edhe këjo qënka kotësirë. Thashë për të-qëshuritë, Qënka marrëzi; edhe për gëzimnë, Ç' dobi sjellka ky?
- 2 Vendosa ndë zëmërët t'ime si të gëzonj mishinë t' im me verë, kur zëmëra ime edhe po merrej me urtësinë, edhe të epem pas marrëzisë, gjersa të shoh ç' të-mirë kanë të bijt' e njerësvet që bënjenë *kështu* ndënë qie-llinë gjithë ditt' e jetës' së tyre.
- 3 Bëra për vetëhenë t' inie punëra të-mëdha; trajtova për vetëhenë t'ime shtëpira;
- 4 bëltova për vetëhenë t'ime vreshta; Bëra për vetëhenë t'ime kopshte e parajse, edhe bël-tova ndër ata drurë çdo farë pemësh. Bëra për vetëhenë t'ime pelge ujérash që të ujit imë ata pyllinë e-bëltuarë me drurë.
- 5 Bleva shërbëtorë e shërbetore, edhe pata shërbëtorë të-lindurë ndë shtëpit *t'ime*; pata edhe kopera të-mëdha prej bagëtish të-mëdha e të-vogëla, më tepërë se gjith' ata që kishinë qënë përpara meje ndë Jerusalim.
- 6 Mblodha për vetëhenë t'ime edhe ergjënt



· edhe ar, edhe thesarët' e-veçantë të mbretërvet e të vëndevet; mblodha për vetëhenë t' ime kënkëtorë e kënkëtore, edhe shëfrimet' e bijvet të njerësvet, gra të-dashura fort 9 shumë. Kështu umadhova, edhe ushtova më tepërë se gjith' ata që kishinë qënë përpara mejë ndë Jerusalim; *mbi gjithë këto* edhe urtë-10 sia po qëndronte tek unë. Edhe çdo që dëshëruanë syt' e mi, nuk' u'a mohova; nuk'i kur-· seva zëmërësë s'ime asndonjë gëzim, sepse zëmëra ime gëzonej mbë gjithë mundimet' e mi; edhe këjo ishte pjesa ime nga gjithë 11 mundinet' e mi. Atëhere vura re gjithë punëratë që kishinë bërë duart' e mia, edhe mundiminë, të-cilinë i keshe dhënë vetëhesë s'ime për të bërë ato; edhe na të-gjitha qënkeshinë kotësirë e mundim fryme, edhe nukë kishte asndonjë dobi ndënë djellinë.

12 Edhe ukthyeshë të shikonj urtësinë, edhe marrëzinë edhe çmënçerinë; (Sepse ç' *munt të* bënë njeriu që vjen pas mbretit? atë që 13 është bërë gjer tashi.) Edhe pasqë se urtësia e shkon marrëzinë kaqë, sa e shkon drita e-14 rrësirënë. Syt' e të-urtit janë ndë kryet t' ati, edhe i-marri ecën ndë errësirë; po unë e njoha 15 se një ngjarie ngan mbë të-gjithë këta. Edhe thashë ndë zëmërët t'ime, Si i ngan të- marrit, kështu dotë më ngjasë edhe mua; përse pra unë ubëshë më i-urtë? Përandaj thashë ndë zëmërët t'ime, se edhe këjo qën-



- 16 ka kotësirë. Sepse nukë dotë mbetetë përherë kujtimi i të-urtit, as ay i të-marrit; sepse ndë ditt që kanë për të-ardhurë të-gjitha dotë janë të-harruara. Edhe qysh *i-urti*
- 17 vdes si i-marri! Kështu e mërzita jetënë; sepse punëratë që bënenë ndënë djellinë janë të-këqia për mua; sepse të-gjitha janë kotësirë edhe mundim fryme.
- 18 Edhe mërzita gjithë mundimnë që jam munduarë ndënë djellinë; sepse duhetë t' j'a
- 19 lë atë njeriut që dotë jetë pas meje. Edhe cili njeh ndë dotë jetë *ay i-vrtë a i-marrë*; po me gjithë këto dotë jetë zot mbi gjithë mundiminë që umunduashë, edhe me të-cilinë dëfteva urtësi ndënë djellinë. Edhe këjo është
- 20 kotësirë. Përandaj un' ukthyeshë e e dëshpërova zëmërënë t'ime për gjithë mundimnë
- 21 që jam munduarë ndënë djellinë. Sepse ka njeri, që umundua me urtësi, e me dituri, e me trimëri; edhe me gjithë këto j'a lë atë për trashëgim një tjeterë njeriu, i-cili nuk' umundua për atë. Edhe këjo qënka një ko-tësirë edhe e-keq' e-madhe. Sepse ç' *dobi* ka njeriu nga gjithë mundimi i ti, edhe nga shtrëngimi i frysë së tij, nga ajo që mun-
- 22 donetë ndënë djellinë? Sepse gjithë ditt' e atij nukë janë përveç hidhërim, edhe të-përpjekurat' e ati dhëmbje; po, edhe natënë zëmëra e ati nukë ka të-prëjturë. Edhe këjo qënka kotësirë:



24 A nuk' është më mirë për njerinë të hajë, e të pijë, e të gëzonjë shpirtin' e tij me lëmiratë nga mundimi i tij? Edhe këtë e pashë  
 25 se është nga dora e Perëndisë. Sepse, *me të-vërtetë*, cili munt të hajë, a cili munt të  
 26 ketë shëfrime më tepërë se unë? Sepse Perëndia i ep njeriut të-pëlqyerë tek ay urtësi, e dituri, e gëzim; po fajtorit i ep mundim, të mbledhë e të grumbullonjë, që t' j'a apë ati që ësht' i-pëlqyerë përpara ati. Edhe këjo është një kotësirë edhe mundim fryme.

### Krye 3.

- 1 Për çdo gjë ka kohë, edhe kohë për çdo dunë ndënë qiellinë.
- 2 Ka kohë për të lindurë, edhe kohë për të vdekurë; kohë për të mbjellë, edhe kohë
- 3 për të çkulurë atë që umbuall; Kohë për të vrarë, edhe kohe për të shëruarë; kohë për
- 4 të prishurë, edhe kohë për të trajtuarë; Kohë për të qarë, edhe kohë për të qeshurë; kohë për të mbajturë zi, edhe kohë për të
- 5 këcyerë; Kohë për të hedhurë tej gurë, edhe kohë për të mbledhurë gurë; kohë për të pushtuarë, edhe kohë për të ularguarë nga
- 6 të-pushtuarëtë; Kohë për të kërkuarë, e kohë për të humburë; kohë për të ruajturë, e-
- 7 dhe kohë për të hedhurë; Kohë për të çjerë, edhe kohë për të qepurë; kohë për të he-
- 8 shturë, e kohë për të folurë; Kohë për të

dashurë, e kohë për të pasurë cmir; kohë për luftë, e kohë për paqtim.

9 Ç' dobi ka ay që punon nga *gjithë* mundimet' e ti? Ë pashë mundimnë që u dha Perëndia të bijvet të njerësvet që të stërvitënë me atë. Çdo gjë e bëri të-bukurë ndë kohët të saj; vuri edhe botënë ndë zëmërët t' atyre, po njeriu s' munt të vëshgonjë që ndë kryet e gjer ndë funtt punënë që bëri 12 Perëndia. Njoh se nukë ka asgjë më të-mirë për ata veç se të gëzonenë edhe të bënjenë të- 13 mirë ndë jetët të tyre. Edhe se çdo njeri të hajë e të pijë, e të gëzonetë me të-mira nga gjithë mundimi i tij, është dhurëti nga Perëndia.

14 Njoh se çdo që bën Perëndia dotë jetë për jetë; asgjë s' munt të shtonetë tek ajo, e asgjë s' *munt* të merretë prej asaj; edhe Perëndia e bëri këtë që njerëzitë të kenë frikë 15 përpara ati. Ajo që është ka qënë gjithënë; edhe ajo që dotë bënëtë ka qënë *gjer* tashi; edhe Perëndia kërkon prapë ato që kanë shkuarë.

16 Pashë edhe ndënë djellinë, ndë vëntt të gjyqit, se ligësia ësht' atje; edhe ndë vëntt 17 të drejtësirë, se ligësia esht' atje. Unë thashë ndë zëmërët t'ime, Perëndia dotë gjykonjë të-drejtin' edhe të-ligunë; sepse ka kohë atje për çdo gjë e për çdo punë.

18 Thashë ndë zëmërët t'ime për gjëndjen'



e tē bijvet tē njerësvet, se Perëndia dot' i çprovonjë ata, edhe dotë shohënë vetë se ja-  
 19 në shtëzë. Sepse ajo që u ngjet njerësvet u ngjet *edhe* shtëzëvet; po, një gjë u ngjet atyreve; sikundrë vdes njëri; ashtu vdes *edhe* tjetëri; po, tē gjithë kanë gjithatë firomë; edhe njeriu mbë asgjë s'është m' i-lartë se  
 20 shtëza; sepse tē-gjitha janë kotësirë. Tē-gjitha venë ndë gjithatë vënt; tē-gjitha janë prej balte, edhe tē-gjitha kthenenë prapë  
 21 ndë baltë. Cili di, ndë fryma e njeriut ngjitetë lart, edhe ndë fryma e shtëzësë sbret  
 22 poshtë ndë dhet? Pashë pra se nukë ka gjë më tē-mirë veç se njeriu tē gëzonetë ndë punërat tē ti; sepse këjo ëshë pjesa e ati; sepse cili dot'a bjerë *prapë* atë që tē shohë ç' dotë bënetë pas atij?

#### Krye 4.

- 1 Pastaj ukthyeshë edhe pashë gjithë paudhëritë që bënenë ndënë djellinë; edhe na lott' e atyre që pësonjënë paudhëri, edhe s' kishte kush t'i ngushëllonjë; edhe fuqia ishte nga an' e atyreve që bënjënë keq, po ata s'
- 2 kishte kush t'i ngushëllonjë. Përandaj unë lumërova tē-vdekuritë që kanë vdekurë më
- 3 tepërë se tē-gjallëtë që edhe po rrонjënë. Më i-mirë se këta tē dy është ay i-cili nukë ka qënë edhe, i-cili nukë ka parë punërat' e-këqia që bënenë ndënë djellinë.

- 4 Pastaj pashë edhe tërë mundiminë edhe çdo-punë që vete mbarë, se për këtë njeriu është-ndënë cmir prej të-afërmit të ti. Edhe këjo-5 është kotësirë edhe mundin frysme. I-marri-6 lëth duart' e ti, edhe ha mishërai' e ti. Më-mirë është një grusht *gjëje* me prëje, se dy: grushte, me mundim e me shtrëngim frysme..
- 7 Prapë ukthyeshë, edhe pashë kotësirë-8 ndënë djellinë. Ka njeri që është i-vetëmë, e-dhe s' ka të-dytë; po, s' ka as bir as vëlla; po me gjithë këto nukë ka funt të gjithë-mundimit *t' ati*, as syt' e ati janë të-kënaqurë-me pasje; nukë *thotë*, për cilinë pra mundo-nem, edhe e shter shpirtinë t' im së-mirash? Edhe këjo është kotësirë, po, është pun' e-keqe.
- 9 Më mirë janë dy veta se një; sepse kanë-një çpagim të-mirë për mundimin' e tyre..
- 10 Sepse ndë rënçinë, njëri dotë ngrerë shokun' e ti; po mjerë ay që është i-vetëmë, i-cili,-11 ndë rëntë, nukë ka njeri që t'a ngrerë. Pra-pë, ndë flejçinë dy bashkë, atëhere ngrohenë;.
- 12 po një *i-vetëmë* si muunt të ngrohetë? Edhe ndë një njeri del i-fortë kundrë atij që është-i-vetëmë, të dy dotë muntnjënë të qëndro-njënë kundrë atij; edhe një litar i-dredhure-tremëzaj s' këputetë kollaj.
- 13 Më i-mirë është një djalë i-vobek e i-urtë se një mbret plak e i-marrë, i-cili nukë-14 di të presë më këshillë. Sepse ay doli nga



burgu që të mbretëronjë, po ky, ndonëse u-  
 15 lint mbret, bënëtë i-vobek. Pashë gjithë të-  
 gjallëtë që ecënënë ndënë djellinë se ishinë  
 me djalinë, me të-dytinë, i-cili hipi ndë vëntt  
 16 t' ati. Nukë kishte funt të gjithë gjindjesë edhe  
 të gjithë atyreve, përmbi të-cilëtë ishte ay;  
 po më gjithë këto ata që dotë vinjënë pas  
 nukë dotë gëzonënë mb' atë. Me të-vërtetë  
 edhe këjo qënka kotësirë, edhe mu dim  
 fryme.

### Krye 5.

- 1 Ruaj këmbënë t' ënde, kur vete ndë shtë-  
 pit të Perëndisë; sepse është më mirë të  
 afëronesh që të dëgjonjç se të bjesh kur-  
 banët' e të-marrëvet; sepse këta nukë dinë  
 2 se bëjnë të-keqe. Mos unxito me gojënë t'  
 ënde, edhe zëmëra jote letë mos nxitonetë  
 të flasë fjalë përpara Perëndisë; sepse Pe-  
 rëndia është ndë qiellt, edhe ti mbi dhet;  
 3 përandaj fjalët' e tua letë jenë të-paka. Se-  
 pse ëndërra vjen me shumicën' e turbulli-  
 mevet, edhe zëri i të-marrëvet, me shumicën'  
 e fjalëvet.
- 4 Kur kushtonesh kusht \* te Perëndia, mos  
 mëno t'a mbushç atë; sepse ay nuk' i pël-  
 5 qen-të-marrëtë; ep atë që ukushtove. Sepse  
 është më mirë të mos kushtonesh, se të

\* A: Kur taks të-taksurë.



kushtonesh e tē mos e mbushç *kushtinë*.

- 6 Mos e lërë gojënë t' ënde tē bënje mi-shinë t' ënt tē fëjenjë; as mos thuaj përpara ëngjëllit, se ubë me tē-lajthiturë; përse tē zëmëronetë Perëndia me fjalënë t' ënde, edhe  
7 tē prishnjë punën'e duarvet tē tua? Sepse ndë shumicët tē ëndërravet, e ndë shumicët tē fjalëvet, ka kotësira; po ti i kij frikë Pe-rëndisë.
- 8 Nde pafsh ndë një vënt se i bënetë shtrëngim tē-vobegut, edhe se gjyqi e drejtëria shtrëmbëronenë, mos uçudit për këtë gjë; sepse një m' i-lartë se tē-lartëtë shikon me  
9 kujdes, edhe ka më tē-lartë se ata. Pronja e dheut është për tē gjithë; *edhe vetë* mbreti shërbenetë prej arësë.
- 10 Ay që do ergjëndinë nukë dotë nginjetë me ergjënt, as ay që do pasjenë me tē-shtu-  
11 arët' e gjësë; edhe kejo qënka kotësirë. Kur shtonenë tē-miratë, shtonenë *edhe* ata që i han' ato; edhe c' dobi është mb' ata *që i kanë* ato, përveç se t' i shohënë ato me syt'  
12 e tyre? Gjumi i ati që punon ësht' i-ëmbelë, do pak ha, do shumë; po tē-nginjurit' e tē-pashurit nuk' e lë atë tē flerë.
- 13 Ka një gjë tē-tmeruarë që pasnë ndënë djellinë, do-me-thënë, pasjetë ruhenë prej  
14 atyreve që i kanë për dëm tē tyre; Edhe këto pasje humbenë prej ngjarjeje së-keqe; edhe ndë ka pjellë djalë, ky nukë ka asgjë



- 15 ndë duart të tia. Sikundrë dolli nga barku i s'ëmësë, lakuriq dotë shkonjë prapë, *ashtur* sikundrë erdhi; nukë dotë marrë asgjë prej mundimit të tij, që t'a ketë ndë dorët të 16 ti. Edhe këjo gjithashtu është një e-keqe e-tmeruarë, se së-gjithash sikundrë erdhi, kështu dotë shkonjë; edhe ç' dobi është mb' 17 atë se umundua për erënë? Edhe gjithë ditt' e tia ha nd' errësirë, e me shumë hidhërim, e me sëmundje e me zëmërim.
- 18 Na seç pashë unë *gjë* të-mirë; është gjë e-përiqyerë për njerinë gjithë ditt' e jetës' së tij që i dha Perëndia të hajë e të pijë, e t' u gëzonetë të-miravet ndë mest të gjithë mundimit të tij që umundua ndënë djellinë; se 19 pse këjo është pjesa e atij. Edhe çdo njeriu, të-cilit i dha Perëndia pasje e kamje, edhe i dha fuqi të hajë préj atyreve, edhe të marrë pjesën' e tij, edhe të gëzonetë ndë mundimt 20 të ti, këjo është dhuratë Perëndie. Sepse nukë dotë kujtonjë shumë ditt' e jetës' së ti; sepse Perëndia i përgjigjetë ndë zëmërët me anë gëzimi.

### Krye 6.

- 1 Ka një të-keqe që kam parë ndënë dje-llinë, edhe këjo është e-rëndë për njerinë;
- 2 Ka njeri, të-cilit Perëndia i dha pasje, e kamje, e nder, kaqë sa të mos i shteretë shpirtit t' atij asgjë nga gjithë sa dësheron; po

Perëndia nuk' i ep fuqi tē hajē prej atyreve,  
 edhe i-huaj i ha ato. *Edhe* kējo ēshtë kotësirë  
 3 edhe ēshtë sëmundje e-keqe. Ndë pjelltë njeri  
 një qint *fëmijë*, edhe tē rronjë shumë vjet,  
 kaqë sa ditt' e vjetvet i' ati tē bënenë tē-  
 shuma, po shpirti tē mos i ngijnjtë me tē-  
 mira, edhe tē mos ketë *nderinë* tē varrosetë,  
 them se një i-lindurë pa kohë eshtë më i-  
 4 mirë se ay; Sepse vjen ndë kotësirë, edhe  
 shkon ndë errësirë, edhe eméri i ati mbulo-  
 5 netë me errësirë; Nukë pa djellinë, as e njo-  
 hu atë; ky ka prëje më tepërë se ay tjetëri;  
 6 Po, edhe ndë rroftë *ky* dy herë një mijë vjet,  
 po pa ugëzuarë së-mire; a nukë venë tē-  
 7 gjithë ndë gjithatë vënt? Gjithë mundimi i  
 njeriut eshtë për gojën' e ati, edhe me gjithë  
 8 këto oreksi *i ati* nukë nginjetë. Sepse c' fi-  
 tim ka i-urti më tepërë ngå i-marri? a ç' fi-  
 tim ka njeriu i-vobek, i cili di tē ecënje për-  
 9 para tē-gjallëvet? Sepse eshtë më mirë njeriu  
 tē shohë me sytë se tē jet' i-gënjerë ndë  
 dëshirët; edhe kējo ēshtë kotësirë edhe mun-  
 dim fryme.

10 Çdo që eshtë bërë, eméri i eshtë dhënë  
 prej shumë kohe, edhe esht' e-ditürë se kējo  
*gjë* eshtë njeriu, i-cili nukë munt tē hahetë  
 11 me atë që eshtë m'i-fortë se ay. Me-qënë-që  
 ka shumë gjer'ra që shtonjënë kotësirë, ç'  
 12 tē-mirë ka njeriu? Sepse cili di ç' esht' e-  
 mirë për njerinë ndë jetët gjithë ditt' e jetës'



s' a!ij së-kotë, të-cilatë i shkon si hie? sepse cili munt t' i thotë njeriut ç' dotë jetë pas atij ndënë djellinë?

### Krye 7.

- 1 Një emër *i-mirë* është më *i-mirë* se vajere *i-pacëmuarë*; edhe dita e vdekjesë më *e-mirë* se dita e të-lindurit.
- 2 Është më mirë të vejë njeriu ndë shtëpi zie se të vejë ndë shtëpi shëfimi; sepse atje është fundi i gjithë njerësvet, edhe *i-gjalli* dot'a vër' *atë* ndë zëmërët të ti.
- 3 Hidhërimi është më *i-mirë* se të-qeshuritë; sepse me të-vrërët' e fytyrësë zëmëra bënëtë *e-gëzuarë*.
- 4 Zëmëra e të-urtëvet është ndë shtëpit të zisë: po zëmëra e të-marrëvet është ndë shtëpit të shëfrimit.
- 5 Është më mirë për njerinë të dëgonjë qërtimn' e të-urtit, se të dëgjonjë kënkët' e të-marrëvet.
- 6 Sepse sikundrë është zëri i gjëmbavet ndënë vorvët, kështu është të-qeshurit' e të-marrit. Edhe këjo është kotësirë.
- 7 Pa fjalë shtrëngata e bën të-urtinë të-marrë; edhe dhurata e prish mëndjenë.
- 8 Më *i-mirë* fundi i çdo gjëje se të-nisurit' e asaj; më *i-mirë* i duruarshimi ndë shpirrt se madhështori ndë shpirrt.



- 9 Mos unxiton dë frymët t'ënde të zëmëronesh; sepse zëmërimi prëhetë ndë gjit të-të-marrëvet.
- 10 Mos thuaj, Cila është ngaja, për të-cilënë ditt' e-shkuara ishinë më të-mira se këto? sepse nukë pyet me urtësi për këtë.
- 11 Urtësia është e-mirë si trashëgimi; po, më e-dobishime për ata që shohënë djellinë.
- 12 Sepse urtësia është mburonjë, si është mburonjë ergjëndi; po vëjëjtja e diturisë është, se urtësia e ruan jetën' e ati që e ka.
- 13 Vërë re punën' e Perëndisë; sepse kush munt t'a bënje të-drejtë atë që Perëndia e bëri të-shtrëmbërë?
- 14 Nde ditët të mbrothësisë gëzohu; edhe ndë ditët të prapësisë vërë re; Perëndia bëri njérënë brinjë për brinjë me tjetërënë, që të mos gjenjë njeriu asgjë që dotë jetë pas atij.
- 15 Të-gjitha këto i pashë ndë ditt të kotë-sirësë s'ime; ka të-drëjtë i-cili humbetë ndëdrejtërit të ti; edhe ka të-lik i-cili sgjat *jetën' e tij* ndë ligësir të ti.
- 16 Mos ij i-drejtë me të-tepërë; as mos bëj vetëhenë t'ënde të-urtë me të-tepërë; përsë të humpç vetëhenë t'ënde?
- 17 Mos ij i-lik me të-tepërë, as mos ubëj i-marrë; përsë të vdesç përpara kohësë s' atë?
- 18 Është mirë t'a mbajsh këtë, edhe nga ajo të mos heqç dorënë t'ënde; sepse ay.



- që i ka frikë Perëndisë dotë shpëtonjë nga këto të-gjitha.
- 19 Urtësia e forcon të-urtinë më tepërë se dhjetë urdhëronjës që janë ndë një qytet.
- 20 Me të-vërtetë nukë ka mbi dhet njeri të-drejtë, i-cili të bënje mirë, e të mos fëjenjë.
- 21 'Edhe mos vërë re gjithë fjalëtë që thuhenë; që të mos dëgjonjç shërbëtorinë t'ënt
- 22 të të mallëkonjë; Sepse edhe zëmëra jote e di se shumë herë ti vetë gjithashtu ke maliquarë të-tjerë.
- 23 Gjithë këto i çprovova me urtësi; thashë, Dotë bënem i-urtë; po këjo ularguaz prej meje.
- 24 Çdo gjë që është lark, edhe me të-tepërë e-thellë, kush munt t'a gjenjë?
- 25 Unë ukthyeshë e vura zëmërënë t'ime të mësonj e të vëshgonj e të kërkonj urtësin' e fjalën' e *punëravet*, edhe të njoh ligësin' e
- 26 marrëzisë, e marrëzin' e çmënçërisë. Edhe gjeta një gjë më të-hidhurë se vdekjenë, *edhe kejo është* gruaja, zëmëra e së-cilësë është dhokanë e rrieta, *edhe* duart' e së-cilësë janë vargje; ay që është i-pëlqyerë te Perëndia dotë shpëtonjë; po fajtori dotë zihetë prej asaj.
- 27 Na, këtë gjeta, tha Lëçitësi, *dyke vëshguarë* gjer'ratë një nga një, që të gjenj fjalënë;
- 28 Të-cilënë edhe po e kërkon shpirti im, po nuk' e gjenj. Mbë një mijë gjeta një burrë; po grua ndë mest të gjithë këtyre *gravet* nukë gjeta *asnje*.



29 Na, vetëmë këtë gjeta, se Perëndia e bëri njerinë të-drejtë; po ata kërkuanë shumë gër'ra të-ra.

**Krye 8.**

1 Cili është si i-urti? edhe cili njeh të-përhapurit' e gjërravet? Urtësia e njeriut e bën faqenë të ndrinjë, edhe ashpërimi i fagesë ndërronetë.

2 *Të këshillonj* të ruanç porosin' e mbretit,  
3 edhe këtë për ben' e Perëndisë. Mos unxito  
të ikënç që përpara ati; mos qëndro ndë  
4 punë të-ligë; sepse ay ç' të dojë bën. Sepse  
fjala e mbretit ka fuqi, edhe cili dot' i thotë  
ati, Ç' po bën?

5 Ay që ruan porosinë, nukë dotë pësonjë'  
gjë të-keqe; edhe zëmëra e njeriut të-urtë e  
6 çquan kohën' edhe mënyrënë. Sepse mbë  
çdo punë ka kohë e mënyrë; përandaj mje-  
7 rësia ësht' e-madhe mbi njerinë; Sepse nukë  
di ç' dotë bënetë, edhe cili munt t' i rrëfenjë  
ati si dotë bënetë?

8 Nukë ka njeri që të ketë fuqi mbë fry-  
mënë, që t'a mbanjë frymënë; as s' ka *njeri*  
*që të ketë fuqi mbi ditën' e vdekjesë*; edhe  
ndë *këtë* luftë s' ka të-shpëtuarë, as ligësia  
dot'a shpëtonjë atë që është dhënë tek ajo.

9 Të-gjitha këto i pashë, edhe e vura mën-  
djenë t'ime pas çdo gjëje që bënetë ndënë  
djellinë; ka kohë kur një njeri ka fuqi mbi



- 10 tjetërë njeri për dëm të vetëhes' së tij. Edhe kështu pashë të-liqtë të varrosenë, të-cilët' erdh' e shkuantë nga vëndi i-shënjtëruarë, edhe uharruanë ndë qytetit ku kishinë bërë kështu. Edhe këjo është kotësirë.
- 11 Me-qënë-që vendimi kundrë punës' së-keqë nukë bënëtë me të-çpejtë, përandaj zëmëra e bijvet të njerësvet ësht' e-kuxuar-
- 12 shime të bënë keq. Ndonëse fajtori bën një qint here keq, edhe ka *dit* të-gjata, po unë me të-vertetë di se dotë kenë të-mirë ata që i kanë frikë Perëndisë, ata që kanë frikë për-
- 13 para atij; Po i ligu nukë dotë ketë të-mirë, as dotë ketë *dit* të-gjata, të-cilatë janë posihie; sepse nukë ka frikë përpara Perëndisë.
- 14 Ka një kotësirë e-cila bënëtë përmbi dhet; ka njerës të-drejtë, të-cilëvet u ngjet sipas punëravet të të-liqvet; edhe ka njerës të-liq, të-cilëvet u ngjet sipas punëravet të të-drejtëvet. Thashë se edhe këjo është kotë-
- 15 sirë. Përandaj unë lëvdova gjëzimnë; sepse për njerinë ndënë djellinë nukë ka më të-mirë gjë veç se të hajë, e të pijë, e të gjëzonetë; sepse këjo dot' i mbetet' atij nga mundimi i tij *gjithë* ditt' e jetës' së tij, të-cilatë Perëndia i dha ati ndënë djellinë.
- 16 Kur vura zëmërënë t' ime të njoh urtësinë, edhe të shoh punëratë që bënëtë përmbi dhet, (sepse *njeriu* as diten' as natënë
- 17 nuk' u ep gjumë syvet të tij;) Atëhere pa-



shë gjithë punën' e Perëndisë, se njeriu nukë munt të gjenjë punënë që bënëtë ndënë djellinë; sepse sado që të mundonetë njeriu dyke kërkuarë, nukë dot'a gjenjë; po edhe i-urti ndë mendon se dot'a njohë, nukë dotë muntnjë t'a gjenjë atë.

### Krye 9.

- 1 Sepse gjithë këtë e mendova ndë zëmërët t'ime që t'a vëshgonj gjithë këtë, se të-drejtëtë, edhe të-urtëtë, edhe punërat' e atyre, janë ndë dorët të Perëndisë; njeriu nukë njeh ndë është dashuri a cmir ndë gjithë
- 2 këto që janë përpara atyreve. Gjithë këto ngsënë gjithashtu mbë gjithë *njerëzitë*; gjithajongan *edhe* të i-drejti edhe te i-ligu; te i-miri edhe te i-kthjellëti, edhe te i-ndyri; te ay që ther kurbanë edhe te ay që nukë ther kurbanë; si është i-miri, kështu *edhe* i-ligu; si ay që bën be, kështu *edhe* ay që ka frikë nga beja.
- 3 Këjo është e-keqe ndër gjithë ato që bënnë ndënë djellinë, se një gjë ngan mbë të-gjithë; po, edhe zëmëra e të bijvet të njerëzvet është plot me ligësi, edhe marrëzia ështe ndë zëmërët t' atyre gjersa rronjënë
- 4 edhe pastaj *venë* ndë të-vdekurit. Sepse për atë që është *edhe* ndë mest të gjithë të-gjallëvet ka shpresë; sepse një qën i-gjallë vë-
- 5 jen më shumë se një leon i-ngordh urë. Se-



- pse të-gjallëtë dinë se dotë vdesënë; po të-vdekuritë nukë dinë asgjë, as nukë kanë më 6 çpagim; sepse kujtimi i atyre uharrua. Gjithashtu edhe dashuria e atyre, edhe cmiri i atyre, edhe nakari i atyre, tashi janë humburë; edhe për jetën' e jetësë nukë dotë kenë më pjesë mbë asndonjë gjë që bënetë ndënë djellinë.
- 7 Shko, ha me gjëzim bukënë t' ende, edhe pi verënë t' ende me zëmërë të-gëzuarë; sepse tashi Perëndia i ka të-pritura punërat' e 8 tua. Mbë çdo kohë rrobatë t' ende letë jenë të-bardha, edhe vaj letë mos shteretë prej 9 kokësë s' atë. Rro i-gëzuarë me gruanë që do giithë ditt' e jetës' së kotësirësë s' atë që të janë dhënë ndënë djellinë, gjithë ditt' e kotësirësë s' atë; sepse këjo është pjesa jote ndë jetët edhe ndë mundimt që mundonesh 10 ndënë djellinë. Çdo që gjen dora jote për të bërë, bëj-e me fuqinë t' ende; sepse nukë ka punë, as mendim, as dituri, as urtësi, ndë varrt ndë të-cilët vete.
- 11 Ukthyeshë, edhe pashë ndënë djellinë, se të-suluritë nukë është e këmbë-çpejtëvet, as lufta e të-fortëvet, po as buka e të-urtëvet po as pasjetë e të-mëncurëvet, po as hiri i të-vëjejturvet; sepse koha edhe fati kanë të 12 bënjenë ndë gjithë këta. Sepse edhe njeriu nuk' e njeh kohën' e ti; sikundrë pishqetë që zihenë ndë rrietë të-keqe, edhe sikundrë shpestë që zihenë ndë dhokan, kështu edhe të



bijt' e njerësvet zihenë ndë dhokan ndë kohë tē-keqe, kur këjo papandehuraj vjen mbi ata.

- 13 Pashë edhe *këtë* urtësi ndënë djellinë pas  
 14 kësaj mënyre, edhe m' uduk e-madhe; Ishtë një qytet i-vogëlë, edhe pak burra nd' atë; edhe erdhi kundrë asaj një mbret i-math, edhe e qerthëlloj atë, edhe ndërtoj fortesa tē-  
 15 mëdha kundrë atij. Po ugjënt nd' atë një njeri i-vobek, po i-urtë, edhe ay me urtësin' e tij shpëtoj qytetnë; me gjithë këto asnjeri  
 16 s' e kujtoj atë njeri tē-vobek. Atëhere thashë, Urtësia qënka m' e-mirë se fuqia, me gjithë-që urtësia e tē-vobegut nukë zihetë për gjë, edhe fjalët' e ati nukë dëgjonenë.  
 17 Fjalet' e tē-urtëvet *që flitenë* me paqtim dëgjonenë më tepërë se tē-bërtiturit' e ati që  
 18 mbretëron ndë mest tē tē-marrëvet. Urtësia është më e-mirë se armët' e luftësë; po një fajuar prish tē-mira tē-mëdha.

### Krye 10.

- 1 Mizat' e ngordhura e bënjenë vajn' e erë-hërësit tē nxjerrë erë tē-keqe; *kështu* një e-vogëlë marrëzi e humbet atë që është i-ndruarë për urtësin' e nderin' e tij.  
 2 Zëmëra e tē-urtit është ndë *dorët* t' ati tē-djathtë; po zëmëra e tē-marrit ndë tē-  
 3 mëngjérët t' ati. Edhe kur ecën i-marri ndë udhët, i shteretë mëndja, edhe u thotë tē-gjithëve se ësht' i-marrë.



- 4 Ndë ungrittë fryma e urdhëratësit kundrë teje, mos e lërë vëndinë t' ënt; sepse ëmblësira u'a pret udhënë fajeve të-mëdhenj.
- 5 Ka një të-keqe që pashë ndënë djellinë, një të-lajthiturë, *them*, që vjen nga urdhëratësi; Se marrëzia vihetë ndë lartësira të-mëdha, edhe i-pasuri rri ndë vënt të-poshtërë.
- 6 Pashë shërbëtorë mbi kuaj, edhe zotërinj dyke ecurë si shërbëtorë mbi dhet.
- 7 Ay që mihi gropë, dotë bjerë nd' atë; edhe atë që prish garth gjarpër dot'a kafshonjë. Ay që luani gurë nga vëndi, prej atyreve dotë shohë dëm; edhe ay që çan dru, prej atyreve dotë gjëndetë ndë rrëzik.
- 10 Ndë qoftë së hekuri s' ësht' i-mbrehurë, edhe zëndonjë s' e mbreh presjen' e *ati*, atëhere njeriu duhetë të përdornjë më tepërë fuqi; po urtësia ësht' e-dobishime për të hequrë udhënë.
- 11 Ndë kafshon gjarpëri pa umagjepsurë, edhe çpifësi nuk' është m' i-mirë.
- 12 Fjalët' e gojës' së njeriut të-urtë janë *plot me hir*; po buzët' e të-marrit vetë atë
- 13 dot'a kollofitnjënë. Të-nisurit' ë fjalëvet të gojës' s' ati është marrëzi, edhe fundi i kuvëndit t' ati është të-çmëndurë të-dëmshim.
- 14 I-marri shumon fjalëtë; po njeriu nukë di se ç' dotë bënetë; edhe ç' dotë bënetë pas ati, cili munt t' i rrëfenj' ati?



- 15 Mundimi i tē-marrëvet i loth ata, sepse nukë di si tē vejë ndë qytett.
- 16 Mjerë ti, o vënt, kur mbreti yt është djalë, edhe tē-parët' e tu hanë që ndë mëngjest!
- 17 Lum ti, o vënt, kur mbreti yt është bir i *njerësve* tē-fisçim, edhe tē-parët' e tu hanë ndë kohët që duhetë, për tē marrë fuqi, e jo që tē dehenë!
- 18 Për përtimn' e-shumë pulazi rrëzonetë, e-dhe për përtimn' e duarvet shtëpia pikon.
- 19 Gostia bënëtë për shëfrim, edhe vera e gëzon jetënë; edhe ergjëndi përgjigjetë mbë çdo gjë.
- 20 Mos mallëko mbretnë, as ndë mëndjet t' ënde; edhe mos mallëko tē-pasurinë as ndë dhomët t' ënde që fle; sepse shpesi i erësë dot'a shpjërë zënë *l' ènt*, edhe ajo që ka krahë dot'a rrëfenjë punënë.

### Krye 11.

- 1 Hidh-e bukënë t' ënde mbi faqet t' ujërvat; sepse pas shumë ditve *prapë* dot'a gjenjç atë.
- 2 Ep-u pjesë shtatë *njerësve*, po, edhe tetë *njerësve*; sepse ti nukë di ç' e-keqe *munt* të bënëtë mbi dhet.
- 3 Ndë qofshinë retë tē-mbushura me shi, dotë sbrazenë mbi dhet; edhe një dru, ndë rëntë nga an'e mesditësë, a nga an' i veriut, ndë vërrt që dotë bjerë druri, atje dotë gjëndetë.



- 4 Ay që vë re erënë, nukë dotë mbjellë; edhe ay që vë re retë, nukë dotë korrnjë.
- 5 Sikundrë ti nukë di cila është udha e erësë, as si *rritenë* eshtëratë ndë shtratt t' asaj që është e-mbarsurë, kështu nukë di punën' e Perëndisë, i-cili bën të-gjitha.
- 6 Ndë mëngjest mbill farënë t' ënde, edhe mbrëmanet mos mbaj pa punë dorënë t' ënde; sepse nukë di cila dotë vejë mbarë, këjo a ajo, a ndë edhe të dyja dotë janë gjithash tu të-mira.
- 7 Me të-vërtetë drita është e-ëmbëlë, edhe pun' e-pëlqyerë për sytë të shohënë djellinë.
- 8 Edhe ndë rroftë njeriu shumë vjet, letë gëzonetë ndë *kohët* të gjithë *këtyre* vitve; po letë kujtonjë *edhe* ditt' e errësirësë, të-cilatë dotë janë të-panumëruara. Gjithë sa bënenë janë kotësirë.
- 9 Gërohu, o djalosh, ndë të-ritt t' ënt; edhe zëmëra jote letë të gëzonjë ndë ditt të djalërisë s' ate, edhe ecë pas dëshirës' së zëmërësë s' atë, edhe pas të-pamit të syvet të tu; po di-e se për gjithë këto gjer'a Perën-
- 10 dia dotë të sjellë ndë gjyq. Hiq pra hidhërimnë nga zëmëra jote, edhe largo ligësinë nga mishi yt; sepse djalëria edhe m' e-mira kohë e jetësë janë kotësirë.





## Krye 12.

- 1 Edhe Krietarinë t' ënt kujto-e ndë ditt të djalërisë s' ate, para se të vinjënë ditt' e-këqia, edhe te arrinjënë vitetë, kur dotë.
- 2 thuash, Nukë kam gëzim ndë ato; Para se të errësonetë djelli, e drita, e hëna, e yjtë.
- 3 edhe pas shiut të kthenenë retë; Kur ruajtësit' e shtëpisë dotë dridhenë, edhe burrat' e-fortë dotë kërrusenë, edhe ato që bluanjënë dotë pushonjënë, sepse dotë pakësonenë, edhe ato që shikonjënë ndëpër finestrat dotë.
- 4 errësohenë, Edhe ndë udhët dyertë dotë mbyllenë; kur zëri i asaj që bluan dotë dobëtonetë, edhe *njeriu* dotë ngrihetë ndë zëtë shpesit, edhe gjithë të bijat' e kënkësë.
- 5 dotë dobëtonenë; Po, kur dotë kenë frikë nga ajo që është lart, edhe trishtime dotë jenë ndë udhët; kur drur' i bajamesë dotë lulëzonjë, edhe karkaleci dotë jetë i-rëndë, edhe oreksi dotë pritetë; sepse njeriu vete ndë shtëpit të ti të-përjetëshme, edhe ata që
- 6 mbanjënë zi ven' e vijnë udhëvet; Para se të këputetë gjalmi i-ergjëntë, a en' e-artë të thyhetë, a stëmba të thyhetë ndë kruat, a rro-
- 7 tovileja të thyhetë ndë pust; Para se të kthenetë balta ndë dhet, sikundrë ishte *më parë*, edhe fryma të kthenetë te Perëndia që e dha.
- 8 Kotësirë kotësirash, tha Lëçitësi; të-gjitha janë kotësirë.



- 9 Edhe përmbi këto, me-qënë-që Lëçitësi  
ishte i urtë, edhe dituri e mësoj gjindjenë;  
po, peshoj me mëndjenë, edhe vëshgoj, *edhe*  
10 vuri ndë radhë shumë fjalë të urta. Leçitësi  
uvu të gjenjë fjalë të-pëlqyera, edhe ato që  
ishinë shkruarë drejt, po, fjalë së-vërtete.
- 11 Fjalët' e të-urtëvet janë si thumbacë, e-  
dhe si perona të-mbërthyera mirë janë *fjalët'*  
e mësonjësvet të mblethjevet, *të-cilatë* janë  
dhënë prej gjithati Bariu.
- 12 Edhe mbi gjithë këto, biri im, mëso, se  
të bënë njeriu shumë vivlia është *një punë*  
*që* s' ka funt; edhe se shumë mësim është  
një lodhje për trupinë.
- 13 Letë dëgjojmë fundin' e gjithë punësë;  
ki-i frikë Perëndisë, edhe ruaj porosit' e ati;
- 14 sepse këjo është gjithësia e njeriut. Sepse  
Perëndia dotë bjerë ndë gjyq çdo punë të-  
.f shehurë, do e mirë është ajo, do e-ligë.



ΕΛΛΗΝΙΚΗ ΛΑΘΟΥΣ  
ΒΙΒΛΙΟΛΑΘΟΥΣ  
ΙΩΑΝΝΙΝΩΝ